



**AG APOLLONI** është një nga shkrimtarët më të rëndësishëm dhe të dalluar të brezit të tij. **ROBERT WILTON** është shkrimtar dhe diplomat, i lindur dhe rritur në Angli. Është nderuar nga shoqata “Kurora e Shoqatës së Shkrimtarëve të Historisë” për romaneve të tij historike.

Shkrimtari Ag Apolloni bisedon me Robert Wilton, përkthyesin e tij në anglisht

## PËRKTHIMI ËSHTË ALEAT I LETËRSISË NË BETEJËN ME GJUHËN



### SHËNIME MBI LIBRAT

Anton Nikë Berisha, *Maksimilian Lamberci për letërsinë shqipe. Studim monografik.*

Studim që e ndriçon thellësisht veprimtarinë e Maksimilian Lambercit për letërsinë shqipe

Nga Mikel Gojani (fq. 4)

“Vepra e zgjedhur e Midhat Frashërit”, vëllimi IX, Shqiptarëve u kthehet një pasuri e madhe kulturore dhe historike e munguar

Nga Uran Butka (fq. 12)

Duke lexuar romanet e shkrimtarit Namik Dokle

PËRTHYERJA E REALITETIT  
PA THYER TË VËRTETËN

Nga Petra Risto (fq. 6)

“Proza tregimtare greke” - Përgatitur nga Stavri J.Dajo

NJË ANTOLOGJI ME VLERA  
LETRARE DHE HISTORIKE-  
BIBLIOGRAFIKE

Nga Akad. Gjovalin Shkurtaj (fq. 8)

Botimet Fishta, Lezhë, 2023

“n’teh” si dukuri jetësore,  
“n’teh” si dukuri artistike në  
poezitë e Melita Vjerdhës

Nga Xhahid Bushati (fq. 22)

“Arbëreshët, shqiptarët e  
italisë”, një libër enciklopedik  
nga Fatmir Toçi

nga Akad. Rexhep Qosja (fq. 16)

Thirrje për aplikime nga  
shoqata “Martin Camaj”

(fq. 21)



(Në 90-vjetorin e lindjes)

## Margarita Xhepa, ylli i pashuar i skenës dhe filmit shqiptar

Nga Enver Kushi

Margarita Xhepa është një aktore, ndoshta të rralla në historinë e shkollës interpretative shqiptare, që rrezaton në tërë qënien e saj shumë dritë. Mendoj se është një dritë e brendshme, që nga lindja e saj dhe më pas është bërë pjesë e pandarë e portretit, gjestikulacionit, të folurit. Mos ndoshta kjo dritë apo rrezatim lidhet me vendlindjen e saj? Them se po.

(fq. 10)

### NJË ËNDËRR POETIKE DHE NJË DASHURI NË ALTARIN E LIRISË nga Feride Papeleka

(fq. 19)

Dino Kalenja, Hero i Popullit, ra për lirinë e Shqipërisë më 29 mars 1944. I dashuruar dhe poet, ai rrugën e poezisë e ëndërronte të lidhur me jetën e ardhme në paqe.

Njëqind vite më parë, më 3 prill 1924 lindi  
Ikona e Kinemasë

Si aktorë të rinj, kishim  
për model interpretimin e  
Marlon Brandos në film

Nga Timo Flloko (fq. 20)



### BIBLIOTEKË

Shqiptar Oseku (fq. 15)

*Poemë e marsit*

Luljeta Dano (fq. 14)

*Krijimi ndodh në errësi*

Vasko Popa (fq. 23)

*Kthemi copat e mia*

Rexhep Polisi (fq. 19)

*Po kalon ajo...*

Arben Meksi (fq. 11)

*Karikatura e të shtunës*

Botim i ri nga Onufri

### NJERIU QË SHET GJAK nga Yu Hua

Përktheu nga kinezishtja: Iljaz Spahiu (fq. 17)

### in memoriam

Jorgo Papingji, bardhi i madh  
i këngës shqiptare

Prof. dr. Bardhosh Gaçe (fq. 5)

Enver Muhametaj – studiues  
i përkushtuar i mendimit  
letrar shqiptar

Nga Prof. dr. Rami Memushaj (fq. 22)



**AG APOLLONI** është një nga shkrimtarët më të rëndësishëm dhe të dalluar të brezit të tij, që shkruajnë në gjuhën shqipe, i admiruar për prozën bashkëkohore dhe elegante, për larminë e pasur të referencave që ajo ka. Romanet e tij të mirënjohura - *Ulërima e ujkut*, *Zazen*, *Kësulëkuqja: përrallë për të rritur* - janë përkthyer në gjuhë të ndryshme dhe kanë fituar shumë çmime. Profesor në Universitetin e Prishtinës, Agu është gjithashtu autor i dramave, poezive dhe shkrimeve kritike, si dhe redaktor i revistës letrare *Symbol*. Romani i tij dokumentar për ankthin e luftës dhe amësisë, *Një fije shprese, një fije shkrepëse*, (tani në anglisht me titullin *Glimmer of Hope*, *Glimmer of Flame*) u shpall Romani i Vitit në Kosovë në vitin 2020 - dhe sapo është bërë i pari nga veprat e tij që do të botohen në anglisht (në formate të ndryshme në Amazon).

*Cfarë rëndësie ka për ju të botoheni në anglisht?*

Të botohesh në anglisht - në gjuhën e të gjithëve, si gjuhë ndërkombëtare - është një mënyrë e mirë për të zgjeruar rrjetin e lexuesve; por edhe një provë e fortë nëse letërsia, në këtë rast romani, mund të ketë lexues edhe kur shkulet nga gjuha në të cilën është shkruar. Për shkak se gjuha mbetet e lidhur me kombin, ndërsa letërsia përpigjet të kapërcejë kufizimet kombëtare të gjuhës, mendoj se çdo përkthim është një aleat i letërsisë në betejën e saj me gjuhën. Autorët e gjuhëve më të vogla kanë nevojë për përkthyes që t'ua mundësojnë këtë. Kështu që unë e shoh përkthimin në anglisht si një ndihmesë të madhe për të kapërcyer disa pengesa jo të vogla. Më befason më tepër fakti që një shkrimtar si unë, i rritur dhe i formuar duke lexuar autorë në gjuhën angleze, si klasikë ashtu edhe modernë, herë në gjuhën e tyre dhe herë në timen, tani u flet lexuesve në gjuhën angleze, në gjuhën e tyre. Kaq shumë autorë të mëdhenj kanë shkruar dhe po shkruajnë

## Shkrimtari Ag Apolloni bisedon me Robert Wilton përkthyesin e tij në anglisht

# PËRKTHIMI ËSHTË ALEAT I LETËRSISË NË BETEJËN ME GJUHËN

Përktheu nga anglishtja: Granit Zela

në anglisht, saqë ndihem mjaft i përlurur në paraqitjen e ofertës time për lexuesit që kanë një larmi të tillë zgjedhjesh. Nuk mund të hyj - nuk guxoj të hyj - në një bashkësi të tillë të denjë pa ndihmën e një përkthyesi. Në këtë mënyrë, frika e autorit të përkthyer zvogëlohet nga siguria që ofron përkthyesi.

*Romani juaj i sapo përkthyer përshkruan dy histori të vërteta dhe të dhimbshme nga Lufta e Kosovës dhe se si ato i bëjnë jehonë tragjedisë klasike. Cfarë ju shtyu ta hulumtoni këtë temë dhe në këtë mënyrë?*


Po, romani paraqet dy nëna tragjike shqiptare të Kosovës që kanë humbur fëmijët në luftë. Njëra prej



tyre, Ferdonija, ka humbur katër djem dhe bashkëshortin, po gjen ende edhe sot forcën - duke u kapur pas një fije shprese - për të jetuar në pritje të kthimit të paktën të njërit prej fëmijëve të humbur - ose të paktën forcën për të vazhduar për të treguar historinë e tyre. Tjetrës, Pashkës, iu kthyen eshtrat e dy djemve të zhdukur dhe pas kësaj bëri një gjest të fuqishëm dhe tragjik, duke i vënë vetes flakën me një fije shkrepëse. Kësisoj, këto dy gra mua më duken si dy figura sublime të tragjedisë së Kosovës: njëra simbol i qëndresës, tjetra simbol i revoltës. Për sa i përket stilit: dy vjet para këtij libri kam shkruar një dramë me titull *Skënderbeu - Manuskripti i Marlowt*, në parathënie të së cilës kam thënë se e kisha përkthyer nga anglishtja. Më shumë se disa lexues më lavdëruan për përkthimin. Në fakt nuk e kisha përkthyer, por e kisha krijuar në stilin e Kristofer Marlowt duke u mbështetur në disa referenca që kisha gjetur se ky bashkëkohës i Shekspirit kishte shkruar një dramë, tashmë të humbur, për heroin tonë kombëtar shqiptar. Pasi krijova atë dramë, doja të "zbuloja" diçka tjetër nga Eskili, babai i tragjedisë. Ndër dramat e tij të humbura është ajo e Niobës, e cila pasi i vriten të gjithë fëmijët, e mbytur nga pikëllimi i madh i lutet ditë e natë Zeusit që të tregohet "i mëshirshëm" dhe ta kthejë atë në gur. Edhe pasi është kthyer në gur, ajo vazhdon të vajtojë. Pra, është tragjedia e një nëne që humbet gjithçka me një goditje nga fati. Kjo më kujtoi aq shumë nëna kosovare që humbën fëmijët - ndonjëherë të gjitha familjet e tyre - në një luftë që u shkaktoi një dhimbje që nuk është lehtësuar as tani. Lufta dhe pasojat e luftës janë kapituj të ndryshëm të së njëjtës tragjedi. Në një farë mënyre, lufta është fizike dhe pasojat e saj janë psikologjike. Në romanin tim doja të trajtoja pasojat; mund të titullohej edhe *Krim dhe mosndëshkim*.

*Duket se ka një interes të ripërtërirë për luftën dhe pasojat e saj në romane, në skenë dhe në ekran. Pse mendoni se po ndodh kjo?*

Është një thirrje e vetëdijshme që viktimat të mos harrohen. Interesi ndryshon natyrshëm me kalimin e kohës nga lufta. Veprat më të mira për luftën zakonisht krijohen pasi të jetë krijuar një hendek i tillë. Një vepër e kënaqshme për luftën, një roman i madh, nuk mund të shkruhet menjëherë më pas nga dikush që e ka përjetuar, sepse ata ende nuk janë çliruar nga urrejtja, trauma dhe qasja "patetike". Lufta është një katastrofë dhe duhen vite për të rimarrë veten pas një goditjeje të tillë. Mund të themi se vitet e fundit kemi filluar të rimarrim veten.

*Romanet tuaja priren të mbështeten në perspektiva personale (kërkime për luftën, për jetën e një shkrimtari, vdekja e një miku); a mund të flitet për një letërsi dallueshëm të veçantë kosovare? - apo shqiptare?*





*Njëfjeshprese, njëfjeshkrepëse* është roman dokumentar dhe romani im i mëvonshëm, *Kësulëkuqja: përrallë për të rritur*, është roman gjysmë dokumentar. Në të dyja rastet kjo nënkupton një lloj shkrimi që heton dhe përzgjedh faktet me shumë kujdes. Për shkak se romanet e mia lidhin auto-fksionin me dokumentaren, ato varen në mënyrë të pashmangshme nga përvojat dhe dëshmitë e mia personale. Besoj se në kuadrin e shkrimit në gjuhën shqipe mund të flitet për një letërsi të vërtetë kosovare, e cila ruan një marrëdhënie me letërsinë shqiptare për shkak të gjuhës, por jo për shkak të modeleve që ndjek. Por të dyja letërsitë gjithsesi plotësojnë njëra-tjetrën dhe bëhen njësh në të njëjtën gjuhë. Dallimet bëhen më të dukshme kur përkthehen, sepse për një lexues të huaj ato duken se përkufizohen si letërsi dhe jo nga gjuha e tyre origjinale. Për arsye politike e historike dhe për modele estetike, letërsia në gjuhën shqipe ka dy identitete letrare dhe një identitet gjuhësor.

*Sa e gjallë do të thoshit se është atmosfera në botën intelektuale dhe letrare të Kosovës tani për tani?*

Ka një atmosferë kulturore relativisht të shëndetshme. Kur bëhet fjalë për librat, njerëzit lexojnë kryesisht letërsi të huaj - ose autorë vendas për të cilët ata e dinë se janë përkthyer. Për shkak se jemi një vend i vogël, ne kemi nevojë për një lloj afirmimi nga jashtë për t'u vlerësuar nga brenda. Shumicës i mungon kjo, por letërsia vazhdon jetën e saj - ndoshta sepse arti lind nga mungesa.

*Jeni gjithashtu profesor i letërsisë; si shihet dhe studiohet letërsia në gjuhën angleze në Kosovë?*

Letërsia anglofone padyshim se ka vlerësimin më të madh në Universitetin e Prishtinës, ku kam studiuar dhe ku kam dhënë mësim që nga viti 2008. Është studiuar në mënyra të ndryshme në degët e

Letërsisë Angleze, Letërsisë Shqipe dhe Dramaturgjisë. Unë kam studiuar dhe kam dhënë mësim në të treja degët, dhe vëmendja kryesore është te emrat e njohur: Shekspir, Milton, Suift, Blejk, Poe, Bajron, Shelli, Osten, Dikens, Jejts, Paund, T. S. Eliot, Xhojs, Vulf, Kipling, Konrad, Frost, Beket, Vonegut, Roth... Në fakt mund të vazhdoj ta zgjas listën pa fund. Letërsia angleze jo vetëm që është studiuar mirë; ajo ka ushtruar një ndikim të fuqishëm edhe në letërsinë shqipe, nga romantizmi e deri te post-modernizmi.

*Kush është autori juaj i parapëlqyer në gjuhën angleze?*

Është e vështirë të veçosh një emër mes kaq shumë emrave që unë i vlerësoj. Krahas Shekspirit, të cilin e do gjithë bota - sigurisht edhe unë - në poezi ia dhuroj palmën e dafinës T. S. Eliotit. Admiroj disa prozatorë bashkëkohorë, por për mua Julian Barnes-i spikat: gjithmonë më mahnit mprehtësia e tij - një finesë stili si filigran Kosove.

Burimi: <https://www.anglo-albanian.org.uk/aaa-gazette>

**ROBERT WILTON** është shkrimtar dhe diplomat, i lindur dhe rritur në Angli. Karriera në shërbimin civil përfshin përvojat në Zyrën e Komonuelthit dhe të Punëve të Jashtme si dhe në vitin 2006 si këshilltar i kryeministrit të Kosovës Agim Çeku për çështjet ndërkombëtare, komunikim dhe administrim, duke e shoqëruar kryeministrin si ndihmës gjatë vitit 2007 në takimet me përfaqësues të Serbisë. Në vitin 2010, u kthye në Kosovë në pozicionin e Drejtuesit të Politikave dhe të Çështjeve Publike në Zyrën Ndërkombëtare Civile, duke monitoruar dhe këshilluar qeverinë e Kosovës. Në vitin 2013 u emërua zëvendës-ambasador i Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), Prania e OSBE-së në Shqipëri. Si shkrimtar Wilton është nderuar nga shoqata “Kurora e Shoqatës së Shkrimtarëve të Historisë” për serinë e romaneve të tij historike. Esetë për historinë dhe filmin i boton në revistën *The London Magazine* dhe revista të tjera. Së bashku me shkrimtaren dhe bashkëshorten e tij Elizabeth Gowing, në vitin 2022 ka botuar përmbledhjen me ese: “Tokat e Askujt: tetë gra të jashtëzakonshme në historinë e Ballkanit”.



Një varg studiuesish të huaj janë marrë me përkushtim me letërsinë shqipe dhe me disa zhanre të saj, mirëpo me veprimtarinë e tyre studiuesit tanë nuk janë marrë mirëfilli me to dhe nuk i kanë ndriçuar arritjet e tyre më të rëndësishme, si fjala vjen, të Georg von Hahn-i, Bop-it, Gustaj Myjer-it, G. Vajgand-it, Maksimilian Lamberc-it, Norbert Jokl-it, Franc Nopça-s etj.

Është fakt se në disa vepra studimore të autorëve të huaj për kulturën dhe letërsinë tonë kanë dëshmuar vlera të mirëfillta shkencore që kanë pasur jehonë jo vetëm në rrafshin ndërkombëtar, por edhe në atë shqiptar. Studiuesit tanë shpesh janë mbështetur në të arriturat e tyre. Kjo ka ndodhur në mënyrë të veçantë në gjuhësi.

Duhet thënë se studiuesit e huaj i vështruan dukuritë albanologjike të bazuara në fakte dhe argumente autentike shkencore, pa ngjyrimë ideologjike, siç ndodhi në botën tonë gjatë kohës së komunizmit, veçmas në Shqipëri.

Njëri nga studiuesit evropian që me aftësinë dhe dijen e tij sa të gjerë aq dhe të thellë, dha një ndihmesë të rëndësishme në studimin e disa fushave të albanologjisë, është studiuesi me origjinë austriake Maksimilian Lamberci. Ai u mor me mbledhjen e materialeve të letërsisë gojore shqipe, në mënyrë të veçantë me epikën gojore e me përrallën. Këtë na e thotë autori i studimit: “*Ndihmesën kryesore në fushën e letërsisë gojore shqiptare M. Lamberci e dha në studimin e dy llojeve: të këngëve kreshnike dhe të përrallës*” (f. 83). Mirëpo, Lamberci iu qas dhe disa veprave të letërsisë së shkruar dhe me mitologjinë shqiptare.

Botimi i tij i parë albanologjik i Lambercit është ai bashkë me Gjergj Perkmez (1872-1938), doracaku për mësimin e gjuhës shqipe Lehr – und Lesebuch des Albanischen (Vjenë 1913). Në maj dhe qershor të vitit 1916 Maksimilian Lamberci për herë të parë udhëtoi në Shqipëri si anëtar i Komisionit për Ballkanin të Akademisë austriake të shkencave për të kryer hulumtime gjuhësore dhe folklorike.

Gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri ai vizitoi disa vendbanime si Grudën, Shkodrën, Lezhën, Krujën, Tiranën, Durrësin, në veçanti Mirditën, ku qëndroi disa kohë, duke studiuar dialektin dhe duke mbledhur material të letërsisë gojore. Gjatë asaj kohe Lamberci bashkëpunoi me Gjergj Fishtën në redaksinë e gazetës “*Posta e Shqypnies*” (1916-1918) në të cilën gjithashtu botoi artikuj. Në vitin 1958 botoi përkthimin e plotë në gjermanisht të “*Lahutës së Malcís*” (“*Die Laute der Berglandes*”), të pajisur me hyrje e me shënime të rëndësishme dhe me vlerë.

Për të hedhur dritë në veprimtarinë e gjerë të këtij albanologu të rëndësishëm studiuesi i letërsisë, prof. dr. Anton Nikë Berisha, i është qasur me përkushtimin dhe seriozitet të madh analizimit dhe ndriçimit të veprave të Lambercit. Dëshmi e kësaj është studimi i tij monografik “*Maksimilian Lamberci për letërsinë shqipe*”, botuar nga Instituti i trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve në Shkup, i pari i këtij lloj në traditën tonë.

Studimi i Berishës ndriçon sidomos kontributin e Lambercit në fushën e studimit të poezisë gojore shqipe, të epikës gojore, të përrallës, po, siç u tha, dhe të disa veprave të letërsisë së shkruar, si, fjala vjen, për veprën e Varibobës, të Fishtës etj.

Në Parathënien me titull “*Vepër që vendos një standard vlerësimi në interpretimin e teksteve të autorëve*

Anton Nikë Berisha, *Maksimilian Lamberci për letërsinë shqipe*. Studim monografik. Botoi Instituti i trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve – Shkup 2021

## Studim që e ndriçon thellësisht veprimtarinë e MAKSIMILIAN LAMBERCIT për letërsinë shqipe

Nga Mikel Gojani

të huaj”, studiuesi i letërsisë shqipe, njëherësh edhe redaktor i këtij libri, Emin Azemi, shkruan se “*Maksimilian Lamberci për letërsinë shqipe*” është një vepër kapitale e Anton Nikë Berishës që e lidh një traditë studimi të albanologjisë evropiane, sidomos, të albanologëve gjermanë e austriakë, me lexuesin shqiptar, i cili pak ka qenë i njohur mbi kontributin e tyre. Kjo vepër është një përpjekje serioze, jo vetëm për ta ndriçuar një veprimtari pak të njohur të Maksimilian Lambercit, por edhe për të vendosur një standard vlerësimi në interpretimin e teksteve të autorëve të

huaj mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare. Nga hulumtimet e prof. Berishës, pohon studiuesi Azemi, rrjedh që Lamberci ka dhënë një ndihmesë të madhe, përpos në mbledhjen dhe në studimin e thesarit tonë gojor, edhe në prezantimin e specifikave etno - psikologjike e kulturologjike të shqiptarëve para një lexuesi të gjerë. Përmes studimeve të tij, sidomos të hulumtimeve të epikës sonë gojore dhe përrallës, Lamberci kishte arritur ta ndriçojë pasurinë dhe karakterin shpirtëror e psikologjik të shqiptarëve përmes një “*rëntgeni*” të vendosur diku në malet e Shqipërisë”.



Ndërkaq autori, Anton Nikë Berisha, në *Fjalën e tij paraprake* thekson se kërkimet e fillimit i kishte përqendruar në veprimtarinë e Lambercit në fushën e letërsisë gojore: “*Veprova në këtë mënyrë për arsye se Lamberci rezultatat më të shënuara e më të qëndrueshme i ka mbërritur në studimin e epikës gojore dhe të përrallës sonë gojore*”. Në vazhdim Berisha vë në dukje se puna e Lambercit është e rëndësishme jo vetëm për albanologjinë po dhe më gjerë, për Evropën Juglindore nga se “*Për herë të parë epika jonë gojore dhe përrallat tona u sunduan nga rrafshet dhe aspekte të ndryshme dhe u krahasuan edhe me llojet e ngjashme të traditave të tjera. Disa mendime të tij nuk e kanë humbur vlerën dhe rëndësinë e tyre as sot e gjithë ditën*”.

Librin “*Maksimilian Lamberci për letërsinë shqipe*” autori e ka konceptuar në katër pjesë: Lamberci njëri ndër albanologët më të shquar; Lamberci për letërsinë e shkruar shqipe; Lamberci për letërsinë gojore shqipe dhe Autor librash gjuhësorë – mësimorë dhe përkthyes letrar i përkushtuar.

Në pjesën e parë të librit Berisha sjell dhe një varg vlerësimesh të rëndësishme të studiuesve të shquar për veprimtarinë e Lambercit, si, fjala vjen, të Eqrem Çabejt, i cili e vlerëson lart veprimtarinë e studiuesit austriak: Lamberci me një shumësi tematike kapërthen kompleksin e studimeve shqiptare në tërësinë e tij, sidomos duke i kushtuar një vëmendje të veçantë e të pandërprerë literaturës popullore dhe artistike, gjuhësisë dhe etnografisë e të folklorit në kuptimin më të gjerë. Berisha sjell edhe vlerësime të autorëve të tjerë si Wilfried Fiedler, Karl Gurakuqi, Claus Haebler, Qemal Haxhihasani, Koço Bihiku, Emil Lafe etj.

Në pjesën e dytë të studimit autori i shpalos mendimet dhe vlerësimet e Lambercit për letërsinë e shkruar shqipe. Fillimisht ai u mor me “*Lahutën e Malcís*” të Gjergj Fishtës si dhe me veprën e Jul Varibobës, “*Gjella e Shën Mërisë Virgjër*”, pjesë nga e cila përktheu në gjermanisht disa pjesë të saj. Lamberci prej gjithë këtyre shkrimtarëve me admirimin më të madh shkruan për Fishtën – Homerin shqiptar: “*Kjo na tregon (krahasimet e Fishtës me Homerin – A.N.B.) se Fishta nuk ishte vetëm homerist, por, në kujtimin e mrekullueshëm për veprën e tij të pavdekshme, do t’ia jepnim me plot të drejtë kurorën e lartë të Homerit shqiptar*” (f. 63). Rreth “*Lahutës së Malcís*”, Lamberci thekson: “*është vepra më e rëndësishme e letërsisë shqiptare. Epi është ngritur nga poezia popullore. Njëpërmjet teknikës epike të baladave dhe të rapsodive popullore, të cilat edhe sot jetojnë në malësitë shqiptare, poeti*



paraqet tridhjetë këngë, qenësinë dhe zhvillimin e popullit shqiptar" (f. 65).

Në Pjesën e tretë autori Berisha e ndriçon kontributin e Lamercin në fushën e letërsisë gojore shqipe. Interesimi i tij për lirikën tonë gojore dëshmohet qysh në vitin 1913 në librin për mësimin e shqipes bashkë me Gj. Pekmez, ku janë përfshirë tri lirika të marra nga përmbledhja e njohur e V. Prennushit "Kangë popullore gegnishte" (1911). Po ashtu, në punimin "Dialektet shqiptare në Itali" (1914) dhe në Raportin e studimeve gjuhësore në Shqipëri, botoi Akademia mbretërore e shkencave të Vjenës, Lamerci jep të dhëna për disa nga botimet më të rëndësishme të letërsisë gojore shqiptare duke filluar nga vepra e Hahnit [Studime shqiptare] (1853/1954 e deri te ajo e A. Skurës "Shqiptarët në Itali dhe këngët e tyre tradicionale" (1912). Mendimet më të rëndësishme për lirikën gojore shqiptare Lamerci shprehu në studimin e tij "Poezia popullore e shqiptarëve. Një studim hyrës".

Duke u marrë me epikën gojore Lamerci vlerëson se epika gojore e traditës shqiptare është një pasur e madhe që begaton epikën e këtij populli.

"Sot për sot po e jap fjalën e shpresës, që nëse edhe një herë bota do ta fitojë lirinë, nga qenësia e popullit shqiptar, ku ruhen aq thesare të lashta e të bukura, në këngë dhe në përralla, në gojëdhëna dhe besime popullore, shkenca do të nxjerrë po ashtu njohuri të çmueshme edhe mbi doke e zakone të popujve të tjerë indogjermanë" (f. 3).

M. Lamerci po ashtu është një studiues i thellë i përrallave dhe pothuajse kësaj fushe i është qasur me përkushtimin më të madh, me çrast edhe rezultatet karakterizojnë suksesin që ka arritur në këtë fushë të letërsisë gojore:

"Përrallat janë në njëfarë mënyrë Bibla e besimit popullor shqiptar, shprehje që dikur i moçmi i besonte, trembej, e donte, e çmonte të shenjtë" (f. 121).

Sipas autorit Berisha, puna e Lamercit me përrallën shqipe shtrihet në tri rrafsh kryesore: në mbledhjen e teksteve të përrallave shqiptare nga subjekte të ndryshëm Lamerci e nisi gjatë qëndrimit studimor në disa ngulime arbëreshe të Italisë në vitet 1913-1914, ndërsa nga viti 1916 vazhdoi mbledhjen e përrallave në Shqipërinë e veriut dhe në Shqipërinë e mesme (f. 121). Rreth këtij lloji letrar Lamercit boti: "Përralla shqiptare dhe tekste të tjera të folklorit shqiptar, Vjenë 1922, "Përralla nga Shqipëria", Lajcig 1922 dhe "Motra me krahë dhe errësira e tokës", Eisenach 1952.

Në kapitullin e katërt autori i flet për rëndësinë e librave gjuhësorë – mësimorë të shqipes të hartuara nga Lamerci, si dhe disa aspekte rreth përkthimeve të Lamercit nga shqipja në gjermanisht, ku veçon përkthimin e 20 këngëve kreshnike, përkthimi i plotë i "Lahutës së Malcis", përkthimi i një varg përrallash, kallëzimesh dhe anekdotash, si dhe pjesë të veprës së Jul Varibobës dhe dramën "Toka jonë" të Kolë Jakovës etj.

Studimi "Maksimilian Lamerci për letërsinë shqipe" i prof. dr. Anton Berishës është një vepër me vlera të veçanta për ndriçimin e thellë të veprimtarisë së gjerë të M. Lamercit në fushën e letërsisë shqipe. Ky libër është një vepër me vlerë që t'u hyjë në punë ligjëruese në fakultet, për studiuesit që synojnë të merren me albanologë të huaj që i dhanë një kontribut të madh studimeve albanistike.

Shkurt, 2024

## In memoriam

# JORGO PAPINGJI, BARDI I MADH I KËNGËS SHQIPTARE

Prof. dr. Bardhosh Gaçe



Ilindur në Vlorë dhe i mbetur vlonjat, Jorgo Papingji dukej se e kishte Vlorën një motiv të brendshëm, një frymë dhe "materie" frymëzimi, e sikur nga Vlora e tij niseshin dhe jetësoheshin të gjitha motivet që përcjellin poezitë e tij, të shndërruar në këngë të muzikës së lehtë. Atë kurrë s'e largoi koha nga mjedisi i shpenguar dhe i gjallë i qytetit të tij. Kujtoj shpesh, Jorgon kur vinte në Vlorë së bashku me poetin Dionis Qirinxiri dhe piktorin Nestor Jonuzi, fizikantin Petraq Truja nuk mund të mos shkonim në Ujin e Ftohtë, atje te shkëmbinjtë përballë detit dhe dallgëve dhe kaltërsisë së Jonit i buronin vargjet dhe poezia si një ujëvarë e freskët dhe përherë e rrjedhshme. Nga aty ku syri i tij shihte peizazhin më të mrekullueshëm të natyrës, projektoshin dhe jetësoheshin dhjetëra motive, që ai i kthente në vargje dhe në pantonima muzikore, duke i bërë skenat e festivaleve të mrekullueshme.

Jorgo Papingji është njëri nga personalitetet e kulturës dhe muzikës shqiptare, i cili për pjesën më të madhe të Festivalit të Këngës në Radio-Televizion ka përbërë imazhin më të mirë të kësaj tradite, e cila në rrjedhën e gati 30 e ca viteve krijoi identitetin e saj të shkëlqyer. I pasionuar, i talentuar, një njohës i kulturës dhe shoqërisë bashkëkohore, Papingji solli në skenat e festivaleve temat nga më të larmishmet dhe frymëzueset, këngëtare dhe këngëtarë nga më të spikaturit, po ashtu ai bashkëpunoi dhe krijoi në çdo rast një risi dhe gjetje muzikale me kompozitorët më të mirë të vendit.

Jorgo Papingji lindi në Vlorë më 10 qershor 1942. Ai është autor dhe poet shqiptar, i cili në "Festivalin i Këngës", "shpërblyer" me 5 këngë fituese, ndërsa kënga fituese e vitit 2014 është pjesëmarrëse në Festivalin Evropian të Këngës. I dekoruar me dekoratën Presidenciale "Mjeshtri i Madh", si poet Jorgo Papingji ka në arkivin e tij të shkruar mbi 4000 këngë, mjaft prej të cilave kanë marrë pjesë në Festivalin i Këngës në RTSH. Në kujtesën e adhuruesve dhe artistëve, muzikologëve, këngëtarëve dhe kompozitorëve të më shumë se një gjysmë shekulli, jehojnë ende këngë të tilla si: 1980 – "Kur jemi bashkë të dy" (kënduar nga Luan Zhegu); 1990 – "Askush s'do ta besoj" (kënduar nga Anita Bitri, fitues); 1991 – "Fat dhe jetë" (kënduar nga Anita Bitri); 1993 – "Kur e humba një dashuri" (kënduar nga Manjola Nallbani, fitues); 1993 – "Rri me mua" kënduar nga Mira Konçi; 1994 – "I thuaj jo" (kënduar nga Ardit Gjebrea); 1995 – "E doni dashurinë" (kënduar nga Luan Zhegu dhe Ledina Çelo); 1999 – "S'jam tribu" (kënduar nga Aurela Gaçe, fitues); 1999 – "Apokalipsi" (kënduar nga Irma dhe Eranda Libohova); 2001 – "Jetoj" (kënduar nga Aurela Gaçe, fitues); 2004 – "Hëna dhe yjtë dashurojnë" (kënduar nga Luiz Ejlli); 2005 – "E dua këngën" (kënduar nga Evis Mula); 2007 – "Po lind një yll" (kënduar nga Rosela Gjylbegu); 2009 – "Në pasqyrë" (kënduar nga Anjeza Shahini); 2010 – "Mirëbrëma engjëlli im" (kënduar nga Dorina Garuci); 2011 – "Këngën time merre vetë"

(kënduar nga Bashkim Alibali); 2011 – "Më lër të të dua" (kënduar nga Mariza Ikononi); 2012 – "Kush ta dha këtë emër" (kënduar nga Hersiana Matmuja); 2013 – "Zemërimi i një nate" kënduar nga Hersiana Matmuja, fitues); 2014 – "Vetëm te ti besoj" (kënduar nga Klajdi Musabelliu); Kënga Magjike 1999 – "Vetëm një fjalë" (kënduar nga Elsa Lila, fitues) dhe në Festivalin Evropian i Këngës; 2014 – "One Night's Anger" (kënduar nga Hersiana Matmuja).

Në një repertor mbi 4200 këngë, Jorgo Papingji, poeti dhe njeriu i lidhur fort me mjedisin kulturor, intelektual dhe social shqiptar, krijoi këngë dhe për fëmijë, dhe për këngëtarët popullore dhe për muzikën moderne krahas asaj të lehtë dhe pse në profesion ai është mësimdhënës, i një lënde specifike, fizikës. Ai tregon: "Jeta ime u përcaktua që në maturë, që më doli e drejta e studimit për mësuesi. Unë kam mbaruar shkencat e natyrës, për fizikë. Ishte një degë, që e fillova pa dëshirë fare, se e kisha mendjen për një degë tjetër, ishte elektronika dhe ishte hera e parë që ishte hapur. Fizika është një shkencë që ka ligjet e veta, që ka rregullsinë e vetë dhe duhet t'i lidhësh gjërat me njëra-tjetrën, t'i nxjerrësh konkluzionin. Edhe kënga kështu është, e fillon me strofë dhe pastaj vazhdon me refren.", thotë Papingji, kur pyetet për këtë të vërtetë jetësore të tij.

Poezia në jetën e tij, përveçse me qytetin e bukur të Vlorës, me të cilën ai mban lidhje në çdo moment, ka qenë gjithmonë brenda tij, si një gjendje e mrekullueshme meditimi, e gatshme për të shpërthyer, për të cilën ai thotë, se: "Unë kujtoj se ka qenë brenda meje, ka qenë e mbyllur dhe u krijua një mundësi që u hap dhe nuk u mbyll më kurrë. Pastaj filluan disa fletore shënimesh, kujtimesh dhe mbaj mend, që isha i vetmi që shkruaja kujtimesh në poezi", dhe pastaj: "Një ditë të bukur mu mbush mendja të shkruaja një këngë për Festivalin e Këngës në RTSH dhe ishte pjesëmarrja e parë e imja në festivalin e madh në radiotelevizion", ku merr rrjedhë një rrugëtim i gjatë jetësor, për t'i mbushur brezat rinore të vendit të tij me motive dhe me një

kujtesë brilante të këngëve të tij, shumicën e të cilave njerëzit i mbajnë përmendësh.

Mbi 4200 tekste këngësh, që Jorgo Papingji i dha këngës shqiptare dhe dhjetëra këngëtarësh nga të gjitha krahinat e vendit, e bëjnë atë një mjeshtër të poezisë, por dhe një njohës të shkëlqyer të kohës, pasi çdo këngë që i afrohet kohës mbart në vetvete thelbin e saj, qoftë kur ajo është një këngë e muzikës së lehtë, muzikës për fëmijë apo muzikës popullore. Jorgo Papingji e ka prekur të gjithë realitetin muzikor të gati 50 vjetëve. Në tekstet e këngëve të tij ka një ndjeshmëri interesante me mjedisin, njohjen e thellë të konstitucionit shpirtëror të njerëzve, veçmas kur bëhet fjalë për këngë që këndohen nga këngëtarët e muzikës popullore. Kolori që i përshkon këto këngë e bëjnë atë të ngrohtë dhe të afër me këdo që i dëgjon, duke qenë i thjeshtë dhe lirik, një mik i përhershëm dhe një njeri i thjeshtë.

Kënga "Më pëlqen të jem ashik" zbulon një mjedis të bukur popullor të Shqipërisë së Mesme, veçmas të Tiranës, një traditë e njohur bujarie dhe e një populli të prirë për bërë një jetë të lumtur dhe të gëzuar. Ahengu Tiranës është i bukur. Ai shoqërohet me një humor të bukur tradicional, siç e përshkon e gjithë kënga në fjalë, ku flitet për traditën (atë që i ka lënë plaku, d.m.th. të moshuarit apo babai), e cila shpërfaqet në të gjithë tekstin, përmes të së cilës poeti zbulon jetën e një tiranasit tradicional, të qejftit, këngës, rakisë dhe ahengut. Duke qenë një këngë e një mjedisi dasme apo mbremjeje ahengu, ajo intonon mrekullisht një muzikalitet të shtruar dhe komunikon, ku dashuria për aheng e pije ngjan si një dashuri për jetën. Fjala ashik, një fjalë fort e përmendur në trevën e Tiranës, mbledh të gjithë kuptimin që ajo përcjell në jetën e një banori të kësaj treve. Pija zgjon gëzim dhe harron vuajtjet, afron njerëzit dhe ditët e gëzimeve i bën të bukura.

Kënga "Robi plaket kur donë vet" është një komunikim më veten dhe të tjerët në një moshë jo të re. Poeti krijon një harmoni të mrekullueshme të rinisë dhe të moshës që e ndjek nga pas, si një ligj që nuk e ndalon asgjë. Përmes një lloj retrospektive, duke kujtuar rininë dhe atë që mendon një i ri, se ka gjithmonë një vrull të moshës së re që nuk e kupton pleqërinë, poeti gjen kohën dhe rastin ta thotë këtë, natyrisht si një dialektikë që se shmang dot njeriu.

Vargjet e poezisë i përshkon një humor i lehtë dhe mjaft i bukur, që në të vërtetë përcjell një shqetësim të brendshëm njerëzor, por që thërret së brendshmi, se njeriu duhet të jetojë i gëzuar, në humor dhe me njerëz. Të kujtosh rininë në një moshë të kaluar, do të thotë të mos e kujtosh vdekjen, se njeriu nuk plaket nga vitet, por nga mungesa e humorit dhe e pasionit për jetën. Moshë rinore përshkohet nga pasioni

Vijon në faqen 7



Gabriel Garcia Marquez një nga reportazhet e tij për Europën Lindore, e fillon kështu: "Perdja e hekurt nuk është as perde dhe as e hekurt. Është një pengesë prej druri të lyer me të kuqe e të bardhë, ashtu si reklamat e floktoreve". Pra, realiteti, në këndvështrimin e këtij shkrimtari-gazetar, përthyeret në një mënyrë tjetër. Faktet e detajet nga Berlina Lindor në vitet pesëdhjetë, një dekadë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ai i zhbiron sëbrendshmi. Te të gjitha reportazhet e librit "Udhëtim në Europën Lindore" (Botime "Onufri", 2016) rrëfimi, faktet japin një pasqyrë të botës lindore, pa censurë apo autocensurë. Imagjinoni një gazetar-shkrimtar shqiptar i para viteve nëntëdhjetë, të shprehej për "Perden e hekurt" si për "një tra të lyer me të kuqe e të bardhë, ashtu si reklamat e floktoreve".

Te parathënia e librit "Letërsia në rrezik" (Botimet "Buzuku", Prishtinë) studiuesi dhe teoricieni i njohur bullgar Tzvetan Todorov thekson se vetëm pasi jetoi dhe studioi në Francë, ku pak më vonë ndoqi edhe leksionet e kritikut të madh Roland Barthes, vetëm pas integritit të plotë dhe një pune të gjatë "dashuria ime për letërsinë nuk ishte më e kufizuar nga edukimi që kisha marrë në vendin tim totalitar".

Kufizimet e edukimit nga Koha, sistemi shoqëror, shkollimi, janë të natyrshme dhe ndryshojnë nga një vend në tjetrin, nga një brez në tjetrin, nga një individ të tjetri. Por edhe "çedukimi" nga kufizimet, zhveshja nga "këmisha e forcës", thyerja e enës deformuese të tipit "kompraçikos", janë procese tepër të vështira, sepse dhe këto varen nga shkallët e emancipimit të shoqërisë, nga niveli i lirisë dhe demokracisë së vendit të caktuar. Kjo vlen edhe për shkrimtarët si qytetarë të botës së lirë, dritësimi i të cilëve përcillet te lexuesit nëpërmjet veprave.

Milan Kundera në intervistën dhënë shkrimtarit amerikan Filip Roth shprehet se: "Botën mund ta kuptosh nëse e sheh nga kënde të ndryshme. Libri i fundit që shkrova në Francë, shpalo një hapësirë të veçantë gjeografike: ajo që ndodh në Pragë shihet me sytë e evropianëve perëndimorë, ndërkohë që çka ndodh në Francë shihet përmes syve të Pragës." Këtë e thotë Kundera, i cili romanin e famshëm "Shakaja" me temë kundër totalitarizmit, e shkruajti më 1967!


Në citimet e mësipërme, kupton përpjekjet dhe vështirësitë për ta njohur dhe kuptuar thellë jetën dhe të vërtetën në vendet e Europës Lindore dhe për ta përcjellë atë, nëpërmjet veprave, te lexuesit perëndimorë, ish-lindorë, apo edhe thjesht totalitarolindorë. Po shkrimtari që i ka përjetuar vetë faktet dhe realitetet e vendit të tij në dy sisteme, sa i sinqertë dhe transparent duhet të jetë duke u ballafaquar me të vërtetën? Si mund ta kapërcej ai pengesën e trarit të lyer kuq e bardhë, apo bardhë e zi?

Duke lexuar trilogjinë e Namik Dokles me tre romanet "Vajzat e mjegullës", "Lulet e skajbotës" dhe "Ditët e lakuriqëve të

## Duke lexuar romanet e shkrimtarit Namik Dokle

# PËRTHYERJA E REALITETIT PA THYER TË VËRTETËN

nga Petraq Risto



natës", por edhe tre romanet e rinj që pasuan trilogjinë, i ndjen përpjekjet e autorit që me narrativën e tij të zhdërvjellët ta pasqyrojë me vërtetësi realitetin apo realitetet në dy sistemet shoqërore. Këtu nuk flasim për përpjekjet e gjetjes së "mesit të artë", sepse Dokle është i qartë në formimin dhe reagimin e vet krijues; në romanet e tij ai tregohet i hapur, i guximshëm, akuzues, por edhe i sinqertë për moskundershtimin e totalitarizmit e diktaturës në kohën e duhur. Fatet e personazheve që shpesh janë realë e thuasht gjysmë të gatshëm nga JETA, e bëjnë autorin tepër transparent në bindjet dhe formimin e tij politik, kulturor dhe estetik.

Trilogjia mbështetet në një krahinë konkrete, Gorë, në Verilindje të Shqipërisë, dhe jo në një zonë me emër të shpikur siç bëri Folkneri me *Joknapatofën* dhe Markezi me *Makondon*. Natyrisht dhe Folkneri dhe Markezi, të dy nobelistë, në këto vende të shpikura kishin parasysh vendbanimet e tyre në ShBA dhe Kolumbi, por "për të luajtur" më shumë me realitetin, me përthyerjen e magjishme të jetës 'shpikën' këndvështrimin e rrezes që bie mbi lupë.

Dokle ka një prozë të veçantë, përgjithësisht me gjeografi dhe personazhe konkretë; në narrativën e tij të shkathët gëshetohen realiteti me magjinë. Rrëfimet mbështeten në fate tronditëse, dramatike e shpesh tragjike. Mjafton të shkëpusim vetëm pak rreshta nga hyrjet e romaneve për të kuptuar jo vetëm stilin, por edhe synimet estetike të autorit.

Fillimi i romanit "Vajzat e mjegullës":

"...Po shihja një ëndërr atë mëngjes të ftohtë dimri, kur dita ende kishte frikë të haptë sytë; një ëndërr të çuditshme që më kishte futur mornica në trup, megjithëse isha pranë një zjarri të madh. I prekja flakët me duar, afrohesha, por sa më shumë u avitesha, aq më tepër mërdhija. Hyra i tëri mes flakëve dhe përsëri asgjë, ftohtë... ftohtë. Në çastin kur u rrasa mes zjarrit të ftohtë, dëgjova piskamën që s'kuptohej nga vinte, nga toka apo nga qielli. Dola në kjustër (hajati) bash

kur u fikën të gjithë yjet nga frika e asaj ulërime therëse dhe dridhësi i tëri, pa kuptuar se ku kishte shkuar dera e dhomës. "Futu brenda shpejt!", më thurri babai dhe më tërhoqi si një trastë me bar të njomë. Nëna më mbuloi në shtrat me përkujdesje, por unë nuk u ikja dot të dridhurave që më ndiqnin nëpër trup, deri në brendësi të kraharorit. "Çfarë ishte?", pyeti nëna. "Arushat", tha babai. "Po vajtojnë nënën e vranë... do ta gjejë ndonjë bela këtë fshat që vrau arushën."

e-mail i Namikut: "I dashur Petraq, ky është romani i parë i triptikut tim për Gorën, krahina e origjinës sime. Ngjarjet zhvillohen në vitet pesëdhjetë. Pastaj vjen tjetri në vitet shtatëdhjetë dhe i treti në fund të nëntëdhjetës..."

"Namik, përshëndetje! Sapo e mbylla leximin e romanit "Vajzat e mjegullës". Urime!... Romani më pëlqen. Nisja është e mrekullueshme. Vrasja e arushës, skelat që mbetën gjithnjë të ngritura si një podium ku nesër do të pushkatohet mësuesi, është një simbol i gjetur, prolog-epilog domethënës. Ky roman i jep lexuesit shumë informacion për Gorën, për vuajtjet në ato vitet e para të pasqyrit... Një pyetje: po tani e shkruar pas gati tridhjetë vjetësh, (për pjesën e parë të trilogjisë) çfarë mendojnë goranët e tjerë (lexues)? Është realist? Është e vërtetë? A i ka ndodhur kjo vetë autorit?... Personazhet kryesorë që të nguliten në mendje marrin vlerë, sepse rrëfyesi është vëzhgues i hollë, i mënçur. Një fëmijë dhe adoleshent që i përjeton tepër emocionalisht situatat dhe bëhet promotor i zhdërvjellët i subjektit, që, edhe pse linear, ka një shkallëzim të vazhdueshëm, një konflikt-atmosferë që përfshinë të gjithë popullatën e Gorës. Veçanërisht në 100 faqet e para leximi të përpin; s'di pse mu kujtua "Njëqind vjet vetmi" e Markezit me atë Makondon e famshme të harruar në një cep të Botës. Figura e Majkës (treqind vjeçare), e xhaxhait, e mësuesit, e rrëfyesit, e mullixhiut, e nuses "macja-miu", e Hate-hetuesit e të tjera, të mbeten në mendje. Shumë histori, rrëfenja, anekdota të atij lokaliteti apo zone, ti i ke shkruar me finesë.


Gjuha është e pasur, rrjedhë e gurgullon. Një tjetër pyetje: Po mirë ato vajzat që nuk u kthyen nga aksioni, a kthehen në romanin e dytë?... Po me rrëfyesin adoleshent çfarë ndodh më vonë, ai bëhet disident apo zëvendëson mësuesin e vranë?... Mendoj se mund të shkëmbejmë mendime (tepër private) dhe pas kësaj letre të shkurtër, shkruar vetëm pak minuta pas përfundimit të romanit...

Nju Xhersi, 29 prill, 2020

Pyetjet që i bëj shkrimtarit Namik Dokle menjëherë pas leximit të librit të parë të trilogjisë, lindën mbase ngaqë ai nuk shpiku një emër imagjinar për krahinën e vet, pra, më shumë u vu në pozicionin e gazetarit – shkrimtar. Përgjigja e tij e menjëhershme më sqaroi dhe për këtë pozicion por, njëkohësisht, më hapi disa shtigje leximi për të ecur më i shpenguar, jo vetëm në realitetin konkret, por edhe në atë të trilluar prej tij.

Tiranë, 29 prill 2020

Të falenderoj shumë për fjalët e mira për romanin. Sidomos për analizën e vlerave artistike, personazheve, gjuhës etj. Dhe më vjen mirë që mendimet e tua përputhen plotësisht me ato të autorëve të tjerë që kanë analizuar romanin, si në Shqipëri dhe jashtë... Për të mos e zgjatur, po të them që njeri nga artikujt e botuar për romanin, në Sarajevë, është titulluar: "Makondo e Dokles". Por më të rëndësishme për mua janë pyetjet që të kanë lindur gjatë leximit... Së pari, shumica e ngjarjeve janë thuasht reale, të ndodhura në kohën e fëmijërisë sime, një pjesë të të cilave i kujtoja vetë, ndërsa pjesa tjetër janë shkruar nga xhaxhai im, i cili ka mbajtur një ditar sekret për 20 vjet (1949 deri 1969), të cilin vetëm mua ma kishte dhënë ta lexoj... Pjesa e përfshirë në roman është vetëm një copëz e ditarit prej 500-600 faqesh. Dhe tash natyrisht vijmë te pyetja jote mbi raportin e perceptimit para dhe pas viteve nëntëdhjetë... E di si ndodhte, i dashur Petraq? Ato që kam shkruar i ndjeja edhe më parë, por nuk i shkruaja dot, ashtu ishte koha dhe



ne nuk kishim lindur disidentë (megjithëse në ato vite më ndaluan tre drama të bëra gati për në skenë). Dhe ndodhte me ne, si me xhaxhain tim: ai ishte një kooperativist i mirë, por mbante ditarin sekret, dhe, si murator që ishte, në shumë nga muret që ndërtonte, shkruante diçka, e fuste në një shishe dhe e muroste. Pas vdekjes së tij, në fshat u ndërtua xhamia e re dhe kur u prishën muret e saj u gjet një nga shishet e tij, me letrën e shkruar më 23 gusht 1967, të cilën e përfundon kështu: "Ky shtet na ka marrë gjithë tokën, na ka lënë vetëm nga një dynym, na ka marrë bagëtitë, na ka marrë gjithë pasurinë dhe na ka lënë vetëm me duart bosh." Brenda trupit tonë jetonin dy njerëz. Goranët që e kanë lexuar romanin e kanë vlerësuar si shumë realist... Ajo që më kënaq është se shumë nga kritikët kanë thënë që "në këtë roman, nëpërmjet një kronike familjare, autori end sagën jo vetëm të një fshati, por të një populli të tërë". (Adijata Ibrishimović, profesore e letërsisë së krahasuar në universitetin e Sarajevës)

Përgjigja e pyetjes ç'ndodh me personazhet në dy romanet e tjerë, nuk do të të kënaq. Pse? Unë i kam konceptuar tre romanet si një triptik, të cilët i bashkon krahina ku ndodhin ngjarjet, por jo edhe vazhdimi i jetës së personazheve, ata nuk përsëriten, përmenden aty - këtu dhe kaq; në dy romanet e tjerë veprojnë personazhe të tjerë. Unë vazhdoj ta konsideroj si triptik, por disa nga kritikët, këtu dhe në Sarajevë, e kanë konsideruar si trilogji, sepse është vazhdim i të njëjtit areal dhe fatësh njerëzore, por nën "lëkurën" e personazheve të tjerë.

Fillimi i romanit "Lulet e skajbotës":  
 "Katër burra e ngritën arkemortin mbi supë. Ende nuk i kishin bërë dy hapa drejt derës, kur dhoma e të vdekurit u thye në mijëra copëra të qelqta nga vajulurima e një vajze.  
 "Jo, jooool! Dua ta shoh edhe një herë! Mos ma merrni... moool!" Ishte motra binjake e të vdekurit. Katër burrat nuk lëvizën nga vendi, kishin ngrirë me vdekjen ndër duar. Ndërta gratë dukeshin si të marmarosura prej zanave të malit. Kufomën e kishin sjellë nga një shtet i huaj, një ditë më parë, në të errur.  
 "Mirë është ta varrosim sa më shpejt, ka ndërruar dy avionë deri në Shqipëri", thanë ata që e sollën."

Vazhdimi është një grotesk tragjik: me ngulmimin e motrës, Jetmirës, e hapin arkemortin dhe shohin se kufoma ishte e një emigranti tjetër që rastësisht kishte të njëtin emër e mbiemër... Dhe Jetmira vihet në kërkim të vëllait (agjallëavdekur)... Po vëllai, Petrit Kallabaku, në të njëjtën kohë kthehet në fshat i gjallë, i gatshëm të përballojë ritmin e romanit që, brenda gjashtë ditëve, përmbledhë jetë dhe histori sa për gjashtëqind ditë. Si te "Vajzat e mjegullës", edhe te "Lulet e skajbotës" rrëfimi ka ritëm, kohezion, vërtetësi, magji, gjuhë të pasur. Personazhi i Çopurit, "çmontuesit të varrezës" për të fituar zha-vorr, 'paskanikut të ri' që bën ligjin poshtëllart, është vizatuar me mjeshtëri, duke na dhënë në njëfarë mënyre dhe një prototip të të fortëve 'me rrënjët lart'.



Subjekte të shumta, limfë jete, histori të vjetra e të reja, lulëzojnë në Skajbotë, "në fshatin ku dielli lind dy herë në ditë e hana perëndon dy herë në natë..." Dhe te "Lulet e skajbotës" autori na e hap mjegullën si perden e një drame. Herë me ngjyra të errëta, herë me një dritë të brendshme shprese, jepen situatat nga fshati thuajse i braktisur, me djemtë e ikur në emigracion, me fatet e vazhde që tashmë detyrohen t'u ikin rregullave e kanuneve e të rrokullisen maleve si gurë, apo të zënë vend edhe jashtë sinoreve të fshatit. Natyrisht, edhe te ky roman, nuk mungon atmosfera e gëzimeve, dashurive të reja, dasmave, që dora mjeshtërore e shkrimtarit i jep me freski, gjallëri e ngjyrimë festive.

"Makina e internimit qëndroi poshtë dritares. Për një imtëkohë ai e mbërtheu vështrimin në anzat e shtrembëruara të saj, pastaj ngriti sytë drejt qiellit dhe pa një kuqëlimë verdhane, që i ngjau si gjak i përzier me qelb. Një qetësi e rrejtshme po e vriste brenda vetes dhe ai nuk arriti të lëvrinte asnjë qelizë të trurit, të paktën sa për të menduar diçka për atë mëngjes të qelbëzuar. Asgjë."  
 (Fillimi i romanit "Ditët e lakuriqëve të natës")

Pas leximit të trilogjisë së Dokles, e ndjen "përthyerjen" e gazetarit - shkrimtar, e ngjashme kjo me përthyerjen e dritës në vartësi të ndryshimit të shpejtësisë së saj, si dhe të dendësisë së mjedisit (në këtë rast të Mjegullës) në hapësirat që përshkon. Te trilogjia dhe veçanërisht te romanet pasues, përthyerja është më e fortë ngaqë dendësia e ngjarjeve është më e madhe se Mjegulla. Kur them "përthyerja" dua të theksoj detyrën e vështirësitë e shkrimtarit për të përshkruar realitetin dhe të vërtetën me shpejtësi më të madhe iluminimi, me guxim qytetar, ndërgjegje të pastër dhe ndershmëri perceptimi. Duke i përshkuar dhe përshkruar realitetet Dje dhe Sot (pra, para dhe pas viteve nëntëdhjetë) kupton reagimin e fuqishëm ndaj realiteteve konkretë (si gazetar) dhe imagjinare (si shkrimtar) në të dyja sistemet. Te trilogjia përgjithësisht ngjarjet përfshijnë histori, legjenda dhe jetë (shumë jetë!) nga krahina e Gorës, por personazhet lëvizin edhe jashtë kufijve të Shqipërisë së sotme: në Sarajevë, Kosovë, Athinë, Paris, Spanjë, etj. Kjo shtrirje gjeografike i jep veprës në tërësi më shumë gjallëri, intensitet, qoftë në temat që trajtohen, qoftë në gdhendjen e personazheve në situata të ndryshme dhe në hapësira më të gjera se fshatrat e një krahine. Triptiku për Gorën është vërtet një vlerë në letërsinë e sotme shqipe.

"Javën e tretë, pas vrasjes së Poetit, erdhi motra e tij. Për ta thënë më saktë erdhi ditën e gjashtëmbëdhjetë. Do të mblidhte ato pak gjëra që kishin mbetur në dhomën e vogël, ku patëm ndenjur bashkë në gjashtë muajt e fundit të jetës së tij. Unë shkoja çdo mëngjes ose mbrëmje tek udhëkryqi ku qe varrosur për herë të parë dhe ku murana me gurët e hedhur nga njerëzit rritej çdo mëngjes e mbrëmje. Por atë ditë e gjeta të rrafshuar. Dikush para meje kishte shkuar atje dhe i kishte shpërndarë gurët në të katërta anët e udhëkryqit.  
 "Varrin ia zhdukën, tani as muranën nuk duan t'ia lënë!", mendova dhe nuk e di pse m'u përfytyrua një njeri i mbuluar me zhgun të zi, supekërrusur si ariu kur ngrihet mbi këmbët e para, që vinte çdo natë aty për të zhdukur muranën e Poetit. Kur përpiqesha të sillja në sytë e mi fytyrën e atij njeriu me zhgun, gjithnjë më fanitej balli i brazduar i atij që urdhëroi skuadrën e pushkatimit... Zjarr! Dhe trupi i Poetit që po binte, duke mbështetur paksa kokën në murin e rrënuar dhe pastaj mbi një baltë të përzier me borë."  
 (Fillimi i romanit "Kolerë në kohën e dashurisë")

Te "Kolerë në kohën e dashurisë", autori 'përthyen' titullin e romanit të famshëm të Markezit, për ti dhënë veprës, që në titull, një forcë më të madhe goditëse. Pavarësisht se në këtë roman dalin në skenë personazhe të rinj, të panjohur më parë në trilogji, vazhdojnë të

veprojnë edhe personazhet e mëparshëm (mësuesi - poet i pushkatuar, etj.) kështu që trilogjia 'kërkon' të kthehet në tetralogji, pra, në katër vëllime, në katër drama apo katër tragjedi.

Te veprat "Kolerë në kohë të dashurisë", "Covid 1984" dhe "Dhjetë gramë nder" gjejmë personazhe, fate, legjenda, proverba, gjurmë dhe jehonë nga Trilogjia e Gorës. Bashkimi me to i librit të shtatë "Vallëzim me Hënë" që pritet të publikohet së shpejti po nga "Toena", i jep kësaj sage një pamje të plotë.

"Tani sapo e mbylla romanin tënd të ri "Covid 1984". Më pëlqen stili, narrativa e zhdërvjellët, gjuha e pasur, galeria e personazheve. Fitimi, Petro, Azizja, Borjana etj. janë vizatuar qartë. Ka dhembje dhe grotesk në fatet e tyre... Jam i bindur që po shkruan një roman tjetër. Uroj që viti i ri 2023 të sjellë vepra të reja, suksese të reja!  
 New Jersey, 28 dhjetor, 2022

"Dje në darkë e përfundova romanin tënd "Dhjetë gramë nder". Urime për veprën e re cilësore... Personazhi i Bajro Jellës, i cili shumë mendime dhe protesta i shkruan dhe i fshih në shishe e pastaj i murosë atje ku punon si ndërtesë apo riparues muresh, është mjaft interesant. Kemi folur edhe më parë posaçërisht për këtë ngjarje të vërtetë. Mendoj se në këtë roman me gjetje të veçantë ky subjekt përshtatet mjaft mirë. Mbase në këtë rast, sipas meje, do ishte më tërheqës po të kishte më tepër magji, përshembull ngaqë shisheet e mesazheve janë prej qelqi, në mure sythojnë dritare të vogla dhe disa nga banorët, (vetëm ata që janë në një gjatësi vale me Bajro Jellën), arrijnë ti lexojnë mesazhet dhe kodet, madje natën shumë mure ndriçojnë, bëhen të tejdukshëm. Bajro nuk duhet të marrë vetëm rolin e një denoncuesi të fshehtë, por edhe rolin e profetit. Kështu autori mundet që ti shprehë më drejtpërdrejt dhe hapur idetë dhe synimet e veta. Vepra të tilla si "Metamorfoza" e Kafkës, "Vjeshta e Patriarkut" e Markezit, "Pallati i ëndrrave" i Kadaresë, "Manteli" apo "Hunda" të Gogolit e shumë të tjera, e shkrijnë magjinë te realiteti. Nuk dua të citoj kapituj apo fragmente nga romani yt i ri që më kanë lënë mbresa të veçanta, ngaqë edhe nuk dua të zgjatem, po mbase jo shumë larg do ulem të shkruaj një ese të gjerë për romanet e tu që, për mendimin tim, po zënë një vend të dukshëm në prurjen elitare të shkrimtarëve të sotëm..."

Nju Xhersi, 6 dhjetor, 2023

Në tërësi mendoj se te saga e Dokles duhen veçuar gjetjet origjinale, gërshetimi me finesë i realitetit me fantastikën, narrativa e shkathët dhe gjuha e pasur. N. Dokle ka shkruar dhe i janë vënë në skena rreth njëzet drama e radiodramatizime, përvojë që natyrisht i ka shërbyer edhe në ngrehinën e kësaj sage, për ti dhënë më shumë ritëm, tension të brendshëm, dialog të shkathët, shpesh me densitetin dhe urtësinë e proverbase. Te disa romane i kupton edhe kapitujt ku "kanë bujtur" dramati i tij. Përzierja e kufijve të jetës dhe vdekjes, dashurisë dhe urretjtjes, të shkuarës dhe të sotmes, realitetit dhe magjisë, gjithçka vihet natyrshëm në shërbim të romaneve të trilogjisë, por edhe të tre romaneve pasues. Duket se bashkëpunimi i autorit me shtëpinë botuese "Toena" ka qenë tepër i frytshëm dhe e ka ndihmuar shkrimtarin të shpejtoj ritmin e krijimtarisë.  
 Përkthimi dhe botimi i disa romaneve në Spanjë, Angli, Bosnje, Turqi etj. dhe suksesi i tyre, flet dhe njëherë për vlerat e prozës së Namik Dokles. Shkrimtari është në kulmin e krijimtarisë së tij dhe lexuesit presin që 'rrezja e dritës dokleane' të përshkojë me shpejtësi dhe "Mjegulla" të tjerë.

Vijon nga faqja 5

për dashuri, për gaz dhe hare, një motiv për të mbetur gjithmonë i ri. Kënga pëlqehet në mjediset popullore.

Këngën "Asgjë nuk është si më parë" e përshkon një poetikë e lëvizjes së kohës, njerëzve dhe rëndësisë së gjërave. Në thelb dialektika është e tillë, gjërat ia lëshojnë vendin njëra-tjetrës. E ndërtaur mbi një dialog, i cili zbërthen shpirtin e një djali apo vajze në kërkim të partnerit apo partneres, poezia është një himn për dashurinë, e cila është një ushqim i çdo momenti për njeriun, ku njëri me tjetrin (ai me atë) plotësojnë njëri-tjetrin. Gjërat pa dashuri janë pa kuptim, thotë diku poeti, një dashuri që e tejkalon raportin intim që zakonisht zgjon një mesnatë larg njeriut që do. Komunikimi përmes këngës, se "sa herë të dëgjosh këtë këngë unë do të jem aty", e shenjtëron dashurinë, një burim jetësor që plotëson vetveten në dhimbje kur mungon dhe në dashuri kur është pranë. Në thelb, poezia e këngës "Asgjë nuk është si më parë", mbart idenë se gjërat janë të ndryshueshme në kohë.

Poezia e këngës "Lauresha e Shkodrës" i kushtohet këngëtares së njohur, Luçie Miloti, një nga më të njohurat e këngës popullore shkodrane, të njohura ndryshe si "ariet shkodrane". Poeti e adhuron këngëtares e njohur, e ajo ngjan me Rozafën, një kala e cila është si nëna e të gjithë gjërave të çmuara që lind dhe rrit Shkodra. Luçia është në çdo derë, aheng, gëzim dhe shpirt shkodrani. E bukur, perëndeshë e këngës dhe zë i papërsëritshëm në këngën popullore shkodrane dhe atë shqiptare, zërin, kujtimin, hirin dhe nurin e të cilës e njeh mali dhe fusha, qyteti dhe fshati. E kështu ajo nuk vdes kurrë, nëse nuk e gjen në Shkodrën Loce do ta gesh në Shirokë, në Va Dejës apo në Koplik. Kënga e saj është si një perëndi e mirë, ngjall gëzim e shpresë. Ata i këndon e gjithë Shqipëria nga Shkodra në Sarandë.

"Lind një këngë" është poezia e një kënge të lehtë, e bukur dhe shumë shprehëse. Poezia e këngës ngjan me një rrëfim të sinqertë, përmes të cilit poeti tregon se ç'është dhe nga lind një këngë. I thotë të gjitha, ndoshta të gjitha burimet emocionale që e kanë ushqyer poezinë e këngëve të tij, që nga lindja e një fëmije, një dashuri, ëndrrat, deti, pranvera, një lule, një rrahje zemre, era nëpër degë, të gjitha janë burimet e këngës, pra, thënë ndryshe natyra dhe njeriu.

Është ndoshta poezia përmes të cilës mund të kuptosh shpirtin lirik dhe të ndjeshëm të poetit, i cili ngjan të jetë kaq delikat dhe komunikues me natyrën dhe ndjenjat.

Poezia e këngës "Mos më gënje" është një realitet që ndodh sot, siç ka ndodhur gjithmonë. Duke pasur një ndjesi të thellë, përmes të cilës shprehet dashuria, shenjtëria që e përcjell atë në jetën e njeriut, dy vargjet e para të këngës (poezisë), si: "Mos më gënje, mos më gënje./ Të lutem shpirti im", duket se përcjell të gjithë mesazhin që përcjell kënga dhe poezia. Dashuria është e bukur për aq kohë sa ajo është e pastër, ajo është një marrëdhënie njerëzore, e cila në të shumtën e rasteve është burim jete, nëse ajo nuk mbart vlerat e shenjtërisë së saj, sinqeritetin dhe pastërtinë, ajo humbet vlerën, se "Në dashuri gënjeshtra s'ka kuptim...". Dhe pse poeti duket se merret me një ngjarje të zakonshme që ndodh në jo pak raste, poezia në të vërtetë është himni i dashurisë, parë nga pozitat e një pasaje që krijon një dashuri e humbur, e cila kuptohet që në vargun e parë të poezisë, që lutja "mos më gënje, shpirti im...", si pika më e lartë e një marrëdhënie mes dy njerëzve, poeti thotë "shpirti im!".

Gati si një moment intimiteti lidhur me muzën e tij, ai thotë, se nëse vetë rri në Tiranë, mendja i rri në Vlorë, ku kurrë nuk harron të kalojë verën e bukur joniane. Me një sinqeritet të brishtë ai tregon një rast: "Pas pak kohësh do m vij dhe vajza ime që jeton jashtë dhe do të shkojmë të gjithë me pushime në Vlorë, por ama unë kudo që shkoj kam me vete një stilolaps, syzet dhe një bllok shënimesh. Nuk shkëputem nga shkrimi, kudo ka impresion, kështu që unë shkruaj vargje gjithmonë", ndërsa këtë raport të përjetshëm, ai e përmbush me një batutë të shkëlqyer, me të cilën përmbledh jetën e tij, poezinë, dashurinë për njerëzit dhe vendlindjen, vështirësitë që e kanë shoqëruar jetën e tij, ku thotë: "Unë do të plakem kur të dua vetë!". E përkryer për një shpirt të madh lirik, por dhe një sfidues të njohur.

Tiranë-Vlorë, mars 2024

Së pari, dëshiroj ta përgëzoj zotin Stavri J. Dajo për punët dhe përkthimet e mira që ka kryer në rrjedhë të viteve dhe, si një nga ata që kam pasur edhe rastin e mirë ta njoh e të kem parë edhe si ka punuar e punon në Selanik, në IMH (Instituti i Studimeve Ballkanike), ku ka dhënë me shumë sukses edhe mësimin e gjuhës shqipe, qysh para se të themelohej atje një katedër e shqipes, madje, mund të pohoj se ai ka punuar në atë mënyrë që edhe e ka bërë të mundshme, më vonë, krijimin e saj, sikundër është tashmë atje, lektorati i shqipes në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Institutit të Gjuhëve të Huaja të Selanikut.

Pra, sidomos për ata që mund të mos e dinë (ose e dinë vetëm pjesërisht) se kush është Stavri Dajo, po lejohej, si lexues e si mik i tij, të them disa fjalë kryesisht me vlerë përnjohëse e të përgjithshme, natyrisht edhe të përditësuar me mbërritjet e botimitet e tij të kohëve të fundit, që, si të thuash, mbërrijnë në një pikë të lartë me botimin e "Proza tregimtare greke", "Litetratus", 2023, f.529.

Stavri Dajo ka lindur në Gjirokastrë. Ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Historisë e Filologjisë (Dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe) dhe është doktoruar për histori në Departamentin e Historisë dhe Arkeologjisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit "Aristoteli" të Selanikut. Është profesor në Departamentin e Gjuhëve të Huaja të Institutit të Studimeve Ballkanologjike (IMXA) në Selanik dhe në Kolegjin Universitar «Logos» në Tiranë. Vëmendja e tij kërkimore dhe shkencore bazohet në studimin e marrëdhënëve ndërballkanike, në marrëdhëniet e Greqisë me tre fqinjët veriorë dhe, në veçanti, në faktorin shqiptar në zhvillimet ballkanike. Ai është marrë me mbledhjen e letërsisë gojore të minoritetit grek dhe me studimin e traditës popullore të rajonit. Është autor i teksteve për mësimdhënien e greqishtes së re për shqipfolësit dhe shqipes për greqishtfolësit.

Ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare dhe projekte kërkimore shkencore për historinë, gjuhësinë, letërsinë e vendeve të Ballkanit dhe përkthimin me një vepër të pasur bibliografike. Ka botuar disa vëllime me studime dhe ese: *Çështja shkollore e minoritetit grek (1925-1945): Nga arkivat shqiptare*. Literatus: Selanik, 2022. (e-libër); *Duke ndjekur makthe: Të arratisurit politikë shqiptarë në Greqi (1945-1991)*. Literatus: Selanik, 2021; *Nikos Zachariadis-Enver Hoxha: Bashkëpunimi dhe marrëveshjet sekrete të PKG me Shqipërinë (1943-1974)*. Literatus: Selanik, 2019; *Refugjatët grekë në Shqipëri*. Literatus: Selanik, 2017; *Nikos Akrivogiannis dhe gjyqi i pilotëve: Një dosje sekrete shqiptare*. Literatus: Selanik, 2017; *Greqia dhe Shqipëria, 50 vjet mosbesim të ndërsjellë: Marrëdhëniet dypalëshe dhe pakica kombëtare greke*. Literatus: Selanik, 2015; *Dimensioni ndërkombëtar i konfliktit E. Hoxha - J. B. Tito dhe mbarimi i Luftës Civile Greke*. Selanik: Observer, 2004; *Kombi i patrahëguar: Letërsia popullore e minoritetit grek*. Selanik: Kyromanos, 1997.

Stavri J. Dajo është, gjithashtu, autor i disa teksteve mësimore, si: "Shqipja për greqishtfolësit", Vëllimi I (A1-A2). Literatus: Selanik, 2022; "Shqipja për greqishtfolësit", Vëllimi II (B1-B2). Literatus: Selanik, 2022. "Greqishtja e re për shqipfolësit". Literatus: Selanik, 2021.

Ai është edhe bashkautor në disa punime kolektive, si: "Greqia dhe Shqipëria në Luftën e Ftohtë". Athinë: Aleksandri, 2021; "Lufta Civile Greke, Një Vlerësim: Implikime Politike, Ideologjike, Historiografike". Elinika Grammata: Athinë, 2007. Stavri Dajo është pronar i qendrës së aplikimeve gjuhësore dhe botimeve "Literatus" në Selanik. Ai është edhe anëtar Shoqatës së

"Proza tregimtare greke"-Përgatitur nga Stavri J. Dajo, botim i "Litetratus", 2023, f.529

# NJË ANTOLOGJI ME VLERA LETRARE DHE HISTORIKE- BIBLIOGRAFIKE

Nga Akad. Gjovalin Shkurtaj

krijuesve të Selanikut "Dega e Blertë".

Si përkthyes letrar, ai ka përkthyer me sukses vepra të letërsisë greke në shqip dhe anasjelltas. Përmendim, kryekreje, se Stavri J. Dajo ka shqipëruar me sukses kryeveprën "Jeta e Aleksis Zorba" të Nikos Kazantzakis (Botimi i 1-rë 1996, botimi i 2-të 2001 dhe botimi i tretë më 2016), e vlerësuar më të drejtë si punë shumë e kujdesshme dhe e zellshme, po edhe për cilësinë e shqipërimit e për pasurinë leksikore të shqipes; mbahet si përkthimi më i mirë letrar i veprave të letërsisë greke në shqip. Përmendim, gjithashtu, "Të jesh i bukur dhe të vdesësh", novelë nga Kostis Palamas, Literatus: Selanik, 2016.

Stavri J. Dajo është tashmë i mirënjohur në përkthimin e veprave letrare nga poetë, prozatorë, shkrimtarë e nobelistë të tjerë grekë dhe qipriotë. Ka përkthyer, gjithashtu, dhe shkrimtarë shqiptarë në greqisht. "Një grua nga Tirana", roman i Helena Gushi-Kadare. Athinë: Ikistos Protos, 1999; "Enigma", poezi nga Yllka R. Imeri. Literatus: Selanik, 2018. Përkthime që dëshmojnë më së miri se, krahas Perikli Jorgonit, Niko Kacalidhës, Robert Goros, Luan Zykës, por edhe më të hershmit, Spiro Comora, Aleks Çaçi, e deri tek Nonda Bulka, Stavri Dajo ka krijuar profilin e tij të veçantë, duke zotëruar e folur mirë edhe anglishten, italishten e frëngjishten.

Nisma të tij të guximshme ishin dhe dy përkthime veprash antologjike në të cilat morën pjesë dhe shumë krijues të tjerë të diasporës shqiptare në Greqi: "Antologji e poezisë qipriote". Tiranë: Albin, 2000; "Antologjia e tregimit qipriot", Tiranë: Albin, 2003; "Antologji e prozës tregimtare ballkanike". Literatus: Selanik, 2020.

Stavri J. Dajo, si studiues, përkthyes dhe intelektual i njohur, bashkëpunon me shtypin prestigjioz shqiptar dhe grek, ndërsa shpesh diskuton në mënyrë aktive në emisione të veçanta në kanale televizive greke dhe shqiptare duke dhënë mendime për çështje të ndryshme historike, të emigracionit, marrëdhëniet mes dy vendeve fqinjë, me akte e dokumente historike për periudha e kohë të ndryshme, për çështje të letërsisë shqiptare të diasporës, të gjuhës shqipe dhe asaj greke etj. Mendimet dhe ndihmesën e tij intelektualë e ka dhënë dhe për organizime shtetërore e bamirëse në Shqipëri, Kosovë, FYROM.

Sa herë ka qenë rasti, dr. Stavri J. Dajo nuk ka mënuar të dalë në mbrojtje të shqipes standarde dhe ka dhënë mendime të vëra për të kuptuarit dhe të vlerësuarit drejt të shqipes si tipari themelor i shprehjes dhe i mishërimit artistik të veprave letrare, shkencore dhe ditunore, po edhe si tregues i nivelit të ngritur të kulturës shprehëse të kombit. Na duket me vend të theksjmë se, edhe në edhe Parathënien e antologjisë "Proza tregimtare Greke", ka një syth mjaft interesant "Gjuha objektiv: gegërishtja, toskërishtja apo standardi shqip", ku shprehet, qoftë edhe shkurt, por me

qartësi e rëndësi, koncepti i drejtë i këtij shqipëruesi e studiuesi për rrugën historike të përkthimeve nga greqishtja në shqipen, qysh "para se të institucionalizohej koineja letrare e sotme, qysh kur shqipja shkruhej dhe flitej në të dy kryedialektet; letërsia dhe përkthimet po ashtu. Ne kemi përmbledhur me ndërgjegje përkthime nga të dyja kryedialektet, toskë dhe gegë." Në vijim, mbasi sjell edhe shembuj konkretë nga përkthimi i të njëjtit autor në dy variantet letrare të shqipes nga dy shqipëruesi të ndryshëm, zoti Dajo përmbyll me këtë vlerësim pa dyshim të urtë e të dobishëm edhe për më tej: "Në këtë prizëm shfrytëzimi dhe rijetësimi në fondin themelor të fjalorit i njëjtit leksikore dhe frazeologjike apo lokucioneve nga gurra e leksikut gegë në stilin libror (pse jo edhe i trajtave morfologjike të saj), të cilat mbetën të fosilizuata ose janë lënë në harresë, agjë të keqe nuk do t'i sillte koinesë letrare shqipe, përkundrazi." Mendim që, pa dyshim, është i drejtë dhe që, ashtu si e ka shprehur edhe vetë zoti Dajo, "ky botim antologjik mund të shërbejë edhe si laborator për përkthyesit e rinj të letërsisë, pasi akumulon një përvojë gati shekullore në përkthimin e letërsisë artistike greke." (f.30)

Disa vjet më parë, kur po në këtë mjedis të Bibliotekës Kombëtare qenë përruar librat "Zorba" të Nikos Kazantzakis dhe "Të jesh i bukur dhe të vdesësh" të Kostis Palamas, përkthyer nga Stavri J. Dajo, botuar nga "Literatus" kam shprehur vlerësimin tim dhe, mbi të gjitha, kënaqësinë estetike e shijën e mirë që kisha ndërë duke i lexuar ata dy libra. Dhe, kur i kam lexuar, kam shkruar me kënaqësi se përkthimet e Stavrit ndjekin hullinë e mbarë të themelënësve të përkthimit si art i fjalës (që nga Gjon Buzuku, te Konstantin Kristoforidhi, Fan Noli, Dom Simon Filipaj etj.) na ftojnë të shmangen përkthimet sa për të kryer punë, pa art e pa përgjegjësi.

Hera e mbarë e pruri që Stavri Dajo, duke e vijuar me përkushtim të adhureshëm punën e tij si përkthyes, po mbi të gjitha, duke ia prirë kësaj pune me një zotësi e hapësirë të gjerë njohëse të prozës së sotme greke, do të na jepte një vepër të madhe e të mirëseardhur: "Proza tregimtare greke"-Botim antologjik dhe bibliografik, një libër prej plot 529 faqesh, të cilin, ashtu si dhe botime të tij të mëhershme, miku im i nderuar, ma dërgoi me kohë dhe më ftoi të isha sot në këtë përrurim, pak të thuash të gëzueshëm.

Në këtë Antologji janë përzgjedhur e përfshirë tregime të prozës greke të përkthyer qysh në vitet para Luftës së Dytë Botërore, herë me emra të shqipëruesve, herë pa emër, por që nuk mund të mos përfillehin, pastaj, sipas periudhave historike: Periudha para-përkthimore 1827-1896; Periudha 1895-1911; Periudha 1911-1945; Periudha 1945-1990; Periudha 1990-2023. Kësaj periudhe të mbrame, i përkasin edhe përkthimet e një sasive të mirë faqesh të



kësaj antologjie, shumica të përkthyer nga Stavri J. Dajo, krahas një yjësie shqipëruesish të njohur (të cilët po i përmendim në rendin që kanë pjesët e përkthyerat prej tyre në antoogji), si: P. Begu (pseudonim i Sterjo Spasses), Vasil Koçi, Telemak Koça, Niko Kacallidha, Mirela Xhaferraj, Spiro Xha, Jani Malo, Natasha Kseno, Llambro Ruci, P. Gjemi (pseudonim i Pandeli Martinjanit), Irena Rafti-Andruc, Maklena F. Nika, Romeo Çollaku, P. Ç. (pseudonim i Spiro Çomorës), Iliaz Bobaj, Enver Fico, Elvis Bramo, Eleana Zhako, Aleks Çaçi, Petro Marko, Kristo Çakuli, Anthulla Kristo, Jasmina Kotrri, Mina Qirici, Vita (pseudonim i pidentifikuar), Kleo Lati, Robert Goro, Milto Likoka, Aristotel Spiro, Dhimitër Falo, Vasil Xhaçka, Sokol Çunga.

Para se të shpreh vlerësimet e mia për krejt sa nden kjo antologji, po lejohej të shpreh, së pari, disa vlerësime për Stavrin si përkthyes dorëmbarë e të atillë që shkon krahas me më të mirët përkthyes që ka pasur gjuha shqipe. E kam thënë e shkruar edhe një herë tjetër, po da ta ritheksoj e do ta përforcoj idenë time se përkthimet e Stavri J. Dajos, bashkë me përkthimet më të mira të yjësive të përkthyesve shqiptarë e albanologëve të huaj, që po shtohen (dhe u shtofshin), krahas vlerave mirëfilli letrare a artistike, kanë edhe një vlerë shumë të madhe për gjuhën shqipe: për t'ia shtuar horet e saj nëpërmjet kundruallësisë e përbalimit të përkthimit në shqip të veprave të mëdha të letërsisë e të mendimit shkencor botëror, po edhe, kur përkthimi është nga shqipja në gjuhë të huaja, për t'ia shtuar kufijtë e njohjes letërsisë shqiptare e mendimit shkencor të shqiptarëve. Prandaj, kur shkruajmë e flasim për përkthimet, mendoj se është mirë që, pavarësisht nga koha kur janë kryer dhe nga trysnia që ushtrohej nga sistemi i kohës për zgjedhjen a përzgjedhjen e librave, duke respektuar edhe gjeografinë letrare të autorëve të huaj, me anësimet e ditura ndaj atyre që quheshin "përparimtarë", qoftë edhe dukshëm "revolucionarë", nuk duhet kaluar në heshtje dhe, aq më pak, të mos vlerësohet ajo që është bërë mirë, ajo që ka qenë prurje e vlefshme, madje shumë e rëndësishme për formimin letrar e gjuhësor të brezave të tërë lexuesish, duke siguruar edhe një njohje relativisht të mirë të autorëve dhe veprave me rëndësi të letërsisë botërore. Janë përkthyer vepra madhore e madhështore jo vetëm të letërsisë së huaj, po edhe të dijes e të shkencës botërore dhe ka pasur një yjësi përkthyesish të përgatitur mirë e të sprovuar, me njohje të shkëlqyeshme të gjuhëve përkatëse dhe të shqipes. Në atë brez dhe me ndihmesa të shumta është edhe Stavri Dajo, dora e të cilit na ka dhënë përkthime veprash me rëndësi dhe që shkojnë në hullinë e mjeshtëve të mëdhenj të përkthimit, si Petro Zheji, Amik Kazaruho, Jusuf Vrioni, Donika Omari, Edmond Tupe, Jorgji Doksani, Shpëtim Çuçka, Aleko Minga, Pirro Misha etj.



Pra, unë e përgëzoj Stavri J.Dajon, sepse ai është një nga ata që, duke qenë gati gjithmonë mëtues drejt shqipërimin e jo "rob" i strukturave të gjuhëve të huaja prej të cilave përkthen, na ndihmon ta mbajmë gjallë e ta shtojmë traditën e mirë të përkthimit dhe shqipërimin nga gjuhët e huaja, jo vetëm në letërsinë artistike, po edhe në botimet studimore e shkencore, kulturore, fetare dhe në të gjitha fushat ku ka nevojë për njohjen e prurjeve dhe dijeve a të mbërriturave nga mbarë rruzulli e sidomos nga Evropa dhe Amerika.

Stavri J.Dajo ka punuar dhe është formuar si përkthyes në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", ku janë bërë përkthime shumë të mira të veprave madhore të letërsisë së huaj klasike dhe të kohës së re, si "Illiada" dhe "Odiseja", kryeveprat e letërsisë së lashtë greke, ku gdhendën mjeshtërinë e tyre si përkthyes emra të mëdhenj si Gjon Shllaku e Spiro Çomora, që u mor me përkushtim e zotësi të madhe me shqipërimin e tragjeditive të Eskilit, Sofokliut, Euripidit.

Krahas vlerave të mëdha e të lëndueshme, në fushën e përkthimit, këta njëzet vitet e fundit, për fat të keq, ka pasur edhe shenja të pamira të largimit nga tradita e vyer e shqipërimave dhe përkthimeve të bukura deri në "përkthimet", sikundër i quan me ironi Edmond Tupja, dhe sajemat dëmprurëse të përkthimeve sa për të mbaruar punë dhe me "google translate". E përgëzoj me gjithë zemër Stavrin për zotësinë dhe punën e kujdeshme, që na kujton mjeshterinë e mëdhenj të gdhendjes, që e kërkon, e gjen dhe e lëmon fjalën me shumë hijeshi. Ja, sa për shije, një frazë e shkëputur nga novela "Të jesh i bukur dhe të vdesësh", ku mund të shihet se sa i kujdesshëm është përkthyesi ynë në përzgjedhjen e fjalëve të duhura.

"Që atëherë Mitro Rumeloti s'u ngrit më në këmbë. Kaluan katërbëdhjetë ditë dhe ai dergjej në shtrat. Këmba iu bë plagë e iu ënjt. Mitron e lëkuri sëmundja. Shkuan dy muaj të tjerë. Shtroi dimri, fry juga dhe shiu s'pushoi dyzet ditë. Nëpër mure mbiu myshk e bar. Qielli i rëndë e i murrëmë rëndonte në zemrat e njerëzve, juga të shponte kokat. Mjerë i sëmuri; shkumëngari!" (f.41)

## 2. Çfarë i sjell lexuesit antologjia "Proza tregimtare greke" e përgatitur nga Stavri J.Dajo?

Për çdo libër të ri (e me mëtime për ta gjetur shtegun e vëmendjes së lexuesit) kërkohet një fjalë hyrëse a parathënie e mirë, e arsyetuar dhe e nyjetuar qartë e kthjellët. Dhe këtë, sipas meje, Stavri J.Dajo, në vend se t'i a besonte ndonjë dijetari a studiuesi tjetër, sikundër veprohet shpesh në botime kësodore, e ka mbajtur për vete këtë detyrë dhe mendoi se ka bërë mirë. Ka bërë mirë, sepse, pikërisht për një antologji të tillë, të prozës tregimtare greke, që shtrihet në një hark kohor të gjatë e që rrok disa periudha, të ndryshme e të atilla që, për secilën prej tyre, kërkohet një qëmtim e hulumtim i gjerë dhe nga një njohës që për shumë vjet është "me duar në brumë", duke ndjekur sa shkruhet, çfarë ishte përkthyer e duhet njohur, por, mbi të gjitha, çfarë duhet të pasqyrohet e të përfillet në një antologji pak të thuash të veçantë e me një akribi të lakmueshme, që rrallë e tek e kemi ndeshur në botimet shqiptare.

Parathënia e kësaj antologjie, për mendimin tim, është një studim i modelor, nevojishtë i thukët dhe i përmbledhur, por që jep dorë për të ditur gati gjithçka për prozën tregimtare greke dhe, në një farë mënyre, do ta krahasojë me "Introduktën" e Fan Nolit në hyrje për përkthimit të "Hamletit". Aty gjejmë aq sa duhet (dhe të thënë me siguri) e duke iu referuar me saktësi botimeve në të përkohshme periodikë a revista, si dhe në libra më vete; jep emrat e shqipëruar ose të pseudonimeve të tyre, sikundër shënon edhe botime pa emrin e autorit, si dhe bën,

besoj për herë të parë, edhe një periodizim të qartë të ecurisë së përkthimeve nga greqishtja në shqipen qysh nga fillimet e deri në ditët tona.

Për të mos shkarë në ndonjë parafrazim të pamirë e të pafryshëm, le të citojmë sa thotë Stavri J.Dajo në rreshtat e parë të Parathënies:

"Antologjia e pranishme e prozës tregimtare bashkëkohore greke është botimi më i plotë deri më sot në shqip i këtij lloji; përmbledh krijimtari të shkrimtarëve grekë të përkthyer në fill të kohërave, botuar në një libër me karakter përmbledhës ose në periodikun e kohës, që nga themelimi i shtetit shqiptar e deri në ditët tona, si dhe ripërkthime tregimesh të botuara më parë, ose përkthime tregimesh të reja, të pabotuara ndonjëherë.

Interesi i lexuesit shqiptar për qytetërimin grek, në përgjithësi, dhe për letërsinë artistike në veçanti, -poezi dhe prozë-zë fill para Rilindjes Kombëtare. Përkthimet e hershme të literaturës së huaj dëshmojnë se ato nisin në një masë të madhe me tekste nga gjuha greke dhe kjo nuk mund të shpjegohet vetëm me fqinjësinë gjeografike të dy vendeve, por me të vërtetat diakronike që mbart kultura greke, me cilësinë e lartë estetike dhe stiistike të saj si dhe me sinkretizimin shpirtëror të dy popujve të moçëm të Ballkanit, që bashkëketojnë për tre mijëvjeçarë." (Parathënie, f.13)

Në të vërtetë, duke e lexuar dhe, sidomos, rilexuar me kujdes Parathënien e kësaj antologjie, mund të themi se ato 20 faqe të saj, janë si një fizarmonikë e mbyllur, e cila, sa më me kujdes ta kundrosh, aq më shumë të jep mundësinë e të kuptuarit të gjerësisë dhe shtrirjes që ka pasur letërsia greke edhe në vendin tonë, natyrisht edhe

në përputhje me kohën, prandaj aty, me dorë të sigurtë, zoti Stavri J.Dajo, ka bërë edhe periodizimin e përkthimeve në gjuhën shqipe nga greqishtja.

Periudha para-përkthimore 1827-1896; Periudha 1895-1911; Periudha 1911-1945; Periudha 1945-1990; Periudha 1990-2023. Për secilën prej tyre sillen edhe prurje sa interesante, aq edhe domethënëse e me vlerë përnjohëse e historike. P.sh. Kur thotë se "Përkthimet nga literatura greke nisin në vitin 1827 me Dhiatën e Re, vepër e shqipëruar nga Vangjel Meksi, mjek personal i Ali Pashë Tepelënës, zoti Stavri gjen rastin të tregojë se "Vetë Ali Pasha ishte përkthyes i letërsisë franceze në turqisht-sipas kujtimeve të Bajronit-përkthimet e poezisë franceze i recitonte dhe i interpretonte publikisht." Dhe, në fakt, për secilën prej këtyre periudhave, sillen të dhëna e shqyrtime të rëndësishme e që, përtej rëndësisë si pjesë e këtij libri, meritojnë të shihen edhe si një sprovë e parë e dobishme dhe mjaft e qartë e historisë së përkthimit nga greqishtja në gjuhën shqipe. Hyrja, theksojmë, është shkruar sipas parimeve të rrepta të saktësisë e burimorësisë, duke cituar në shënime në fund të faqeve (fusnota) burimet e çdo prurjeje të përmendur në të.

Për secilën pjesë të përfshirë në Antologji, jepen në fund "Të dhëna biobibliografike" shumë të vlefshme, sidomos për mënyrën e shkrimit dhe të shqiptimit të emrave të autorëve e të katalogizimit të tyre. Në fakt, në ato shënime, për disa nga autorët më prodhimtarë e të njohur, jepen edhe të dhëna të holësishme biobibliografike, duke shënuar edhe titujt e veprave të tyre si dhe, kur është rasti, edhe të njohjes së tyre në botën e letrave të kohës, duke sjellë, kështu, një ndihmesë të vlefshme për të pasur

edhe një njohje të mirë rrethvëndit që u takon autorëve përkatës në letërsinë bashkëkohore.

Me rëndësi të veçantë më duket koncepti strukturës përmbajtësore dhe i kriterëve shkencore të përmbledhjes. "Vëllimi i pranishëm antologjik përmbledh prozë tregimtare të afirmuar dhe të përmendur nga studimet akademike greke dhe sidomos që evidentohet si e tillë në ndërgjegjen shpirtërore të lexuesit; përndryshe, përmbledhjen dhe ato tregime që janë bërë pronë shpirtërore dhe e lexuesit shqiptar nga botimet e periodikut përgjatë viteve. Për këtë arsye, përveç shqipërimeve të reja veprash të dalluara të kohës, kemi zgjedhur dhe botimet më të spikatura të së kaluarës në shtypin shqiptar, pa pasur pretendimin se zgjedhjet tona janë të pagabueshme." (f.28) Me vend, pa dyshim, është edhe kriteri që përket përzgjedhjes ideologjike, duke theksuar se është munduar t'i përmbledhë në një masë të mundshme të gjitha drejtimet ideologjike e rrymat letrare që janë shfaqur në prozën greke.

Së mbrami, në mbyllje të kësaj kumtese modeste, do të shpreh idenë se vlerësimi i përkthimit dhe i përkthyesve duhet të meritojë vëmendjen dhe kujdesin shumë të madh të shoqërisë shqiptare, prandaj, po e ritheksoj propozimin që kam bërë edhe në Konferencën kushtuar përkthimit, të mbajtur në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në qershor të vitit 2016, që, para se të jetë vonë, të themelohet edhe një institucion mbarëkombëtar kushtuar përkthimit, që mund të ishte edhe një Akademi Shqiptare, e cila të ketë si detyrë e synim kryesor përkrahjen, nxitjen dhe vlerësimin e përkthimeve të mira, duke ideuar e jetësuar edhe një veprimtari të përvitshme të dhënies së mirënjohjeve e çmimeve për përkthimet më të mira. Po ashtu, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe me universitetet ku ka fakultete të gjuhëve të huaja, të organizohet puna për kualifikimin e përkthyesve dhe të redaktorëve për gjuhët kryesore të përkthimit, duke synuar e realizuar shtimin e kujdesit dhe të përgjegjësisë për gjuhën e përkthimeve në gjuhën shqipe në të gjitha fushat e jo vetëm në botimet e letërsisë artistike.

Stavri J.Dajo, me përkthikët e mëparshme dhe me antologjinë "Proza tregimtare greke" ka dëshmuar se di jo vetëm të përkthejë bukur, më saktë: të shqipërojë aq këndshëm, po mbi të gjitha të përzgjedhë nga thesari i vyer shpirtëror i letërsisë artistike greke. Kam qëmtuar e nxjerrë shumë fjalë e togfjalësha të përdorur mjeshtërisht e me hijeshi të rrallë në librat e përkthyer nga Stavri Dajo. Gjithandëj në këtë antologji, por veçan në pjesët e përkthyer nga vetë S.J.Dajo, shquajnë dy cilësi me rëndësi për t'u vënë re e vlerësuar. Së pari, kujdesi i vazhdueshëm për t'i zbatuar rregullat e drejtshkrimit të shqipes së sotme dhe normat morfosintaksore, duke shmangur forma a dysorë të panevojshëm. Së dyti, autori ka concept të drejtë për normën leksikore, e cila është më pak e shtrënguar sesa rregullat e drejtshkrimit e norma gramatikore, prandaj sa here ka qenë rasti, u është qasur me ëndje edhe fjalëve a sgpërheje të bukura nga krahinat e sidomos nga gegërishtja e shkruar dhe e folur. Përmendim, ndër të tjera: *i cemte, për midis, bun, kaptoj, hundë majuce, përkaj, zhbirim, tekembramja, ballinë, pale (se mos) do (disa): do gra, sinor, vrikthi, bëzante, ndajdarkë, burri i botës, ngutas, gjithherë, thuprak, vjegë* etj. Po ashtu edhe ka krijuar fjalë që mund të mbeten si gjedhe edhe për shkrimtarë e përkthyes të tjerë.

Pra, le t'i themi me gojën plot, i lumtë dora këtij përkthyesi të përkushtuar e të sprovuar dhe suksese të mëtejshme.

Tiranë, 26 mars, 2024



### Energjia krijuese e Margarita Xhepës

Mbaj mend, që një nga shkrimet e botuara në të përjavshmen letrare-kulturorë "EX LIBRIS", e kam titulluar "Prilli i Margarita Xhepës". Mund ta kisha titulluar edhe "Stinët e Margaritës", ose "Pranverat e jetës skenike dhe filmike të Margarita Xhepës".

Këta tre tituj, për jetën dhe karrierën e Margarita Xhepës, si një nga yjet e skenës dhe filmit shqiptar, i lidh pranvera dhe një nga muajt e saj më të bukur, prilli. Metaforikisht do të shtoja se prilli i ka dhënë aktorese së madhe edhe bukurinë, sharmin, zërin dhe timbrin e veçantë të tij, që është si "tingull harpe, që pushton jo vetëm një sallë të stërmadhe, por një botë të tërë". (Angjelina Xhara)

Nuk është e rastit, që regjisori grek i "Elektrës" të Sofokliut, ku Margarita luan rolin e dados, flet për "gjëmimin e rënkimit të saj".

Është ky "gjëmim i rëndkimit të saj", që të trondit dhe të lë pa gjumë, kur dëgjon në filmin "Pylli i lirisë" vajin e gruas myzeqare apo klithmën ulëritëse të Hekubës. Për gjëmën e Trojës. Ajo, te tragjedia "Trojanët" të Euripidit solli një Hekubë sa trojane, aq edhe ballkanase dhe shqiptare. Këtu qëndron suksesi dhe shkëlqimi befasues i Margarita Xhepës te "Trojanët", kur u vu në skenë në nja nga teatrot më të mirë të Athinës, nga regjisori Theodhopulos, i cili shkroi: "Ajo përcolli me energji tronditëse rolin e Hekubës, duke i dhënë frymë dhe ritëm të gjithë shfaqjes. Dua t'i puth dorën për energjinë tronditëse me të cilën përballoi rolin dhe situatën dramatike."

Margarita Xhepa është një aktore, ndoshta të rralla në historinë e shkollës interpretative shqiptare, që rrezaton në tërë qënien e saj shumë dritë. Mendoj se është një dritë e brendshme, që nga lindja e saj dhe më pas është bërë pjesë e pandarë e portretit, gjestikulacionit, të folurit. Mos ndoshta kjo dritë apo rrezatim lidhet me vendlindjen e saj? Them se po. Ajo ka shumë nga drita e tokës dhe e qiellit myzeqar. Myzeqeja ka shumë dritë. Është një dritë që vjen jo vetëm nga qielli, por edhe nga toka. Nga ana tjetër, në portretin e saj ka shumë mirësi, butësi, si dhe bukuri e hijeshi prej aristokrateje. Mendoj se gjatë karrierës së saj të gjatë, janë dy elementë që përbëjnë thelbin e talentit të përsëritshëm të Xhepës: goja dhe sytë. E para, si artikolohet ajo dhe e dyta, pra sytë, fshehin dhe shfaqin botën e brendshme të njeriut.

Po të perifrazoja vlerësimin e kritikës botërore për Aleksandër Moisiun, veçanërisht zërin e tij, unë do të thoja se edhe Margarita Xhepa ka një zë tipik shqiptar nga timbri, tonaliteti dhe shqiptimi. Nga ana tjetër, aktorja jonë e madhe fsheh një energji të jashtëzakonshme interpretimi në sytë dhe vështrimin e tyre. Kushdo që ka ndjekur në skenë interpretimet e saj, por veçanërisht rolet në filmat shqiptarë, me siguri ka vënë re

## Në 90-vjetorin e lindjes MARGARITA XHEPA, YLLI I PASHUAR I SKENËS DHE FILMIT SHQIPTAR

Nga Enver Kushi

forcën dhe energjinë e syve të saj. Energjia e saj krijuese fshihet jo vetëm te sytë. E kam të vështirë të depërtoj në laboratorin interpretative të Aktorese së Popullit Margarita Xhepa dhe shumë nga kulmet e saj në teatrin dhe filmin shqiptar.

### Monologu i parë

Pranvera në Lushnjë është e bukur, veçanërisht prilli, muaji i dytë i saj. Qytetin tim e rrahin erërat e buta, që vijnë nga deti Adriatik dhe pasi peshkojnë fushën e paanë të Myzëqesë, u japin kodrave një gjallëri të veçantë. Duket sikur çdo gjë merr frymë ndryshe: edhe ullinjët, kumbullat, pjeshkët, limonët e portokallet, luledet, trëndafilat... Edhe njerëzit. E ndiej më shumë se të tjerët prillin. Jam ndryshe në këtë muaj dhe kam dëshirë të dal, të eci rrugëve të Tiranës dhe pastaj te Parku i Madh i Liqenit... Sepse prilli është muaji im. Pranvera është stina ime. Kam lindur më 2 prill të vitit 1934, në një shtëpi të thjeshtë, pranë asaj të madhes, ku është mbajtur Kongresi Historik i Lushnjës.

Edhe kur isha e vogël, edhe kur u madhova, ajo shtëpi më është dukur më e madhja dhe më e bukura e qytetit tim. Nga fëmijëria e mbaj mend nënën time të bukur e fjalëpakë. Më vjen shpesh në ëndërr nëna ime e mirë, që vdiq shpejt, duke më lënë jetime. Babai u martua me një grua tjetër. Isha me fat që njerka na donte shumë. Ajo ishte nikoqire dhe zonjë e vërtetë. Mbaj mend babain tim që këndonte bukur. Mbaj mend zërat e qytetit tim dhe njerëzit e tij të butë. Edhe aromat apo parfumet, që vinin nga kopshtimet me shumë lule.

Eh Lushnja ime e dashur dhe fëmijëria e rinia që kam kaluar në këtë qytet të mrekullueshëm. Ah! Nuk do të harroj kurrë një nënë



nga Çamëria. Familja e saj kishte ardhur në lagjen tonë "Stani" në dimrin e vitit 1944. Isha dhjetë vjeçe atëherë, dhe shtëpia e familjes nga Çamëria ishte shumë afër tonës. Nëna nga Çamëria kishte një të folur të veçantë, shumë të ëmbël. Ajo vinte shpesh tek ne. Më përkëdhelte flokët kaçurrele dhe duke më përqaftuar më thoshte: "Bila ime, vashëza ime e bukur." Edhe në këtë moshë më duket sikur dëgjoj të folurën e saj të veçantë dhe kam në gojë shijen e byrekut me lakra dhe një lloj tjetër, që e quante klumushtor, që bëhej me qumësht dhe vezë..."

### Monologu i dytë: Ofelia ime

"Ishim në kulmin e punës për vënie në skenë të Hamletit. Ofelia ishte bërë pjesë e qënies time. Ajo më ndiqte kudo jo vetëm gjatë provave, por edhe në rrugë, shtëpi ose dhe kur vija kokën në jastëk. Kur gjumi nuk më zinte apo edhe kur sapo dremisja pak, më vinte në ëndërr e bukur, delikate dhe e brishtë si vesa e mëngjesit... E ndjeja që gjatë provave, veçanërisht në skenat kur ajo është

e çmendur, diçka nuk shkonte. Nuk kishta parë asnjëherë, deri në atë moshë ndonjë vajzë ose grua të çmendur. Ishte paradite, kur mora në telefon prof. Ylvi Vehbiun, me të cilin kishim njohje familjare. Prof. Ylvi Vehbiu ishte një nga psikiatritë e njohur të kohës. I thashë profesorit se doja të vija në spitalin psikiatrik, për të parë nga afër ndonjë vajzë të re të sëmurë. Ai më tha se mund të vija menjëherë... Nuk do ta harroj kurrë momentin kur pashë në një korridor të spitalit psikiatrik, vajzën e çmendur. Ajo ishte 17 vjeçe. E bukur. Shumë e bukur. Bënte ca lëvizje të guditshme, si në jerm apo në një hapësirë boshe. Pastaj qëndronte, duke vështruar sa majtas-djathtas ose lart. Dhe këndonte, me një zë të ëmbël, sikur ishte në skenë... Eh... E gjora vajzë! E gjora vajzë! Befas ngriti duart lart, lëvizti prap dhe pas disa sekondave, ia dha të qarit me dënësë... I ngulita në kokë të gjitha këto dhe në skenë, i bëra pjesë të Ofelisë time... Regjisori sovjetik nuk e përmbajti entuziazmin. Ai m'u afrua e më përqaftoi, duke thënë rusisht fjalët "Ah pëllumbesha ime! Çfarë ndryshimi nga ditët e mëparshme...". Isha Ofelia e çmendur. Lëvizja në skenë si e çmendura që kisha parë në spitalin psikiatrik, gjendja emocionale e së cilës ndryshonte nga kënga, e qeshura në të qarë që të këpuste shpirtin. Edhe unë, Margarita-Ofeli, këndoja:

Të bardhë si dëborë e kish savanin,  
Me lule të stolisur,  
I vogël e i madh me lot e qanin,  
Me zemër të zalitur".

Kjo është Ofelia ime, që, siç shkruan Fan Noli: "Ofelia, e dashura fatzeze e Hamletit, është një nga fytyrat më tragjike dhe më patetike të teatrit shekspirian. Si Hamletit, ashtu edhe Ofelisë i është përmbysur bota mbi kokë".

### Monologu i tretë

Filmi "Dora e ngrohtë", më skenar të Neshat Tozajt dhe regji të Kujtim Çashkut u prit shumë mirë nga shikuesit shqiptarë. Sallat e kinemave në Tiranë ishin plot dhe shumë qytetarë e panë disa herë këtë film, që me mjeshtri trajtonte një problem të veçantë, shumë delikat të familjes shqiptare në atë kohë. Ndoshta është nga rolet më të arrira të miat. Edhe nga më të ndjerat. Ishte një kastë e tërë aktorësh, njëri më i mirë se tjetri. Do të veçoja interpretimin brilant të Reshat Arbanës, që në fim ishte partneri im... Arti i vërtetë dihet se ka një ndikim të madh në shoqëri. Këtu do veçoja teatrin dhe filmin. Mbaj mend, që pasi përfundoi shfaqja në Teatrin Kombëtar, dola me nxitim nga oborri i Teatrit, pastaj kalova në trotuarin pranë xhamisë dhe u hodha matanë, pranë monumentit të Skënderbeut. Pashë orën. Po shkonte nëntë. Dhe, teksa i hodha një vështrim të shpejtë sheshit, që ndriçohej nga drita e zbehtë e neoneve, dëgjova fare pranë zërin e një gruaje: "Mirëmbrema Margarita. Më falni, nëse ju shqetësoj...". Ndala. Gruaja më zgjati dorën dhe më përqaftoi. Kam mbi një orë që po ju pres, tha gruaja. Pastaj më ftoi për kafe, se donte të më falënderonte për gjithçka që kisha bërë për familjen e saj, se... I thashë se me kënaqësi do ta pija kafënë me të, por ishte vonë dhe më prisnin djemtë për darkë. Ajo heshti dhe më pas, me ndrojtje shtoi se edhe njëherë më falënderonte për rolin tim te "Dora e ngrohtë", se ajo prej vitesh kishte përjetuar të njëjtën dramë, si te filmi, se .... Heshti prap dhe më tha se bashkëshorti i saj e kishte parë dy herë filmin, se nuk ishte më i pari, duke më trajtuar ndryshe mua dhe djalin tim nga martesja e parë. Shtanga. Më besoni, sytë m'u mbushën me lot. Ju hodha në qafë gruas së panjohur dhe i premtova që do ta takoja prapë. Merr me vete edhe burrin tënd, i thashë. Edhe djalin. Do t'ua jap unë kafënë... U ndava prej saj dhe bëra tutje nën ndriçimin e zbehtë të neoneve.

### Zonja nga Parga dhe Margarita Xhepa

Në vitin 2019 u botua novela ime "Zonja nga Parga". Margarita Xhepa ishte nga lexueset e para të kësaj novele. Mbaj mend telefonatën e saj aty nga nëntori i atij viti. Më vjen keq që nuk i shkruava në letër ato që ajo më tha. Fliste me entuziazëm dhe me



emocion. Mbaj mend që më tha, se e kishte rilexuar disa herë këtë novelë dhe se e gjente vehten, nëse do të xhirohej një film me skenar për "Zonjën nga Parga", në rolin e kësaj gruaje çame. Këtë mendim e shprehu edhe në promovimin e novelës, më 5 shkurt të vitit 2020, që u organizua, falë kontributit të sponsorizimit të librit dhe veprimtarisë nga Alket Veliu. Emocionet këtij promovimi ja shroi fjala dhe interpretimi i nje fragmenti nga kjo novelë e aktores Margarita Xhepa. Është ky fragment, që po publikoj më poshtë, që Margarita i dha shumë shpirt, duke i emocionuar të pranishmit e shumtë nga ky recitim. Është momenti kur Kristua bashkëshorti grek i zonjës nga Parga, e çon atë në një tempull për të folur me shpirtrat e të parëve të saj.

"Bila ime. Bila ime", dëgjova zërin që vinte nga kubeja. Ishte zëri i gjithit... Zëri i gjithit tim, thashë me vehte. Ku je fshehur? M'u shfaq...M'u shfaq prapë të të shoh... Ah korba 'U. Korba 'U!

"Bila ime e mirë. Gjishi jam... Drita e gjithit...U të flas. Dëgjomë e mira ime. Gëzohem që je mirë. Gëzohem që të shoh. Ah bila ime e mirë... Ku na mbete? Ku të lamë e mira ime?... Botë e Shqipërisë më ka mbuluar bila ime e bukur si ill... Edhe ghishja jote nga botë e Shqipërisë është mbuluar... Edhe Nuja... Edhe babathua... Këtu janë me muas. Të vështrojnë e gëzonenë që të shohin mirë bila ime. Hidhi pas krahëve ato që të kanë glaRË. Selam bëju gurëve të Çamërisë. Selam bëji detit dhe Pargës. Selam bëju ullinjve. Selam bëju ature që janë në Pargë, Agji, Morfat, Rrapes... Puthi sitë djalit tënd. Selam bëji Kristos dhe fëmijës së tij. Selam... Selam... Selam..."


Aktorja pret skenarin e "Zonjës nga Parga" dhe realizimin e filmit. Ajo e kërkon këtë me ngulm, sepse siç më thotë, koha shkon dhe mosha bën të vetën. Pastaj shton, se mund të ishte dhe një bashkëpunim me një regjisor grek dhe se realizimi i këtij filmi me mesazhet që do të përcjellë, i bën nder edhe marrëdhënies midis dy popujve tanë dhe në përgjithësi humanizmit njerëzor. Filmi do të jetë një apel, që të mos përsëritet e kaluara dhe se popujt tanë, veçanërisht ai çam, ka nevojë të shohë nga e ardhmja.

#### Monologu i fundit: Të flasësh me detin

"Në shtator të vitit 2020, kur Shqipëria dhe bota lëngonte nga murtaja e këtij shekulli, Covid-i, u nisa për në Himarë. Mbaj mend, që ishte një vjeshtë e bukur, shumë e paqtë. Bashkë me mua ishte dhe skulptori Mumtaz Dhrami dhe të tjerë. Më kanë pëlqyer vazhdimisht udhëtimet, në të gjitha stinët dhe në viset e Shqipërisë. Shihja nga xhami i makinës peisazhet e bukura të vendit tim dhe qetësinë që të japin ato. Dukej sikur Covidi i tmerrshëm ishte larg këtyre peisazheve. Pastaj Llogaraja dhe mrekullia që shfaqet kur je duke zbritur poshtë. E dua detin. Atë ditë ai shtrihet i paanë, i kaltër, çuditërisht i qetë dhe me një bukuri që mua më prekte. Ishte mesditë, kur arritëm në Himarë. Ku janë njerëzit, pyeta, organizatorët e veprimtarisë. Ata ngritën supet, duke më thënë se frika nga Covidi i kish mbyllur brenda. Mirë, u thashë. Unë kisha menduar, që t'u recitoja atyre disa poezi. Këtë do ta bëj me një spektator tjetër, që ka ardhur dhe është fare pranë nesh. Ah, ah, harrova të them Enver. Ku është Lefter Çipa, poeti i madh që i ka kënduar si rrallë kush Labërisë, Pilurit, Himarës, shpirtit njerëzor dhe shpirtit të detit? Më thanë se nuk ishte mirë me shëndet... Atëhere hodha disa hapa dhe iu afrova detit. I fola me zë: "Mirë se të gjeta!" Ai m'u përgjigj në heshtje, nëpërnjet dallgëve të lehta dhe ca fjalëve, që vetëm unë i kuptoja, se ç'donte të thoshte deti. Pastaj nisa recitim. Ishte një nga interpretimet më të çuditshme që kam bërë në karrierën time të gjatë si aktore, ku përballë meje nuk ishin spektatorët, po deti, hapësira e tij e paanë, thellësia e tij, që më ndoqi me vëmëndje. Kur mbarova, dëgjova jo duartrokitje, por ca zëra si amanete, që vinin nga spektatori DET. Dëgjova pastaj, jo vajzën e valëve, por qindra vajza valësh. Dëgjova zërat e të shkuarës, të sotmes dhe të ardhmes. Miku im, skulptori Mumtaz Dhrami, dukej si i ngrirë dhe pasi më përqafoi më tha: "Margaritë, recitimi yt ishte një mrekulli!"

Tiranë, prill 2024

## Karikaturë nga Arben Mexsi



Sapo doli në qarkullim vëllimi IX i veprës së Midhat Frashërit, botuar nga "Onufri" nën kujdesin e z. Bujar Hudhri. Ky vëllim përfshin letrat e kohës së Mbretërisë (1928-1939), të periudhës së Luftës së Dytë Botërore (1939-1944), si edhe ato të emigracionit politik të tij (1944-1949).

Përpara tyre janë vendosur disa letra dhe ese që janë gjetur nga ne më pas gjatë hulumtimeve nëpër arkiva, letra të viteve 1908-1928 dhe letra apo dokumente të nxjerra nga fashikulli i Mid'hat Frashërit në dosjen e Sigurimit të Shtetit, të botuara në këtë vëllim, me qenë se është i parafundit i kolanës "Vepra të zgjedhura të Mid'hat Frashërit".

Pjesa e parë e letrave të Mid'hat Frashërit dhe ato të bashkëkohësve drejtuar atij janë produkt i kohës më të qetë e më të stabilizuar të shtetit shqiptar, por edhe të jetës së tij, kur ai ishte librar në Librarinë "Lumo Skëndo" në Tiranë dhe zhvillonte një veprimtari të gjerë intelektuale, kulturore, studimore, madje edhe diplomatike si kryetar i Asosacionit të Lidhjes së Kombeve për Shqipërinë. (Ai nuk pranoi asnjë post në kohën e regjimit të Zogut, apo të kohës së pushtimit nazifashist)

Edhe në këtë letërkëmbim, si në gjithë veprën e tij, ai shfaqet si një prijës ideor dhe shpirtëror i kombit shqiptar, profet dhe edukator i njerëzisë, ndriçues i mendjes, yshtës i punës së parreshtur, i paqes (babai i përparimit njerëzor është paqja, thotë ai), i mirëkuptimit, bashkëpunimit, marrëveshjes jo vetëm mes shqiptarëve, por edhe midis popujve dhe kombeve, një kritik i vetes edhe i të tjerëve, qofshin personalitete e institucione të ndryshkura shqiptare, por edhe të fuqishme ndërkombëtare, që i bënin dëm Shqipërisë, një vullnet titanik i pathyer dhe i kurrë i pashpërblyer (uvrier, thotë ai në një letër), mospajtuës me urretjen, padrejtësinë, arbitraritetin, dhunën, diskriminimin etnik e social, gënjeshtren dhe nënshtrimin, tradhtinë ndaj atdheut dhe nxitjen e luftës, jo vetëm mes shqiptarëve, por edhe kombeve të tjerë. Një evropian i madh në një vend të vogël, një vizionar që i rrëfente njerëzisë një udhë të re: udhën e drejtë e të vërtetë të përparimit e mirëkuptimit në atë kohë, por edhe në të pritmin.

"Unë i përkas një rajoni të Evropës që ka vuajtur shumë, ndoshta ai që ka vuajtur më shumë gjatë dy dekadave të fundit. Është ky rajon i Evropës që kishte më shumë nevojë për paqe, pajtim dhe harmoni midis elementëve kuptojnë se ka vetëm një mënyrë për të arritur prosperitetin, vetëm një mënyrë për të të ndryshëm të tij. Popujt ballkanikë kanë filluar të shkëputur zakonet e këqija të së kaluarës, sipas të cilave çdo popull përtej kufirit konsiderohej armik. Ata tashmë e kuptojnë se një solidaritet interesash të përbashkëta, materiale dhe ekonomike, madje edhe morale e intelektuale, duhet t'i bashkojë popujt dhe jo t'i ndajë ata."

M.Frashëri, ky erudit i madh, nuk iu nda për asnjë çast, edhe në kohët më të vështira të jetës së tij dhe të kombit, përfutuesit dhe mëkuesit të diturisë, por edhe përpjekjes për krijimin e institucioneve kulturore dhe shkencore në Shqipëri, siç ishin themelimi i Bibliotekës Kombëtare, Institutit të Studimeve Shqiptare dhe së fundi edhe projekti i ngritjes së një akademie diplomatike në Tiranë në vitin 1938 me ndihmesën e Austrisë dhe të diplomatit austriak August von Kral. (Letër ministrit Kral)

Njëkohësisht, M.Frashëri ka letërkëmbim me personalitete të rëndësishme të botës shqiptare me të cilët bashkëbisedon dhe bashkëpunon për probleme kombëtare, por edhe ta kulturës shqiptare, si me Ismail Qemalin, Fan Nolin, Branko Merxhanin, Fuat Dibrën, Kristo Dakon, Kristaq Tutulanin, Vasil Andonin, Abaz Kupin, Alfred Andonin, Musine Kokalarin, e të tjerë.

Në këtë vëllim ngërthehen edhe letrat e dashurisë, që e bëjnë edhe më magjepsës botimin. Vijnë letërkëmbimi me të dashurën e tij franceze, intelektuale Ninon. Sipas një kuptimi që i jepet këtij emri (Ninon) në frëngjisht, bëhet fjalë për një grua të dashur, plot madhështi kulturore me interesa për muzikën klasike, letërsinë dhe pikurën, grua

# BOTOHET VËLLIMI IX I VEPRËS SË ZGJEDHUR TË MIDHAT FRASHËRIT

Nga Uran Butka

tepër e ndjeshme, e mbyllur, besnike, disi e ndrojtur dhe e përmbajtur, që i jep pamje të ftohtë, por që ka besim në vetvete dhe fal shumë dashuri

Po ashtu botohen edhe letrat e fundit të rumunes Angela Romano, letërkëmbim i jashëyakonshëm që zgjati 25 vjet. Ajo jetonte me kujtimet e bukura me Mit'hatin në Stamboll apo në Zvicër dhe ëndërronte ta takonte atë përsëri në Gjenevë apo diku gjetkë. "Bukuria e natyrës ka gjithmonë efekt të më afrojë me ty miku im. Janë ato ekskursionet në këmbë që bënim në Zvicër dhe në malet e pyllëzuara mbi Montreux që më vijnë në mendje dhe kam gjithmonë një dëshirë të fortë ta shoh edhe një herë atë vend të mrekullueshëm. E sheh, kur mendoj për mundësinë e një udhëtimi jashtë shtetit, janë vetëm vendet ku kam qenë me ty që më tundojnë!" Angela ishte e vetëdijshme dhe e vlerësonte përkushtimin e Mit'hatit për kombin e tij. Ajo disa herë i shkruan të bashkohet të jetojnë bashkë, por Mit'hati zgjodhi çështjen kombëtare dhe shpirtin e lirë. Më 28 Nëntor 1933 ajo i dërgon një kartolinë "Po të shkruaj me nxitim, ngase nuk doja të shpëtoja kjo ditë pa të thënë që nuk e harroj përvjetorin e një dite të lumtur për vendin tënd." Pra e uron për ditën e Flamurit.

Në letrat e fundit Angele e fton Mit'hatin të bashkëjetojnë në Bukuresht apo në ndonjë

vend tjetër të Evropës, meqenëse Shqipëria e pushtuar ishte vend i pasigurt për të jetuar. Por Mit'hati mes Shqipërisë dhe Angeles zgjodhi vendin e vet, mes dashurisë dhe detyrës zgjodhi detyrën të punojë si uvrier në Shqipëri

Opozitar ndaj çdo lloj qeverie si intelektual e qytetar i Evropës, ai u qëndron i pathyer goditjeve dhe presioneve të pushteteve. Le të citojmë vetëm një letër të tij të vitit 1937: "Zoti Kryeministër, si njeri i ndershëm që të konsideroj, ma deklaro mua açik: në qoftë se qeveria juaj nuk më do, unë ikën nga Shqipëria, edhe mos kini frikë se bënj shantazh si të tjerët. Këtu rronj si një uvrier duke punuar. Si uvrier do të rronj kudo që të vete"

Edhe ndaj pushteteve të Fuqive të Mëdha dhe atyre fqinje, që donin ta zhbënin Shqipërinë, Mit'hat Frashëri është kundërshtar dhe kritik i pathyer. Ja çfarë proteste i dërgon kryetarit të Konferencës së Paqes në Paris, Klemanso' në vitin 1920: "Shqipëria, e krijuar më 1913 si shtet i pavarur, neutral dhe i garantuar, zotëron një të drejtë të fituar dhe nuk mund të shohë shkatërrimin e pavarësisë dhe integritetit të saj pa protestuar. Italia nuk ka asnjë të drejtë legjitime mbi Vlorën dhe tokën në brendësi të saj, përveçse asaj që vjen nga forca e saj e pamatë kundrejt Shqipërisë së vogël e të dobët; Greqia, si dhe Jugosllavia, nuk kanë asnjë të drejtë mbi pjesët



e tjera të territorit shqiptar".

Mit'hat Frashëri si një diplomat evropian i mirënjohur dhe largpamës, e sheh dhe e kërkon zgjidhjen e çështjes shqiptare në forumet më të larta vendimmarrëse të Evropës jo si një çështje të shkëputur, "që s'ka të bëjë vetëm me Shqipërinë, por që i intereson paqes në Ballkan dhe madje edhe në Evropë". Në letrën drejtuar më 9 prill 1921 Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Eric Drummond, M.Frashëri, si kryetar i Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, i shkruan:

"Përveç tri letrave që kam nderin t'ju dërgoj në datën e sotme, i lejoj vetes t'ju shkruaj këto radhë personalisht. Ju lutem të më falni për to. Por nuk do të mundesha kurrë t'ju lutesha sa duhet për të tërhequr vëmendjen tuaj dashamirëse mbi një çështje që s'ka të bëjë vetëm me Shqipërinë, por që i intereson paqes në Ballkan dhe madje edhe në Evropë.

Fuqitë e mëdha, që ngurrojnë të merren individualisht dhe veçmas me çështjen tonë, janë të gatshme t'i japin asaj një zgjidhje, nëse u kërkohet nga Lidhja e Kombeve.

Për ne janë tri pika që duhet të merren parasysh:

1 - Të evakuhet nga Serbia krahinat e pushtuara arbitrarisht në Lindje dhe në Veri të Shqipërisë.

2- Të evakuhet nga Greqia krahina shqiptare në Lindje e Korçës.

3- Të njihet qeveria shqiptare de jure dhe të vendosen marrëdhëniet diplomatike.


Jam i bindur se zgjidhja e këtyre çështjeve do të bëhet në mënyrën më paqësore dhe më të lehtë nëse Lidhja e Kombeve - në interes të paqes -, do të dëshironte të merrej me to".

Pjesa e dytë e letërkëmbimit ngërthen letrat e periudhës së Luftës së Dytë, kohë kur Mit'hat Frashëri ishte themelues dhe kryetar i Organizatës nacionaliste demokratike "Balli Kombëtar" në përballje me pushtuesit, në përpjekje për bashkëpunim me Lëvizjen Nacionalçlirimtare e gjithë faktorët antifashistë në luftën për çlirim (Marrëveshja kombëtare e Mukjes, gusht 1943) dhe, pas prishjes së saj nga komunistët, përfshirjen e padëshiruar prej tij dhe të imponuar, në luftën civile me Frontin Nacionalçlirimtar të udhëhequr nga PKSH, që e provokoi, e nisi dhe e përfundoi këtë luftë shkatërrimtare me vendosjen e regjimit diktatorial komunist dhe ndarjen me Perëndimin demokratik.

Kur Enver Hoxha urdhëronte luftën e pamëshirshme kundër nacionalistëve, "Me forcë dhe me armë ta marrim në dorë pushtetin. Ballin ta likujdojmë pa mëshirë nga çdo anë qoftë. Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi nëse në luftën për asgjësimin e Abaz Kupit do të gjejmë vdekjen edhe oficerët anglezë që rrinë me të", M. Frashëri ngrinte zërin për bashkim "Sot është koha për një FRONT të çeliktë kundër armikut okupator dhe kundër horrave që e pasojnë. Ky front i përbashkët është gatuar me gjakun e heronjëve tanë: Qemal Stafa e dha shtrimin dhe i fali atdheut gjënë më të shtrenjtë që kish: jetën. Jashar Cakrani<sup>1</sup> e dëgjoi edhe ai atë kushtrim, duke rënë martir për atdhenë. Me qindra të tjerë kaluan mbi gjurmët e gjakut të dëshmorve dhe vaditën me gjakun e zëmërës së tyre këtë tokë arbërore. Le të luftojmë të bashkuar rreth fjalëve që na lanë të parët tanë: JA VDEKJE, JA LIRI! JEMI VËLLEZËR, S'NA NDAJNË DOT!"

Por luftën civile nuk e ndali dot, as humbjen e mijëra viktimave të pafajshme, as humbjen

<sup>1</sup> Jashar Cakrani, luftëtar i Ballit Kombëtar, që u vra në luftën e Ruzhdijes 13 mars 1943 Mallakastër kundër pushtuesve italianë (red)



INSTITUTI I STUDIMEVE HISTORIKE  
"LUMO SKËNDO"

9

e tij politike, as ngritjen e përgjashme të regjimit komunist.

Ai e vijoi përpjekjen për rivendosjen e lirisë dhe demokracisë në Shqipëri, edhe kur ishte në emigracionin politik në Europë, edhe kur shkoi në SHBA, si kryetar i komitetit "Shqipëria e Lirë". Aleatët perëndimorë e zgjedhën Mid'hat Frashërin në krye të "qeverisë në hije në emiracion", për shkak të vizionit të tij perëndimor demokratik, mendjes së hapur, antikomunizmit, pastërtisë së figurës dhe intransigjencës ndaj vetes dhe të tjerëve. Në emigracion ai u përpoq si lider i Ballit Kombëtar t'i bashkonte shqiptarët për interesin kombëtar pavarësisht nga përkatësitë ideore e partiake kudo që ndodheshin: në Itali, Francë, Greqi, Turqi, Egjipt, ShBA për t'i shërbyer Shqipërisë e për t'i kthyer popullit shqiptar një qeverisje demorotike dhe të gjitha të drejtat dhe liritë e mohuara nga regjimi komunist. Por ai nuk pranoi të bashkohej e të bashkëpunonte me ata krerë, sidomos të Bllokut Independent, që kishin bashkëpunuar me pushtuesit dhe kishin njolla e faje kundrejt atdheut. Ky qëndrim zbulohet qartazi në letërkëmbimin e viteve 1947-1949, të zgjedhura në këtë botim. Më i prerë bëhet ky qëndrim apo vija e tij ndarëse, kur bëhet fjalë për përzgjedhjen në Komitetin "Shqipëria e Lirë".

"U themelue Komitetit "Shqipëria e Lirë", i cili përfaqëson të gjithë ata shqiptarë, që duen me pa në Shqipëri një qeveri demokratike, e cila do t'i sigurojë popullit shqiptar të gjitha liritë politike dhe të drejtat njerëzore që i janë mohue" (Deklaratë e Komitetit Shqipëria e Lirë, 1949)

"Një komitet i përbashkët do t'ishite një vegël e çueshme për të rifituar të drejtat kombëtare. Por a nuk mendoni edhe ju se kondita e parë e një organi, që do të merrte përsipër një barrë të tillë, duhet të jetë i formuar prej njerëzish mbi të cilët të mos peshojnë njolla dhe faje kundër Atdheut? Duhet të kemi parasysh se kundërshtarët e Shqipërisë do të kërkojnë të përfitojnë nga të tilla shkakë, për të luftuar të drejtat tona kombëtare. Nga ana tjetër, duhet të mejtujmë mirë efektin katrastofal që do të ketë pranë shqiptarvet, që kanë vuajtur dhe janë dërmuar gjatë këtyre vjetëve të fundit. Qysh mund të paraqitemi përpara opinionit publik krahpërkrah si bashkëpunëtorë me njerëz, mbi supet e të cilëve rëndojnë ngjarje të shëmtuara, që e bënë Shqipërinë një shkretinë, duke përfunduar në gjendjen e sotshme" – i shkruante Midhat Frashëri - kryetarit të Legalitetit, Abaz Kupit, 1948.

Letërkëmbimi i kësaj periudhe dhe disa artikuj problemorë të tij si edhe informacione të Sigurimit të Shtetit të botuar në këtë vëllim, janë tejet të rëndësishëm dhe interesantë për evidentuar veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar të pasluftës, si edhe përpjekjen madhore të Mid'hat Frashërit për çështjen shqiptare në bashkëpunim me aleatët anglo-amerikanë dhe gjithë diasporën antikomuniste shqiptare, si edhe për të qartësuar akuzat e pabaza ndaj tij dhe përbaltjen e padenjës të qeverisë komuniste të Tiranës e të Sigurimit të Shtetit, që çuan edhe në eliminimin e tij fizik më 3 tetor 1949.

Më duhet të theksoj se thujse gjithë materialet shkrimore të mbledhura nga Sigurimi i Shtetit komunist në dosjen voluminoze nr.5 prej 228 faqesh, fashikulli i Mid'hat Frashërit, ndonëse ato janë qëmtuar për të rrëfyer veprimtarinë "tradhtarë e kriminale" të Mid'hat Frashërit, siç shprehet edhe hyrja e dosjes, në të vërtetë, siç dëshmojnë qartazi edhe tekstet e botuara në këtë vëllim, vërtetojnë të kundërtën: asnjë fakt për tradhti e krim, përkundrazi dëshmojnë patriotizmin dhe veprimtarinë e pastër politike, kulturore dhe kombëtare të Mid'hat Frashërit, rolin e tij ndërkombëtar në mbrojtjen e çështjes shqiptare, por edhe të paqes në Ballkan dhe në Evropë, si edhe qëndrimin e tij demokratik dhe intransigjent në diasporën politike postkomuniste, që kulmon me themelimin e komitetit "Shqipëria e Lirë".

Me botimin e kolanës "Vepra e zgjedhur e Midhat Frashërit" dhe me vëllimin IX, shqiptarëve u kthehet një pasuri e madhe kulturore dhe historike e munguar.

## BREGDETI MBARSET NGA PYLLI

tregim nga Ylli Pango



...Si fillim, e nuhatën turistët besnikë të qytetit. Ata që nuk i ndaheshin çdo vit. Ashtu si çdo i dashuruar, që nuhat edhe ndryshimin më të vogël, në kurmin e së dashurës, ata e ndjenë rishtaz aromën ndryshe. Sikur nuk vinte më erë deti-det. Ose më saktë era e detit ende ndjehej por e përzjerë disi me një aromë tjetër krejt të kithët a-detare.

Sipas shërbimeve të specializuara të nuhatjes, po të kish, kjo duhej të vinte ngase, në qytetin bregdetas, kishin zbritur me barinj të krye, tufa bagëtish nga RrafshKali, pllaja që i bënte hije qytetit. Zbrinin për bar a tagji në ca kullota në fshatrat përreth e fusnin turitë deri në sinorët e fshatar-qytetarëve në periferi qyteti...

Më vonë, kjo rezultoi pjesërisht e vërtetë. Siç do shihet më poshtë ca nga ca, shkak nuk ishin veç ata por edhe e sidomos Drurët e pyllit...ata që si fillim erdhën me stiva për dru zjarri. (E kujt i duheshin në atë bregdet të bekuar?)...Ata vinin të lodhur e të djersitur, nga rrugë e gjatë... nuk kishin pasur ku, a as edhe nuk ju ish dashur ndofta as edhe të laheshin...

...Aroma e re vijoi ca kohë e durueshme. Pastaj aroma u kthye në erë...mmm...ç'ërë... përzjerë me një fije aromë jodi ...Njerëzit po ndjeheshin krejt ndryshe. U shfaq rrufa e përçit. Rishtaz në formë alergjie e më pas epidemie...

...Nuk duhet shkuar më tej...me parfumet. Ka pa fund shfrime(pffff), ankime, shkrime, e deri edhe filma e libra për to. Njeri syresh("Perfume: The story of a murderer") ngjethës...

...Veç turistët tashmë zhyteshin shpesh e më shpesh në ujë...ndofta edhe për ti shpëtuat ndjekjes së "aromave" të erës së re...

...Pastaj në qytet filloi të ndrojojë dialekti. U shfaq një "esperanto" e drunjtë miksuar me të folurën vendase, derisa kjo e fundit filloi të fragmentohej në copra gjithnjë e më

të vogla. Së fundmi gjuha e vendit u tret e u gëlltit përfundimisht në detin e tallazitur të lutjeve mbrëmësore plot ah-e uh-e, vaj. Ato vinin valë valë, e dëgjoheshin gjithnjë e më të shumta, nga faltoret e zhurmshme të sjella nga Drurët e pyllit nga shumë larg. Valët e detit u mbytën në to e nuk u dëgjuan më kurrë.

...Zakonet e gëzimet...u larguan nga ato të kripës së muhabetit, të peshkut e të jodit të detit e u kthyen në turli terbiatesh turli e turshi me shëllirë...

Veshja e Drurëve mbetej e rëndë e ndonëse ardhacakët djersiteshin nga vapa, a klima e re, ata nuk hiqnin dorë nga tradita e tyre. Pështymat në rrugë u bënë të pashqitshme e plehrat mbi to, simotra. Kjo edhe pasi koshat u kthyen në kosha mini-basketbolli për kalamajtë e të ardhurve të rinj

...Muzika e natës së vonë, që ish dikur shqetësim për turistët, u ndrrua fund e krye. Nga altoparantet tashmë buçisnin mjauullima, lehje, pallma, hungërima e deri klithma e britma të thekshme për hakmarrje...Turistët që vazhdonin vinin, fotografonin, ndonjëherë edhe zhyteshin në ujë "sa për krypë", e ikinin brenda dite. E bënë gjumin në brigjet matanë...

Ky trend i ri muzikor pat zbritur bashkë me Drurët, ardhur prej pylli. Ata patën ardhur për dru zjarri në bregdet, por filluan të përdoren edhe për shumë pune të tjera. Me ta rriheshin kundërshtarët, vendalinjtë. Njeri-tjetri. Por edhe shoferët e paditur, që parkonin vend e pa vend, nga zaptuesit e parkingjeve. Kërcenjët e vjetër zgjidheshin për ndezjen e zjarreve ekzotike të të parëve në breg.

...Deti huazoi pa e ditur, emrin e një lumi të turbullt kinez. U quajt me a pa të drejtë, Deti i Verdhtë.

...Emrat e vrasarëve më trima, ju a vunë rrugëve, hoteleve e shkollave

...Fasadat u lyen kaki e kafe...Ca edhe me

të zezë..Qyteti ndroi dhe emrin...U ruajt në at' emër, veçse pak, ngjyra e detit të dikurit. Në atë emër tash ishte bluja që cilësonte të gjelbrën. Qyteti u riuajt Pyllnaja Bojqilli.

Plazhi e rëra dolën me tepri dhe traujt u xhveshën syresh. U ngjesh dhe e ato u kthyen në treg gjigand të gjësë së gjallë. Turistët tashmë ishin të lirë të hidheshin si të donin në ujë. Në preferonin me këmbë a ndryshe me kokë, nga balta a betoni drejt e në det

Në bregdet filluan të therrnin e bënë kurban viça e derra. Të përbrendshmet ja hidhnin në formë flije, Poseidonit në detin tashmë quajtur nga ishvendatit edhe LumëeDet...Të ardhurit, që e mësuan atë emër perëndie nga vendasit, nuk e shqiptonin dot kollaj atë emër të panjohur. E ndryshuan pak. Me kohë i mbeti pak më shkurt Posedon...a ndryshe Zotnon a ndaras Zot-non...

...Edhe struktura demografike natyrshëm ndroi. U ndanë qartë dy shtresa. Ca i quajtën klasa. Në fakt grupe krejt të kithta: Njerëz dhe Drurë.

Në qytet nuk kishte më dru me pre. Por kishte Dru me Pare. Ndonëse ende me prona pa letra. Por boll me pare letra... Me ato letrat e tjera, kinse dokumenta a "dekumenta", qyteti vazhdonte të ishte i vendalinjve. Kjo u pat mjaftuar këtyre që për pak kohë, n'ato fillime, të bëheshin afendikonj. Me prona e me pare. Pasurim erdhi i menjëhershëm prej hoteleve e restoranteve të tyre të para...ngritur la e më la me kate pa leje e bërë më pas me leje të paguara bujarisht. Pastaj vendalinjtë u mërztitën, ndonëse veçse për ca pak kohë, duke punuar e fituar me hotele. Vendosiën t'ja bënë vetes më kollaj e të ndrronin profesion. Ata u a dhanë Drurëve të ardhur nga larg, me qira afatgjata, hotelet, restorantet, discot...disa edhe gratë... dhe ikën e fluturuan me të dashurat në brigje fqinje, ende të kaltra. Banorët autoktonë u kthyen kësisoj në turistë të kamur-dashnorë të detrave a brigjeve të botës.

Ata ikinin e mungonin pothuaj gjithë vitin. Mbetur pa mbrojtës, qyteti i pylltë kësisoj, kapi rastin e u rimboll i tëri në bregdet...Ky ishte një transformim i madh i natyrës nga dora e Drurit.

..."E megjithatë ai lëviz" deklaroi në media, Komandanti nga kryeqyteti.

...Turizmi vazhdoi të rritej, (për skeptikët paradoksalisht), në mënyrë galopante. Sado paksa ndryshe... Gjithsesi allosoj, nga gjithë bota zbritën e zbriten miliona për të parë çudinë...

Mrekullinë se si një det mori emër lumi... Habinë si u kthye më pas një det në pyll...e një breg në treg...

...Qyteti i dikurit nuk ekzistonte më. Nuk kish më as qytetarë e jo më guidë për turistët. Turistët e shijonin vetë çdo gjë. Vinin, fotografonin, e ja hypnin flugave për të ikur, ngrënë e pirë në brigjet më të afërta fqinje...

Pagesën e tureve, turistët e ndërgjegjshëm e hidhnin në një Kukuma të madhe në qendër. Kukumaja e Shtetit. Shteti vinte dy herë në vit: mblidhte taksat e Drurëve dhe merrte paratë nga Kukumaja.

...Kjo ndodhi vite më pas. Kur edhe qytetarët e riardhur, Drurët themelues të qytetit pyll në bregdet, e që kish kohë e quanin veten autoktonë... ikën edhe ata...Natyrisht pasi ishin pasuruar e bërë afendikonj edhe ata, me paratë e fituara nga dhënia me qira... e hoteleve të marra me qira. Zunë të largoheshin e të bridhnin, edhe ata si edhe qiradhënësit e parë të tabanit. Shkonin turistë, në brigjet e Botës. Edhe më tej...Nuk rrohej tërë jetën me punë...

Qyteti turistik i zbrazur pothuaj krejt nga njerezit...ish mbarsur ...i rilindur kësisoj së fundmi së bashku me bregdetin, i tëri si një pyll në det. Gjithsesi mbetet turistik...

Krijimi ndodh në errësirë. Monika Golemi shihet në ëndërr sikur ndodhet në një bibliotekë të stërlashtë, përtej kohërave dhe nuk arrinte të lexonte asgjë në pergamenat e gjata disa metroshe të bëra nga gjethet e palmës me tekste të gdhendura, në shkrimet e papirusëve prej tekstilësh pangjyrë me përzierje barishtesh, të mëndafshita, me lëkurë kafshësh të zhdukura apo në pllakat prej dylli, prej ari, prej argjendi dhe elementësh të tjerë të panjohur. Përpëlitej nga vrundulli i joshjes për vendin ku ndodhej, si dhe nga pamundësia për të shijuar dijen absolute duke lexuar pergamenat, gjersa një zë telepatik i foli: *Mos prit të lexosh tekste të shkruar. Diturinë e vjetër do e lexosh nëpërmjet një shqisë intuitive të pashfaqur ende.*

Ndërmarrja e elektrikut u ndërpriste energjinë çdo dy orë dhe orët e mbrëmjes, gjashtë gjer në tetë ajo i kalonte në shtëpi, mëpastaj shkante në Ministrinë e Rendit ku merrte komunikatën e lajmeve të ditës. Ishte redaktore përgjegjëse e fletës së tretë të së përditshmes TIRANA BULEVARD, e cila në njerën faqe kishte kronikën e zezë dhe në tjetrën faqen sociale. Mona i dorëzonte tekstet me fotografitë faqesësit dhe punonin bashkë gjer vonë pas mesnate për shtrirjen e tyre në faqe sipas skicës *menabò* që kishte bërë kryeredaktori. Politika dhe dy faqet e përgatitura nga Mona Golemi mbaronin të fundit, pastaj gazeta shkante në shtypshkronjë.

U hodh përpjetë prej rrapëllimës së xhamave në dhomat e shtëpisë që shihnim nga bulevardi Dëshmorët e Kombit. Qiriri u fik. Tritoli kishte shpërthyer në qoshe të lulishtes, m'u para Presidencës. Krisma tronditëse e qelqeve të dritareve të pallatit u shoqërua dhe me tingullin e thyerjes së porcelaneve të mamasë në kristalierën e madhe italiane dhe nëpër raftet e tjera ngado nëpër apartamentin me shumë dhoma.

E ëma, nartiotja Eleni Shteto, kishte serrën më të bukur të luleve në ndërmarrjen e gjelbërimit të kryeqytetit. Kur vinin delegacione të huaja i çonin për vizitë të shihnin çfarë kishte kompozuar ajo grua, që dukej se fliste gjuhën e luleve.

Diktatori i donte lulet mbi tryezën e tij vetëm nga dora e Elenit.

Por Mona kishte fobi ndaj luleve të këputura dhe qëkur filloi të kuptonte ende pa folur, qante me të madhe sa shihet një tufë me lule në shtëpi.

Eleni Shteto, qe dënuar nga e bija të mos mbante në vazot e shumta dekorative tufa me lule mbi tryezë. Nga një tjetër pasion i dyfishtë dhe zëvendësues i saj për lulet, porcelanet e cilësishëm më të mirë që i zgjidhte të kishin lulërima, njëjtë me natyrën, dukej se kishte në shtëpi një copë pylli të ngrirë në porcelan me bimë fieri, kuçumbele, nusepashke, manushaqe, lulet blu të jakës së këmishave të beqarëve, lulediellin e egër, fruta pylli, zambakë, kokoçe, luleprevezë, yllin e alpeve, manaferrë, luleçaji, zymbylë, trëndafila të përralltë nga të gjitha ngjyrat në setet e plota të servirjes në tryezë prej porcelani *Kaiser* të Bavarisë, në porcelanet e origjinës *Meissen*, setet e kafesë dhe çajit, porcelanet e Drezenit, pjatat bardhë e blu dhe të tjera me relief varur nëpër mure, peshtafët, supierat e vazot në blu kobalti me lulegjethet e arta, për gati dy shekuj e gjysëm, qyshse gjermanët zbuluan të parët në Evropë sekretet e "arit të bardhë", në muret dhe kristalierat e shtëpisë së tyre renditëshin nga pasioni i Elena Shtetos dhe rastësia e blerjeve ngjarjet më të rëndësishme të porcelanit gjerman.

Ishte koleksioni i rrallë dhe i çmuar i një lulishtareje prej gati shtatëqind pjesësh.

Pjesa më e madhe qe blerë në Leipzig dhe u soll me një kamion të madh transporti internacional të eksporteve bujqësore që quheshin *Albania*. Por edhe në shtëpinë ku hyri nuse Elena Shteto kishte gjetur mjaft antikuarat porcelani. Në Leipzig qe mjekuar për tre muaj në spital, nga *osteomyelitis* i kërcirrit të këmbës ku hoqi me operacion një *sekuetër* para se të lindte vajzën.

Figurinat e kafshëve, nudot e hirshme në porcelan të hollë të bardhë, dreri duke vrumbulluar dhe një ansambël i gjashtë grave

## KRIJIMI NDODH NË ERRËSIRË

tregim nga Luljeta Dano



të bukura, si nimfa me lopën e bardhë, që ishte vetë Evropa në porcelan *Meissen*, amforat e larta me lule nga poçarët mesjetarë të *Nymphenburgut*, xhamat e kristalierës, thesari i vogël i Elena Shtetos me rrallësi antikuarati, gjithë farfuritë e xhamat nga plasja e eksplozivit për bri pallatit ku apartamenti i tyre kishte tri dritare të ekspozuara nën rrezen e shpërthimit, qenë bërë kika.

Mona Golemi ndjeu zemrën t'i ngrijë si porcelan.

Edhe në serën e luleve që Eleni Shteto e ndërtoi me kate duke rritur nga lulet më të përzgjedhura të kopshtit botanik nga tërë bota, ishte sheshuar brenda javës për t'u ndërtaur shumëkatëshin nga firma e ndërtimit "7B".

- Ah, mama, sikur të kishe pasur pasion metalet dhe jo këto brishtësirat, lulet dhe porcelanet!

Prindërit e saj së bashku me gjyshërit ikën për gjithë natën në Greqi, pesë vjet më parë, para të dielës së votimeve të para pluraliste dhe ende nuk janë takuar me vajzën e vetme, as nuk kanë ardhur dot në shtëpi në Shqipëri dhe as përtej oqeanit, ku Mona Golemi me një bursë të Zërit të Amerikës ndoqi një kurs njëvjeçar gazetarie.

Prej vitesh Mona banonte e vetme në apartamentin me gjashtë dhoma, apartamentin e përbashkuar në një me apartamentin e gjyshërve. Strehimi politik që familja siguroi në Greqi, Mona ka një bindje të verbër që është për shkak se Adem Golemi, gjyshi i saj kishte qenë një nga eksponentët me status të veçantë në Sigurimit të Shtetit, me pseudonimin e pushtetit absolut të atyre që e dinin kodin: *Luani i Kuq*, por edhe gjyshe Miriami nuk duhej të kishte pasur një post të thjeshtë në strukturat e nëndheshme të shtetit. Një gjyshe e rreptë, pikërisht se nuk e ngrinte zërin kurrë për të edukuar dhe qortuar fëmijën, porse rregullat e saj të nguliteshin si prej një shkolle angleze. Edhe kur bënte punët e shtëpisë Miriam Golemi mbante këpucë me taka të larta.

Gratë e pallatit kishin dalë në ballkone dhe nëmnin elektrikut, policinë, orarin e shtetrrëthimit, lokalit *Non Stop* përmidis pallateve e bulevardit dhe tërë kallamkusuret që e kanë mbushur vendin me krime. Kriza e rebelimit popullor që shkaktuan firmat financiare piramidale, ku u fundosën miliarda kursime private dhënë rentierëve të fajdeve, u pasua me anarkinë e hapjes së depove të armëve të shtetit dhe shkatërrime në masë të institucioneve shtetërore e pasurive private, dëme që u llogaritën më të mëdha se ato të dy

luftave botërore. Njerëz të armatosur gjer në dhëmbë lëviznin sheshit të armatosur gjer në grykë, madje edhe majë tankeve në dhjetë ditët e para të marsit të Luftës Civile kur shteti ra, të cilat e ndanë vendin së kundërti më dysh, jug-veri. Bandat terroriste mbështesnin një nga dy partitë kryesore në vend, jugu mbështeste të kuqtë, veriu blutë. Shtetet fqinje ishin gati për ndarjen e vendit dhe aneksimin e copës pranë tyre, ëndërr nga e cila që me lindjen e shteteve ballkanike nuk hiqnin dorë.

Gazetat e përditshme kishin pak ditë që rifilluan të dilnin.

Krijimi i qeverisë së Pajtitit Kombëtar me koalicionin e dy partive kryesore risolli njëfarë rendi, ndonëse çdo ditë mbyllej me një bilanc lufte të vvarësh nga lufta mes bandave, plumbat qorr, aksidentet me arsenalin e ushtrisë që kishte marrë rrugët e nga maskat që grabisnin udhëtarët në linjat e brendshme dhe ndërkombëtare. Njerëzit po blinin masivisht armë në tregun e zi për ta mbajtur në shtëpi në rast *pogromi*, armë të reja që kishin ende grason e fabrikës së prodhimit. Armë të lehta e të rënda u kthyen në biznes fitimprurës.

Duke ecur mes xhamave të thyer Mona Golemi ngrii qindat e robdeshambrit të gjatë që ia kishin dhuruar e emta, Antigoni, pasi festoi pesëdhjetëvjetorin e quajti kufirin e fundit të pritjes për t'u martuar dhe ua ndau pajën e saj fantastike mbesave. Ndezi qiririn që linte pranë derës. Në derë gjendej një tufë me policë që kërkonin terroristin. Specialistët kishin identifikuar se ai kishte vepruar nga lartësia e pallatit duke targetuar lokalit *Non Stop* dhe diku nëpër skutat e pallatit ndodhej ende i fshehur. Në lajmet e mbrëmjes u dha se nga ai shpërthim, një fëmijë duke dalë nga *Non Stop* kishte pësuar djegie të rënda dhe dëme të tjera materiale. Pas atentateve të shumta dhe plumbave qorr rrugët e qyteteve mbusheshin me qirinjtë të shkrirë, memoriale dhe lule.

Shefi i uniformave blu hyri në sallonin e pritjes, por shumë shpejt doli dhe u tha policëve:

- Është plot me libra.

Pasi iu përgjigj telefonatës nga spitali i fëmijëve, Mona u ngjit një kat më sipër për të njoftuar fqinjët me qiri në dorë. E shoqëruar vetëm nga e ëma, vajza e tyre qe nisur me patrullën ushtarake në spital. Pas operacionit të apandisitit kishte humbur dëgjimin, se me të filluar mjekët ndërhyrjen, mbërriti një djalë me automatik në dorë, që kërcënoi doktorët t'i shpëtonin urgjent qenin e plagosur. Të frikësuar ata i dyfishuan vajzës barkçarë dozën e narkozës dhe i nxorën qenit plumbat.

Ndërmarrja e elektrikut nuk i kishte lëshuar ende dritat, kur ra sërish telefoni. Mona Golemi zbriti një kat dhe trokiti te Zeneli, fqinji nën ta.

- Janë ata të restorantit. Pyesin për nesër.

Zeneli, ish - ushtarak i vjetër i truprojave të udhëheqjes, kishte më shumë se një javë që mbante të prenotuar restorantin për drekën e përsëritjes së nënës që mendosej se do vdiste me sot me nesër. Plaka nuk po vdiste, por Zeneli nuk e anulonte prenotimin. Se nuk mund të turpërohej ai dhe gruaja, që për shkak të shtetrrëthimit të ngeleshin pa drekën e përsëritjes në lokal. Se në raste vdekjesh njerëzit vinin një për të qarë dhe njëqind për të përqeshur.

Nga hapja dhe mbyllja e derës, rrymat e ajrit shkundnin nëpër shtëpi aromën e trëndelinës së vjetër nga paja e porsaçelur e Antigoni, që ua ndau mbesave duke qeshur pa asnjë fije trishtimi për burrat që i kërkuan dorën dhe ajo i ktheu mbrapsht.

Qiriri fikej e ndizej nga rrymat e ajrit. Djali i armatosur që kërkonte policia kishte hyrë në apartamentin e saj.

- Motra, mos u tremb! Jam i Komitetit të Shpëtimit të Vlorës. Më ndihmo dhe më ke vëlla e shkua vëllait për gjithë jetën.

- Si të quajnë?

- Fatjon. Më ke vëlla e shkua vëllait, mos ki frikë nga unë.

- Fatjon, më ler të mendohem të gjejmë një zgjidhje.

- Drèèè! Motra, me libër shpie paskeni punuar t'gjithë të fabrika e porcelanit?!

- Epo, tani nuk kemi më asgjë, na i theve, ti!

- Motra, të blen vëllai gjithë fabrikën, vetëm më ndihmo sonte.

Dëgjoheshin zërat e skuadrës së policëve ende para pallatit. Mona Golemi i kalkuloi rrefeshëm me mend tërë situatat e mundshme duke menduar më të keqen që kriminelitë të ishte dhe i droguar.

- Motra, ma bëj këtë nder, për Zotin, mos ki fare frikë, se nuk do të vijë e keqe nga unë.

- Fatjon, edhe ti mos ki frikë nga unë. Jam gazetar e radios dhe nuk spiunoj njeri.

Kur udhëtonte me punë në periferi të largëta Mona Golemi thoshte gjithmonë kur e pyesnin se ku punonte, që ishte gazetar e Radios Kombëtare, e vetmja atëherë. Ende nuk kishin filluar radiot private. E përdorte si një mburojë, për të mbajtur një brez sigurie distancë para të panjohurve të çuditshëm që e shihnin si një çupërlinë delikate nga ato që gënjeheshin kollaj, drogeheshin e rrëmbeheshin në mes të ditës dhe në shesh të qyteteve për t'u trafikuar në perëndim. Statusi i gazetares së radios gëzonte respekt për ngrohtësinë e marrëdhënies njerëzore, por edhe impononte një marrëdhënie afërsie me shtetin.

- Fatjon, me këto gjëra nuk bëhet shaka, ndaj do e zgjidhim në favor të të dyve ne. Do e bëjmë kështu, do të presim edhe pak, pastaj unë do shkoj të vishem se po më shkon ora e emisionit në radio dhe vjen më merr makina e punës. Do i them shoferit që je kushuriri im nga Vlora. Do të të çojmë dhe do zbrëshesh ku ta mendosh se është më mirë për ty. Ti do më presësh këtu, atje është banja dhe në kthinë frigoriferi nëse do diçka. Unë do të kaloj pas asaj dere në fund tek apartamenti i gjyshërve dhe do e kyç nga brenda, sa të vishem për punë.

Ai ishte i panjohuri i njohur për të, si gazetar e faqes së kronikës së zezë dhe çështjeve sociale.

Ishte i njëjti tip djali me një a dy pistoleta nën brez, i pashkolluar, i rënë në para nga trafiqet e paligjshme ose nga fitimet marramendëse prindërore në tregun e etur për gjithçka të shitshme dhe pa rregulla. Ky tip në delir bënte të fortin kudo ku ndodhej.

Sepse kishte një gropë të madhe në gjoks, *Uni* - n e pambushur. Mjaft të mbushte atë: *Unë Jam!* dhe nuk kishte rrezik për momentin.

Kishte para saj në shtëpinë e zhytur në errësirë kriminelin, i cili me lehtësinë që mund të vriste njeriun e të shpërthente tritolin mund të bëhej qengj po t'ia shëtisje mendjen me fjalë, ta pyesje duke i dhënë mundësi të përgjigjej për gjëra që e ngrinin shpirtërisht,

zakonisht dobësi për ata që e llastuan si një djallush me bisht, ndoshta gjyshi i ikur nga jeta, ndoshta babai, sa të ushqente gropën e uni - t delirant në gjoks.

Makina e gazetës mbërriti para hyrjes, por pak më përtej sa mori kthesën e parë në Bllok, Fatjoni kërkoi të zbriste. Eci pa frikë mospërmas rrugës qendrore të Bllokut, aty, në qendër të qendrës.

Mona Golemi mori komunikatën e lajmeve të ditës në Ministrinë e Rendit dhe i mbaroi faqet e saj pas mesnate më vonë, se zakonisht. E kishte lakmuar si profesion gazetarinë, por po ndjehej çdo ditë e më shumë e frustruar nga kushtëzimi i pronarit të medias që kërkonte nga gazetarët zbulimin e lajmeve duke mbuluar thelbin e tyre.

U kthye në shtëpi e stërlodhur. Pasi kapi një batanije leshi në dritaren me xhamat e thyer, hoqi këpucët e pallton dhe fjeti pa u ndërruar në dhomën e gjyshërve.

Kur hapi sytë në mëngjes, u ndje më e rraskapitur, se kur ra në gjumë. Nuk ishte nga tmerrri i çmendurisë absurde të një realiteti që po shthurej dita - ditës, sa nga dhembja e thellë për vetminë e saj. Me prindërit dhe gjyshërit flisnin rrallë në telefon. Dyshuese se mos nuk ishin fizikisht pas telefonit, por kishin lënë për të kasetat të gatshme të rregjistruara më parë. Mona u bënte teste me kujtime të tyre të largëta, fjalët konvencionale, grimasat në përdorimin e batutave familjare, që nuk mund t'i dinte kush tjetër. Kur merrte përgjigjen e saktë, i terej ankthi. Ata ishin mirë aty pas fillit të telefonit që i lidhte dhe po flisnin bashkë në kohë reale. Por nuk kishin ikur vetëm ata. Pothuaj tërë fqinjët e tyre të vjetër kishin shitur apartamentet dhe shkuan në emigrim. Dy djemtë më të vegjël të Adem Golemit, Isaku kishte ikur me gjithë familjen e tij në Amerikë dhe i vogli, Andi, ende beqar dhe ollçaku i shtëpisë edhe më larg, qe vendosur në Australi. Shoqëria e ngushtë e Mona Golemit me të cilën qe rritur, shoqëria e gimnazit, e universitetit, të gjithë iknin, iknin, duke u shkullur përfundimisht nga ky vend. Ajo takohej në të përditshmen e saj me njerëz të rinj dhe puna nuk i linte më kohë për veten.

Hodhi tek plehrat sa më shumë mundi të mbledhë nëpër kuti kartoni qelqet dhe porcelanët e thyer. Doli të gjejë një punishte xhamash për dritaret.

Me të gjithë tregtarët që foli, ata përpiqeshin t'i mbushnin mendjen, me këtë rast të zëvendësonte dhe dritaret, por Mona Golemi këmbëngulte vetëm për vendosjen e xhamave të thyer. Më në fund e gjeti artistin e xhamit, Tan Korbin që merrte me të njëjtën përgjegjësi profesionale, si ndërtesuesin e fuqishëm, si porositësin më modest të xhamit për ndonjë kornizë fotografie të vogël. Telefoni pronarin e gazetës dhe i kërkoi tri ditë pushim, se ishte sëmurë dhe pa xhamat në shtëpi. Me vendosjen e xhamave në dritaret, etazherët dhe kristalierat, iu fut pandalim pastrimit të apartamentit të madh, duke mos lënë asnjë pjesëz xhami përtokë dhe asnjë objekt qelqi e porcelani sadopak të ciflosur a të krisur në raftet e kondrubeve dhe kristalierave. I kishte fobi enët e qelqit dhe të porcelanit kur kishin ndonjë ciflosje sadopak të dukshme ose të padukshme. Fare pak pjata e filxhanë që ishin të mbyllur në sirtarë e kuti kishin shpëtuar.

Kur u zgjua në krevatin madhështor të gjyshërve me dru arde, stil *Louis XV*, mendoi se do kish fjetur njëzet e katër orë pa ndalim, gjer në agun e ditës tjetër, por jo. Kishte fjetur dymbëdhjetë orë, ishte mbrëmje dhe kishte ende dhe një natë pushim. Ndezi qiririn e lënë mbi komodinë dhe u ngrit. Bëri një përshesh me kos, arra e me mjaltin e ngrirë disavjeçar prej rignoni të kuq nga malet e Labërisë, të cilin i gjyshi, Ahmet Golemi e kishte depozituar me shumicë.

Vendosi fishën e shkullur të telefonit në linjë, por nuk pati më nga telefonatat e zakonshme për fqinjët.

Dhoma e gjyshërve i qe dukur gjithmonë e stilit të vjetër, e papreferuar prej saj, por befas ndjeu joshjen për ta kthyer në dhomën e vet. Do ta lyente dhe do bënte disa ndryshime të vogla. Hapi dollapin e rrobave dhe nisi të

provojë fustanët e gjyshe Miriamit. Vetëm dy-tre prej tyre i bënin ngjitur pas trupit, Miriami kishte mbetur tepër elegante. Në anësoren pa një dorzë të vogël rumbullake, e rrëshqiti dhe mbeti para një dere dhome.

Pas dollapit të rrobave zbuloi derën e një dhomë sekrete.

Gjysma e fasadës anësore që sheh nga bulevardi kishte qenë gjithmonë e veshur me pllakatë, ndaj dhoma e izoluar dhe e fshehtë nuk duhej të kishte dritare.

U vu në kërkim të çelësit të saj. Ra telefoni.

Mona Golemi foli me të katër familjarët e saj, por nuk u tregoi asgjë nga ndodhitë e çmendura të ditëve të fundit. Kishte një vetëkontroll për çdo herë që flisnin në telefon duke besuar se kishte një vesh që i përgjonte duke i rregjistruar.

Çelësin e dhomës së maskuar e gjeti, në çastin e fundit kur i humbi shpresat për ta gjetur në brendësi të grupit të matrioshkave mbi komodinën nga ana ku flinte gjyshe Miriami. Me frikën më të madhe që kishte provuar ndonjëherë në jetë, çkyçi derën. Era e rëndë e mosajrisjes disavjeçare të mbyste. Dhoma ishte një magazinë, dhe me një shikim të parë nuk dalloi pajisje përgjimi, ose që të kishte shërbyer për përgjimin e banorëve të pallatit.

La dyert e dollapit dhe dritaret hapur në errësirë një copëherë.

Paramendoi se raftet metalike lyer me bojë vaji e të mbushura përplot me kuti po jeshile metalike, dosje të mëdha luksoze që nuk mund të ishin prodhuar në Shqipëri, duhej të kishin materiale përgjimi e dokumenta të rezervuara, në mos edhe pajisje përgjimi të sofistikuara. Ishte dhe një dollap me dy kanate i blinduar me një spango dyfishë që dilte nga brenda njerit prej kapakëve, kryqëzohej në dorezat rumbullake të kapakëve dhe qe fiksuar tek kapaku tjetër me plastelinë dhe e vulosur sipër me gërmën L dhe numrin 1. E pushtoi një angushti e madhe për provat e krimit që mund të gjendeshin aty. Nga padurimi nuk priti gjatë, mbylli dritaret edhe me perdet e rënda duke ndezur dritat në të dy dhomat. Dollapin e blinduar nuk e hapte dot pa gjetur çelësin.

Filloi me dosjet.

Mbi njerëz prej tyre shkruhej: POEZI. Brenda dosjes ndodheshin poezi të shkëputura, shkruar me shkrim dore apo të daktilografuara, e rrallë ndonjë prej tyre kishte inicialet e emrit në fund të vjershës. Nga zverdhja e letrës në tonalitete të ndryshme, mund të qenë shkruar edhe katër - pesë dekada më parë. Mona Golemi vetëm poezi dhe histori me poetë nuk do ia kishte marrë mendja se ndodheshin aty në depozitën më të rezervuar të gjyshit të saj.

Sapo kaloi fasha orare e dy orëve, ikën dritat sërisht.

La dritaret hapur në errësirë dhe u mblodh në kanape me një batanije. Nën dritën e qiririt kurdisi zemrekun e gramafonit *Victor Talking Machine* me manivelën.

*Perëndia thotë emrin e Tij për herë të parë. "Perëndia i tha Moisiut: "Unë Jam Ai Që Jam". Dhe Ai tha: Thuajini popullit të Izraelit: Unë Jam - i më dërgoi tek ju". (Eksodi 3:14).*

Vuri pllakën me vals *Love's Joy* në gramafonin të vjetër duke tentuar fort të zbraste kokën edhe nga mendimi më i imët dhe të shijojë pavarësinë komode ndaj elektricitetit. Përkëdheli në stampën ikonike të markës tregtare vendosur në mes të kasës, qenin e bardhë Nipper që dëgjon me kokën e anuar në grykën e hinkës së gramafonit tingujt hyjnorë të muzikës dhe reagon sikur të kishte dëgjuar zërin e të zotit të vdekur, Mark Barraud, vëllait të piktorit, Francis Barraud.

Pikëllimi i qenit Nipper pas dy vitesh, për të zotin e ndërës. *Hes Master's Voice*.

Kur erdhën dritat ndjehej e kapitur dhe u rikthye për të fjetur në dhomën e saj. Dritaren dhe kanatat e dollapit antik në dhomën e gjyshërve i la hapur për gjithë natën të ajroseshin.

Pikëllimi i Mona Golemit, se kush ishte ajo vetë. Po prindërit dhe gjyshërit e saj, kush ishin? Ku ishin ata dhe me ç'urdhër? *HMV*.

Sapo u mbushën pesë vjet pa u takuar.

*Hes Master's Voice*.

## POEMË E MARSIT

### Poemë nga Shqiptar Oseku



I.  
Një prej të vdekurve në ëndrën time ishte një djalë i vogël.  
I goditur në tamth, skaj veshit, me gjakun që i njomte flokët përreth plagës, ai më vështronte pareshtur.  
"Ç'kish ndodhur më parë?" më pyeti terapistja.  
"Asgjë", i thashë.

Mandej, m'u kujtua gjithçka.

II.  
Psikologët thonë se njeriu në ëndrra përpunon stimuli nga orët pararendëse.

III.  
Arsyeja e vrasjes qe banale: u ishin rrasë brendë e u kishin kërkuar çelësin e veturës.  
I zoti i shtëpisë ua jep mënjeherë.  
Mandej ua marrin lekët.  
Mandej ua marrin stolitë.  
Mandej u thonë të zhduken prej aty, se përndryshe!

Kur dalin janë në formë, me veturë të re. Por ishte mars lufte. Vetura s'ka benzinë. Kështu që nisen me bidon gjer te pika e karburantit.

U merr nja gjysëm ore, pse atje luajnë pak me pronarin para se ta vrasin.

Çelësin e veturës e kanë lënë brenda.

IV.  
Një nga fqinjët në lagje i ka parë tek largohen.  
Ai del tinëza dhe ua merr çelësin.  
S'u ngjinjtë duke grabitur, more të poshtë!

Dikur fqinji luante futboll me vrasësit. Tashti struket në qilar prej tyre, i ndien si ngushëllim se do të japë një sihariq sa të mbarojë lufta.

Edhe ai vdes atë natë, nga një bombë kuturu.

Çelësin e shkruaruar e merr me vete që t'ia tregojë Zotit.

V.  
Kur ata vijnë dhe shohin se mungon çelësi, kthehen në shtëpinë ku kishin marrë veturën.  
Në oborr marrin një hu të trashë.

Rrasen brenda, e i mbysin të gjithë që hasin duke u mësuar me hu, e me qyta armësh.

Djalë e gjejnë të fundit, të fshehur nën shtrat.

VI.  
Mandej kërkojnë kudo çelësin e veturës. Ndër trupat e vdekur. Në sirtarë. Nën palë rrobash.  
Por s'e gjejnë dot.

Të irrituar nga ajo ditë e gjatë, derdhen benzinë mbi trupa e u fusin flakën.  
E ndalen përjashta dhe admirojnë ca kohë bukurinë e zjarrit.

VII.  
Atë natë e mbijeton vetëm zonja e shtëpisë, pse s'rastis në shtëpi.

Unë e has plakën në rrugë, vite më vonë: e në mbrëmje më fanitet biri i saj.

(Ai djalë do ta kërkojë gjithmonë nënën e vet.)

VIII.  
Gjyshja ime thonte se ëndrrat janë shenja.

IX.  
"Ç'kish ndodhur më parë?" më pyet terapistja.  
"Asgjë", i them.

X.  
Por më kujtohet, gjithçka.

## BOTA ARBËRESHE NË NJË LIBËR

A i njohim ne mirë arbëreshët? A e dimë kalvarin e vuajtjeve dhe odisenë e shpërnguljes së tyre përtej brigjeve të Adriatikut e të Jonit, në një vend me gjuhë e zakone të ndryshme? A e dimë çngulime krijuan dhe cilat syresh u mbijetuan furtunave të kohës? A e njohim gjendjen e tyre aktuale ekonomike, kulturore, arsimore etj.?

Këto pyetje qëndrojnë në themel të këtij libri, i cili është një punim i zgjeruar monografik me karakter informues për historinë dhe vendndodhjen e ngulimeve arbëreshe, për kulturën e tyre shpirtërore dhe materiale, besimin, ritet, objektet e kultit, të trashëgimisë kulturore etj.

Autori i kësaj vepre duhet të jetë nga të paktët që ka mundur të vizitojë e të shohë nga afër pothuaj të gjitha vendbanimet arbëreshe në Itali, jo vetëm ato që njihen sot edhe zyrtarisht si të tilla - rreth 50 komuna e fraksione të tyre - por 558 qendra banimi, që kanë qenë arbëreshe, një pjesë e tyre deri edhe një shekull më parë, të cilat janë përzier, asimiluar, ose larguar drejt qendrave të tjera për arsye nga më të ndryshmet, duke mbetur, gjithsesi, pjesë e historisë dhe e kulturës së vendit ku jetuan.

Janë pikërisht këto 558 ngulime arbëreshe në Itali, të shtrira në 65 provinca të 17 krahinave (it. regioni), nga 20 të tilla që ka Italia, nga veriu në jug, për të cilat informohet në këtë libër, rreth 100 prej të cilave, me gjurmë më të dukshme shqiptare në ditët tona, trajtohen më

## ARBËRESHËT, SHQIPTARËT E ITALISË

### (Vendbanimet, Historia, Kultura, Ritet, Objektet e Kultit)

## NJË LIBËR ENCIKLOPEDIK NGA FATMIR TOÇI

gjerësisht e me hollësi.

Në librin vëllimor prej gati 1000 faqesh trajtohen, në një vështrim përmbledhës, historia mbi 500-vjeçare e arbëreshëve në aspektet e saj më kryesore, duke nisur nga aventura tragjike e kalimit të tyre nga Arbëria drejt Italisë, kalvari i dhimbshëm i vuajtjeve të tyre për t'u integruar në atdheun e ri dhe gjendja politike, shoqërore, ekonomike e kulturore që nga koha kur u vendosën në Itali e deri në ditët e sotme.

Për secilin nga vendbanimet që trajtohen në libër jepen shpjegimet më të nevojshme, duke ndjekur të njëjtën tematikë e strukturë: të dhëna për vendndodhjen dhe popullsinë, për historinë e vendbanimit, për besimin fetar dhe ritet, për objekte dhe vende për t'u vizituar, për festa, kremtime dhe takime tradicionale etj. Informacioni pasurohet me shumë kureshti e ndërhyrje të shkurtra (kelio), tekste e ilustrime - që në dukje

nuk janë pjesë integrale e rrëfimit, por në të vërtetë janë pjesë e rëndësishme informuese për të krijuar një njohje më të plotë të jetës së arbëreshëve - dokumente të kohës, pasuri shpirtërore e trashëgimi kulturore, personalitete të shquara sipas komuniteteve, folklor gojor e i shkruar, veshje tradicionale, gastronomia tipike dhe receta gatimesh arbëreshe etj.

Një kapitull i veçantë i është kushtuar rolit të kishës së ritit bizantin për ruajtjen e identitetit shqiptar dhe organizimit të kishave të ritit bizantin në dy dioqeza: të Ungërës (Lungro), në Kalabri, për kishat e ritit bizantin të Italisë kontinentale, dhe të Horës së Arbëreshëve (Piana degli Albanesi), për Italinë ishullore.

Për ta plotësuar informacionin, në fund të librit janë dhënë 4 tabela përmbledhëse: 1. Lista e plotë e vendbanimeve arbëreshe në Itali, ku jepen emrat në formën zyrtare italiane, arbërisht (aty ku ekzistojnë dhe sot), si dhe në formën e tyre në gjuhën

shqipe; 2. Emigracioni shqiptar në Itali në shek. XII-XVIII sipas rendit kronologjik; 3. Famullitë dhe kishat e ritit bizantin në Eparkinë e Ungras (Lungro); 4. Famullitë dhe kishat e ritit bizantin në Eparkinë e Horës së Arbëreshëve (Piana degli Albanesi).

## VLERËSIME PËR LIBRIN:

Vepra e Fatmir Toçit "Arbëreshët - Shqiptarët e Italisë (Vendbanimet, historia, kultura, ritet, objektet e kultit)" është vepër e veçantë historiografike. Me librin e tij jashtëzakonisht të rëndësishëm, më të madhin me përmbajtje, me të dhëna, me të reja, me mendime, me të vërteta, me vlerë për Arbëreshët deri sot, i ka pasuruar dijet tona për të shkuarën, të përtashmen, për fatin e tyre, kur të lavdishëm e kur tronditës gjatë shekujve të pasmërgimit, por edhe i ka shtuar, i ka pasuruar, i ka thelluar edhe ndjenjat tona ndaj vëllezërve tanë të lashtë - Arbëreshëve, italo-shqiptarëve të Italisë.

*Akademik Rexhep Qosja, Prishtinë*


Asnjëherë më parë nuk jam hasur me një vëllim që ka mundur të përmbledhë kaq mjeshhtërisht tematikat dhe tiparet kryesore që karakterizojnë universin e identitetit të këtij minoriteti gjuhësor në Itali. Me një këndvështrim enciklopedik, libri i Fatmir Toçit vlerësohet si një vadamekum i shkëlqyer që gërsheton me mençuri shkencën dhe rrëfimin popullor,

FATMIR TOÇI

# ARBËRESHËT SHQIPTARËT E ITALISË

VENDBANIMET, HISTORIA, KULTURA, RITET, OBJEKTET E KULTIT

BOTIMET TOENA



Pikturë nga Pashk Përvathi

Fatmir Toçi është lindur në Tiranë, në prill 1958. Studioi në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Financës dhe, më pas, në atë të Gjuhë-Letërsisë.

Ka punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe të administratës shtetërore në poste drejtuese, pedagog i gjuhës italiane në Akademinë Ushtarake Tiranë etj., deri në janar të vitit 1993 kur themeloi Shtëpinë Botuese TOENA, më pas Institutin e Librit dhe të Promocionit (ILP) dhe Revistën "Universi Shqiptar i Librit".

Ka qenë kryetar i Shoqatës së Botuesve të Shqipërisë (1998-2000, 2003-2008), kryetar i Lidhjes së Botuesve Shqiptarë (2000-2003), anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar (2005-2009), nënkryetar i SHKA "Labëria" (1999-2009), si dhe deputet në Kuvendin e Shqipërisë për dy legjislatura (2009-2017).

Është autor i disa botimeve (fjalorë e metoda) për mësimin e italishtes, veprave historike dhe ka veprimtari të gjerë publicistike për probleme kulturore, politiko-shoqërore etj.

Veprat kryesore të botuara:

Gjuha italiane pa mësuës (1992); Fjalor shqip-italisht / italisht-shqip, 20 000 fjalë (1993); Foljet e gjuhës italiane (1995); Skënderbeu, novelë për fëmijë me ilustrime nga V. Kokolari (2000); Enciklopedi e Kurveleshit (Bashkautorë: N. Meçaj, Xh. Çelaj) (2009); Një rrugë për banorët e Lumit të Vlorës (2013); Ditari i përballjes me Koronavirusin (2020); Arbëreshët - midis realitetit dhe mitit (2021); Arbëreshët - Shqiptarët e Italisë (Vendbanimet, historia, kultura, ritet, objektet e kultit) (2023).



aftësinë e të treguarit dhe rigorozitetin metodologjik, duke arritur në këtë mënyrë plotësisht objektivin për të tërhequr vëmendjen e lexuesit, kureshtja e të cilit jo vetëm nxitet prej tij, por gjithashtu ushqehet plotësisht.

**Prof. dr. Matteo Mandalà,**  
Universiteti i Palermos

Është historia e ribërjes së vështirë të jetës në vend të huaj nga ana e një populli të detyruar të braktisë vatrat e veta. Autori identifikon faktorët që sollën rrudhjen e faktorit arbëresh. Por ai nënvizon fort edhe faktorët e ruajtjes, ku rendit gjuhën, kulturën, institucionet tradicionale, kujtesën historike, besimin e krishterë të ritit bizantin. Studimi prosopografik mbi personalitete të shquara të botës arbëreshe e çimenton bindshëm idenë e

autorit, se bota arbëreshe është një pjesë e pandashme e botës shqiptare, gjithashtu një faktor me rol të madh në proceset e zhvillimit historike e aktuale të Italisë fqinje, dhe si e tillë ajo duhet ruajtur e duhet zhvilluar.

**Prof. dr. Pëllumb Xhufi,** Akademia e  
Shkencave, Tiranë

Është padyshim libri më i plotë, më gjithëpërfshirës dhe më poliedrik mbi botën arbëreshe. I shkruar me erudicion, ky libër trajton me të njëjtin dimension historinë, gjuhën, kulturën, gjeografinë, duke përcjellë njëkohësisht ndjesitë dhe shqetësimet e një udhëtari të palodhur të katundeve arbëreshe. Është një enciklopedi e "gjakut të shprishur" të Arbërit, që nuk duhet të mungojë në asnjë bibliotekë.

**Prof. Neritan Ceka,** ish-ambasador  
i Shqipërisë në Romë

## PRONONCIMI I AKADEMIKUT REXHEP QOSJA PAS BOTIMIT TË LIBRIT

Arbëreshët.

Sot kemi në Tiranë një Qendër të Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Sot kemi pjesëmarrje të Arbëreshëve gati në të gjitha veprimtaritë dhe manifestimet mbarëkombëtare në Shqipëri, kryesisht në Tiranë.

Sot i kemi të botuara apo të ribotuara pjesën më të madhe të veprave letrare, shkencore e publicistike të autorëve më të shquarë arbëreshë.

Sot i kemi të botuara një varg shkrimesh më të vëllimshme apo më modeste për të djeshmen e të përtashmen e Arbëreshëve.

Sot i kemi të botuara për Arbëreshët dy vepra të mëdha, shumë të rëndësishme, të studiuesit shkencor, shkrimtarit, përkthyesit, botuesit Fatmir Toçit.

Sot letërsia e arbëreshëve prej se krijohet nuk trajtohet më e veçuar si dikur, siç trajtohej edhe letërsia e Kosovës, por si përbërëse e asaj letërsie mbarëkombëtare që e quajmë Letërsia Shqipe.

Sot Arbëreshët nuk janë vetëm Ata, por janë edhe Ne, Ne, Ne, Një popull, Një Komb Arbëror, Shqiptar.

Për mendimet e këtilla më ka nxitur vepra e dytë e Fatmir Toçit me titullin *Arbëreshët – shqiptarët e Italisë – vendbanimet, historia, kultura, ritet, objektet e kultit.*

Është kjo vepër e madhe, me vëllimin, 934 faqe të formatit të madh 16.5 x 24 cm dhe e madhërisht me përmbajtjen e saj. E me vlerën e saj. Nuk është kjo monografi e zakonshme e një çështje, por një monografi enciklopedike, që u kushtohet Arbëreshëve, domethënë Ne, Neve.

Baza e gjithëjetshme e njerëzve, e popujve janë Gjeografia dhe Historia. Mbi këtë bazë të qenies, ekzistencës së Arbëreshëve, të Neve, shkurt këndej e në vazhdimësi andej detit e deri sot janë, ndodhin, trajtohen, shihen, të gjitha ato të veçanta e të përgjithshme që e përbëjnë Jetën e Arbëreshëve: shpërngulja e tyre prej Atdheut, vendosja e tyre në Vendin tjetër në 17 krahinat italiane, në 58 komuna, në 558 qendra banimi, në 65 provinca, kultura e tyre, qytetërimi i tyre, ritet e tyre, objektet e tyre të kultit, mitet dhe mendësitë e tyre, politikat dhe ideologjitë e tyre, mërgimet e mëvonshme të tyre, asimilimet e disave të tyre, gëzimet e dhembjet e tyre, Gjithësia e tyre me rinitë, pleqëritë e rilindjet.

Lexues të dashur!

Lexojeni enciklopedinë e titulluar Arbëreshët – shqiptarët e Italisë. Do të mësoni shumëçka s'keni ditur e s'dini për Arbëreshët, për Ne, për të Djeshmen, për të Sotmen e për të Ardhmen. Dhe do të pastroheni shpirtërisht, do të pasuroheni etikisht e do të lartësoheni gjithëkombëtarisht. Vëllazërisht.

Prishtinë, 20.03.2024



## Botim i ri nga Onufri NJERIU QË SHET GJAK nga Yu Hua

Përktheu nga kinezishtja: Iljaz Spahiu

Si një nga dhjetë librat më me influencë të dekadës së fundit në Kinë, ky roman i vlerësuar ndërkombëtarisht, shkruar nga një prej shkrimtarëve më të mirë bashkëkohorë të Kinës, paraqet një portret të guximshëm të jetës nën kryetarin Mao.

Xu Sanguan, një shtytës karroce në një fabrikë mëndafshi, shton të ardhurat e pamjaftueshme duke shkruar rregullisht të shesë gjak. Vajtjet i bëhen tmerrësisht të shpeshta, teksa orvatet të mbajë gruan dhe tre djemtë e tij në kulmin e Revolucionit Kulturor. Ai shkatërrohet kur zbulon se djali i preferuar në fakt ishte pjellë e një marrëdhënieje të fshehtë midis gruas së tij dhe një fqinji, provon çnderimin më të madh, kurse gruaja e tij qortohet publikisht si një prostitutë. Megjithëse varfëria dhe tradhtitë e regjimit Mao e kanë shteruar, Xu Sanguan në fund gjen forcë në lidhjet e gjakut me familjen e tij. Me një intensitet të rrallë emocional, përshkrime të gjalla që të mbajnë mbërthyer dhe dhembshuri të qartë, Yu Hua na jep një panoramë të jashtëzakonshme të jetës njerëzore në rrethanat e vështira të ditëve të një njeriu.



Yu Hua

NJERIU QË  
SHET GJAK

Përktheu nga kinezishtja: Iljaz Spahiu

OnufriRoman

Dino Kalenja, Hero i Popullit, ra për lirinë e Shqipërisë më 29 mars 1944. I dashuruar dhe poet, ai rrugën e poezisë e ëndërronte të lidhur me jetën e ardhme në paqe. Të ëndërroje në kohën e Dinosh, do të thoshte edhe të ndërtoje një botë imagjinare me sy të hapur, në përpjekje për t'u arratisur nga një realitet i vrazhdë. Në përgjithësi të ëndërrosh do të thotë ta harrosh materialitetin dhe të afrosh me kozmosin. Ose të ndërtosh një tjetër botë, të mbushur me dashuri.

Ëndrën e tij poetike dhe dashurinë Dinua i vuri në altar të lirisë. "Për dashurinë jap jetën / për lirinë fal dashurinë". Këto vargje të Petëfit janë bërë emblematike. Gatishmëria për të vdekur për atdheun kërkon përherë një analizë të thellë të vlerave etike dhe morale të atyre që u flijuan për lirinë. Nëse i japim karakter historik konceptit të atdhedashurisë, duhet të shkojmë deri në Antikitetin grek e pastaj në atë romak për të kuptuar sesi kjo ndjenjë i shoqëronte martirët të shkonin drejt vdekjes si zgjedhje e pakushtëzuar.

Në ditët tona, studimet në fushë të antropologjisë historike në botë na lejojnë të shtrojmë pyetje të shumta që e ndriçojnë qëndrimin patriotik të individëve dhe sidomos të rinisë për të pranuar « më mirë i vdekur, se gjallë dhe në robëri ». Flijimi i dëshmorëve të lirisë simbolizon triumfin e paqes mbi luftën, kundër kësaj egërsie barbare që mbjell vdekje kudo që shfaqet. Qysh nga *Iliada* e Homerit, shprehjet e përdorura nga Hektori, hero i Trojës, por edhe nga Priami, mbret i Trojës dhe i ati i Hektorit „të luftosh për atdheun“, është oguri më i mirë i një kohe që është duke ardhur dhe një qëndrim që e sublimon vdekjen. Këto shprehje i gjejmë pastaj te Likurgu dhe Aristoteli. Në veprën e Tirtut hasim shprehjen e kuptimplote "vdekje e bukur", kur është fjala për vdekje për atdheun. Tragjikët do ta zhvillojnë më tej konceptin e vdekjes dhe të sakrificës për atdheun e rrezikuar, duke e trajtuar si temë më vete.

Qëndrimi i historianëve është më neutral. Herodoti, të cilin Ciceroni e quan « baba i historisë » e që udhëtoi shumë dhe që dëshmitar i disa luftërave, në veprat *Histori* dhe *Anketa*, në vitet 450-445 para erës sonë përshkroi edhe dëshirën për të nxitur bashkimin e grekëve kundër barbarëve. Pas tij Tukididi në veprën kryesore *Lufta e Peloponezës* u përpoq të analizonte shkaktuesit e luftërave, por edhe motivet e brendshme energjike të luftëtarëve para dhe gjatë betejës. Ai thotë se nuk bëhet fjalë për të reflektuar, por për të vepruar kur bashkësia e njerëzve në emër të të cilëve lufton për t'i mbrojtur, është e kërcënuar. Kjo nuk do të thotë se para tyre nuk kishte pasur përpjekje për të rrefyer ngjarjet e së kaluarës në luftë. Grekët kishin pasur me epopetë e tyre një model të rrefimit letrar që lidhej me heronjtë realë, por edhe me heronjtë mitikë. Edhe Plutarku, më vonë, e thekson se vdekja për atdheun është në një farë mënyre vdekje e dëshiruar: *Pro Patria Mori*. Ai ndalet shumë te marrëzja e luftës në përgjithësi, por kur flet për luftën për mbrojtjen e atdheut, ai thekson se pjesëmarrja është një zgjedhje dhe vërtetim i identitetit brenda një bashkësie njerëzore. Rënia për atdhe e shndërron martirin në një individ që u përket të gjithëve. Ai ushqen sjellje qytetare përmes nderimit, luleve, varrezave të veçanta, shtatoreve dhe përkujtimet me ligjërimi funebre, me poezi dhe këngë.

Dino i përkiste brezit të shkolluar që u hodh në luftë, i udhëhequr nga bindja se të japësh jetën për të mbrojtur atdheun dhe vlerat e lirisë, është detyrë dhe nder. Ai brez e dinte se do të derdhej gjak, se çmimi i lirisë ishte i rëndë, por që pastaj do të vinte një botë e re. Vënia e jetës në altar të lirisë nga rinia dhe patriotët shqiptarë në Luftën e Dytë botërore përbalë pushtuesve nazi-

## NJË ËNDËRR POETIKE DHE NJË DASHURI NË ALTARIN E LIRISË

nga Feride Papeleka

fashistë, mbetet një model frymëzues që u ka dhënë kuptim jetëve të shumë brezave të mëvonshëm.

Sakrificat e partizanëve ndryshoi Historinë. Dhe kjo nuk është aspak një qasje patetike për t'i dhënë forcë frazës dhe as për të nxitur emocionet e lexuesit. Luftëtarët e lirisë ecën në atë rrugë që mund të sillte lirinë përmes vdekjes. Ata që ranë në luftë për liri, para se të ishin heronj të kësaj lufte, ishin njerëz plot shpresa dhe ëndrra, plot dashuri. Dino kishte qenë liceist në liceun francez të Korçës, ku ishte mbrojtur me një kulturë iluministe. Pas kësaj, ai kishte shkuar në Itali, në Romë duke e zgjeruar edhe më tej dritën e kulturës së tij. Pas disa vjetëve studimi dëshira e tij për paqe dhe jetë të lumtur si e të gjithë të rinjve ishte e madhe. Ai e përjetoi rëndë pushtimin e Shqipërisë nga fashizmi më 1939, pikërisht kur ishte në Itali dhe kishte zbuluar qartë ëndrën e tij poetike. I dhënë pas paqes dhe humanizmit, në shpirtin e tij poetik zë rrënjë antifashizmi.

Gjatë kësaj kohe, ai u njoh në Romë, me një poet, Salvatore Quasimodo (Kuazimodo), i cili më vonë do të bëhej nobelist, që është një nga poetët më të mëdhenj italianë të shekullit XX, dhe një nga figurat e mëdha që futi hermetizmin e mitologjisë së lashtë në ligjërimin poetik. Dinua ka edhe një foto me Quazimodon, dhuruar prej vetë poetit nobelist me autograf. Studenti shqiptar i Akademisë Ushtarake të Romës kishte një shpirt të ndjeshëm poetik. Ai kishte filluar të shkruante poezi qysh në lice. Dhe prandaj u afrua me Quazimodon. Por ata i bashkoi edhe shpirti antifashist, për të cilin ka folur gjerësisht Moikom Zeqo në një shkrim kushtuar miqësisë së Dinosh

me Quazimodon, në mars 2014, në të cilin botohen për herë të parë edhe disa fotografi të Dinosh, ruajtur nga familja e që disa po botohen edhe në ExLibris. « Dino është shqiptari i vetëm në botë që ka fotografi me nobelistin Quasimodo », shkruan Moikom. Dhe pyetjes retorike të tij « Po çfarë e ka lidhur Dinon me Quasimodon ? », ai i përgjigjet : « Poezia ».

Dinon e dënuan gjatë kohës së studimeve, pasi mori pjesë në një protestë antifashiste kundër politizimit që i bëhej vendosjes së bustit të Skënderbeut nga fashistët në Romë, të cilët e quanin Romën kryeqytet të përbashkët të Shqipërisë dhe Italisë. Por ai në këtë kohë përjetonte edhe takimet e dashurisë me një italiane të re, e cila quhej Loleta. Në një fotografi që ka dalë me Dinon, ajo shkruan : "A Dinucio, Roma" dhe "Come pegno d'amore - LOLETTA". E dashura e thërriste Dinucio duke e italianizuar emrin e tij, një hollësi që dëshmon se dashuria e tyre ishte e thellë. Ajo ëndërronte të vinte në Shqipëri.

Më 1942 Dino u kthye në Shqipëri si shumë bij të këtij trualli. Ai i la studimet dhe dashurinë përtej detit. Atdheu i pushtuar nga fashizmi duhej çliruar. Sepse në hierarkinë e vlerave ka diçka që qëndron më lart se gjithë të tjerat. Dhe ajo është liria. Përkushtimi i tij si i të gjithë atyre që mendonin për lirinë, atëherë kur vdekja i përgjonte në çdo hap, ishte që të bënte diçka të vyer për lirinë e vendit të vet. Prandaj edhe u lidh shpejt me lëvizjen antifashiste dhe me organizatorët e luftës. Fillimisht ai u punësua në Zyrën sekrete të xhandarmërisë fashiste, për të mbledhur informata në strofkën e armikut. Në gusht 1943, pasi organizoi arratisjen e disa të burgosurve nga spitali i burgut fashist




në Tiranë, ai u arratis edhe vetë në Pezë si luftëtar i ri. Prej andej iu bashkua batalionit partizan "Ismail Klosi", të Mallakastrës si një nga drejtuesit e tij të përgatitur. Dino bëhet artëherë edhe një nga frymëzuesit e betejave duke qenë në ballë të luftimeve. Në çantë mes dokumenteve si komandant batalioni, ai mbante edhe një fletore ku hidhte herë pas here motive poezie si: *Pushka* (vrastare), *Mazho partizani* (ushtari italian që u fut në radhët e batalionit të tij), *Flutura*, *Dashuria*, *Loleta*, *Deti në mes etj.*, me një lloj lirizmi të veçantë, sado që lufta kishte pamjet e saj tragjike, me betejat, zjarret dhe vdekjet.

Kontributi i tij në drejtim të luftës, u konkretizua me shumë aksione luftarake. Përvoja e tij ushtarake ishte e madhe, por sulmet armike ndihmoheshin edhe nga kolaboracionistët e sillnin dëme të mëdha. Në një betejë të ashpër kundër forcave naziste më 29 mars të vitit 1944 Dinua, u godit nga plumbat dhe ra. Ishte një betejë e ashpër dhe e pabarabartë në një vend të quajtur Kodrat e Kasnicës, midis Ballshit dhe Patosit. Lufta e vrau edhe dashurinë e tij edhe ëndrën poetike. Por Dino Kalenja shkroi një akt të madh për atdheun. Pa gjakun e tij e të dëshorëve të tjerë nuk do të çlirohej Shqipëria. Prandaj poetët dhe aedët popullorë kudo në botë kanë thurur vargjet më të ndjera për martirët e lirisë. Mund të përmendim, poetët modernë të Greqisë sonë fqinje, poetët e tjerë në disa vende të Ballkanit, poetët talianë, shqiptarë, jugosllavë, spanjollë dhe amerikanë, vendet e të cilëve u përfshinë në një luftë të pabarabartë.

Në letërsinë franceze poetët kanë shkruar për heronjtë e Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë. Mes tyre Louis Aragon-i poet komunist francez përjetoi Luftën e Parë dhe Luftën e Dytë, si dy katastrofa të mëdha të njerëzimit. Në një poemë të librit *Romani i pambaruar (Le Roman inachevé)*, me nëntitull *Poème* - fjala „roman“ përdoret këtu në kuptimin e saj mesjetar tregim në vargje -, ai thotë: „Vdekja nuk ua dridh qerpikun e syrit Partizanëve“. Sigurisht janë me dhjetëra e dhjetëra poemat franceze që i kushtohen qëndrimit heroik para vdekjes duke filluar me poemën e famshme *Baladë për të varurit (Ballade des pendus)* e poetit François Villon në shekullin XV dhe duke vazhduar me poetin Victor Hugo në shekullin XIX me poemën *Pas betejës*. Edhe në veprat e poetëve shqiptarë duke filluar me De Radën dhe Gavril Darën, të Riun, me Rilindësit që himnizuan kohën e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, pastaj me poetë që kënduan për udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për prijësit e kryengritjeve popullore, pastaj poetët që i kënduan trimave që ranë në luftën e Dytë botërore dhe që i simbolizon aq natyrshëm edhe kënga popullore me vargjet: „Moj Luftë e Dytë botërore / Të bukur trima që more“, apo „Seç erdhi behari ra një zi për ne, / lule more trima që ratë për atdhe“, me vargjet kushtuar trimave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fund të shekullit XX e shumë vepra të tjera në prozë, në dramaturgjiri në filmografi, në pikturë, në fotografi etj.

Përkujtimi i rënies së Dinosh dhe trimave të tjerë që u flijuan në Luftën e Dytë botërore për liri është një moment i madh reflektimi për të vënë edhe njëherë në dukje vlerat që i motivuan partizanët të futen në një luftë që



Dino Kalenja (djathtas) me poetin Salvatore Quasimodo, pranë një skulpture në një park. Treviso, tetor 1940.

mund të sillte vdekjen. Ata njerëz, të rinj e të reja, burra dhe gra në vijën e parë apo në prapavijë, të cilët morën pjesë në aksionin e madh çlirimtar duke e rreshtuar Shqipërinë e vogël në krah të Aleatëve të mëdhenj, do të mbeten të pavdekur.

Edhe Dinua ishte një i ri, një poet që e vuri jetën e tij të re së bashku me një ëndërr poetike dhe me dashurinë në altarin e lirisë. Jeta e tij tashmë njihet prej kujtimeve të shkruara dhe të treguara nga ata që e njohën nga afër si kujtimet e vëllait të tij Xhevit Duraj që pasi u vra Dinua, shkoi në luftë fare i ri, pa i mbushur ende të 16 vjetët për ta zëvendësuar - një gjest i jashtëzakonshëm që lidhet me shpirtin luftarak të atit të tij, Bektashit, i cili në moshë të re kishte përcjellë xhaxhanë e tij në Luftën e Vlorës dhe tani përcillte djalin e dytë - nga kujtimet e shumë partizanëve që luftuan me të; nga kujtimet e veçanta të zotit Myrteza Pepa, që u ndodh pranë tij kur u vra e që tregonte se si qëndroi Dinua ende në këmbë kur breshëria e automatikut e goditi në kraharor. Zoti Pepa, atëherë, partizan i ri 16 vjeçar, kishte fiksuar një buzëqeshje të shkurtër, një lloj qëndrese të Dinos ndaj vdekjes, në kuptimin se nuk besonte se do të rrëzohej dhe nuk done të rrëzohej. Jetëshkrimi i vëllait tjetër të tij Qani Duraj, mbështetet në këto kujtime dhe në kujtimet e gjalla e reliket e familjes. Për të mbajtur gjallë kujtimin e tij kanë kontibuuar edhe Zenel e Ylli Duraj, nipërit e Dinos, djemtë e Xhevit Duraj.

80-vjetori i rënies së Dinos na sjell edhe njëherë në mendje trajektoren e jetës së tij të shkurtër: lindja në 4 nëntor 1919, shkolla fillore në Ballsh, liceu francez në Korçë, vajtja në Itali, njohja me Salvadore Kuazimodon që e ringjalli ëndërrën e tij për t'u bërë poet; kthimi në Shqipëri me zemrën të mbushur me dashurinë e një vajze italiane; pjesëmarrja në luftë; rënia heroike më 29 mars 1944.

Si një i ri dhe poet, me ide progresiste, mbrojtës i zjarrtë i lirisë ai do të mbetet burim frymëzimi për brezat e rinj. Dëshmi të shumta nxjerrin në pah kontributin e tij në luftë. Ajo që e lartëson një martir nuk është thjesht vdekja, por çështja për të cilën ai dhuron jetën e tij. Kjo çështje e madhe është LIRIA e ATDHEUT. Dhe prandaj emri i tij është gdhendur në kujtesën tonë kolektive.



Dino dhe Loleta, Romë.

## PO KALON AJO...

Poezi nga Rexhep Polisi



### KUR MBRËMJA TË VIJË...

Kur mbrëmja të vijë e qetë në muzg  
E kur Dielli të mbyllë synë e zjarrtë,  
Atëherë unë dua ëmbël të të uth  
Dhe të të përkëdhel me të miat fjalë.

Kur mëngjesi të vijë me pak vesë  
E kur dita të çelë ashtu si përherë,  
Si toka e zhuritur shiun do të të pres,  
Bashkë të nisim udhën në Pranverë...

### NË TË TJERË QIEJ

Ti lodron  
E ngazëllehesh lumturisht.  
Fluturon  
Në të tjerë qiej,  
Përhumbesh  
Përmes kaltërsish,  
Hapsirës pafund...  
Pastaj kthehesh sërish  
Më e lumtur se lumturia,  
Kur strehë gjen  
Në ëndrrat e mia...

\*\*\*

Nëse më ikën si fllad ndër duar,  
Unë bëhem erë dhe të arrij.  
Nëse më vjen si vesë mëngjesi,  
Bëhem borë dhe në çast shkrij...

### PO KALON AJO...

Po kalon ajo... dhe shndrit rruga,  
Ku shkel solemne këmb' e saj.  
Po kalon ajo... (me emrin Grua),  
Kthejnë kryet lulet skaj më skaj.

Po kalon ajo... dhe Dielli venitet;  
Dita zbehet si e zënë në faj...  
Po kalon ajo... (me emrin Grua),  
Bota merr frymë nga frym' e saj.

### MES MALESH PA KUPTIM

Si një re e përhime  
U fashite  
Në qiellin e murrme  
Duke lënë pas  
Dhembje e trishtim.  
Tani, i vetëm  
Mes malesh, pa kuptim  
Numëroj rrahjet  
E zemrës  
Dhe hapat e tu  
Në ajrin e kujtesës.

### QYTETI IM

Kur nata të bjerë e qetë në qytet  
E terri të nderet në perëndim,  
Aty do të doja të isha nëpër net,  
Qytetin ta pushtoja në përfaqim.

\*\*\*

Ka ditë që nuk e dëgjoj zërin tënd  
Dhe ndjej si tingujt shuhen brenda meje;  
Ka ditë që fjala e pathënë më dhemb  
Dhe s'guxon të marrë udhë drejt teje!

Ka ditë që nuk e dëgjoj zërin tënd,  
Ndërsa Dimri zbardh në malet e lartë.  
Atje, tej bardhësisë do ta gjej një vend  
Për dashurinë tonë të zjarrtë...

### LLAVË PËRVËLUESE

Tani jemi dy të huaj,  
Dy të huaj që ecin  
Në kahe të kundërta...  
Asnjëherë nuk përballemi  
Me Diellin.  
I shmangemi llavës përvëluese,  
Ashtu si Pandemisë  
Që ka pushtuar rruzullin.  
Tani jemi dy të huaj;  
Ti në rrugën tënde,  
Unë në udhën time,  
Nuk mbajmë më maska  
Në rrugët tona të gjata,  
Veçse Dielli i dashurisë  
S'na bën më me flatra...  
Mars 2021

### KOHË E PAKOHË...

Më mbyti kjo kohë e pakohë,  
Ky shi që bie me ngashërim,  
Mendime të lagura vërtiten  
Në qiellin pa ngjyrë,  
Ndërsa ajri mpikset në fytyrë.  
Në lokalit që ka zaptuar  
Trotuarin  
Dy të moshuar  
Rrufisin dhembjen  
Në filxhanin e kafesë,  
Rrethuar me gulçë gangësterësh.  
Qelqi i avullt  
Pasqyron portretin tim,  
Ndërsa në tokën e lagësht  
Dielli mezi mbushet me frymë.  
Në qiellin pa formë  
Dita nxin...  
As malet e lartë  
Nuk paskan shpëtim  
Nga ky rrethim...

### ËNDRRA QË FLINTE ZGJIMIN

Ti më nxite frymëzimin  
Dhe ike me një mllef në gji.  
Ëndrrën që flinte zgjimin  
Ç'pate që ma zgjove ti...?!

Ike, më le; ç'ironi!  
Dhe vuaj për shkakun tënd.  
Kur më në fund të vish ti,  
Do të jesh një dhembje që dhemb.

\*\*\*

Dita përndritet  
Në ajrin vjeshtak.  
Mendimet fluturojnë  
Hapsirës së artë  
Dhe përflaken  
Nga mungesa jote  
E gjatë.  
Vjeshta  
Përkundet  
Në pellgjet e lotëve  
Që nuk shterin  
Për asnjë çast,  
Ndërsa malli  
I shndritshëm  
Tretet dhimbshëm  
Në Vjeshtën e artë...

### GJETHET E PEMËVE RËNKOJNË...

Qielli është nxirë,  
Retë mbajnë pezull shiun  
E thinjur nga pritja...  
Gjethet e pemëve rënkajnë  
Nga dhembja e hapave  
Të kalimtarëve  
Që nxitojnë të kapin kohën.  
Në cep të rrugës  
Një i mitur lyp pafajësi,  
Ndërsa dhembja shurdhohet  
Nga boritë e makinave...  
Ky dimër pa borë  
Nuk paska as lot të qajë...

### VJESHTËN SONTE DO TA DEH

Do të pi të bëhem tapë,  
T'i kthej gotat nji nga nji,  
Të ec i vetëm nëpër natë  
Gjersa të mbërrij te ti...

Do ta pi të gjithë rakinë,  
Vjeshtën sonte do ta deh;  
Se ajo më heq mërzinë,  
Që pa gjumë po me le...

Përmbi re do të shkoj shaluar,  
Hënën do ta rrok për qafe;  
Pastaj esëll, në të aguar,  
Do puth buzët e një vajze...  
Vjeshtë '99

### NUK PO MENDOJ MË...

Nuk po mendoj më për buzët e tua,  
As për fjalët që ma çonin zemrën peshë.  
Më mirë për ty. Le të jem një i huaj  
Që ikën prej natës e rilind në mëngjes.

S'do të ta prek më as dorën e bukur,  
As do të t'i ledhatoj flokët e zez...  
S'do të t'i vështroj më sytë e shkruar  
Që më shihnin ëmbël çdo mëngjes.

Mirë, pra, po i bindem dëshirës sate.  
Ja, po e dëboj këtë ndjenjë.  
Po ikën ajo duke derdhur lot,  
Ndërsa vetja po më duket si robot...

Brando pati jetën e një djaloshi të Bthjeshtë, nga rrethinat e një qyteti provincial të shtetit Illinois, i cili brenda një kohe shumë të shkurtër, pa i mbushur të tridhjetat, u bë i njohur e i famshëm në të gjithë Amerikën dhe anembanë botës.

Në karrierën e tij të jashtëzakonshme, ai mori dy çmime "Oscar", me Teri Malloin, një boksier dhe natyrë e komplikuar, në filmin *Në ballë të portit* dhe me bosin e mafies, Vito Korleone, te *Kumbari*. Qysh në fillim (në fillim të viteve '50), Brando, si asnjë aktor tjetër, pati katër nominime radhazi si Aktori më i Mirë për çmimin e akademisë "Oscar", që nisi me *Një tramvaj i quajtur dëshirë*, *Rroftë Zapata!* dhe *Jul Cezari*. Marlon Brando luajti në 41 filma, në 54 vjet karrierë.

Kur isha student në Akademinë e Arteve, një nga kurset më me interes ishte ai i filmit, që e zhvillonte regjisori Piro Milkani. Në një prej shfaqjeve të javës në Kinostudio, pamë filmin *Rroftë Zapata!*, me regji të Elia Kazanit. Edhe sot e kam të gjallë impaktin që krijoi Emiliano Zapata porsa u shfaq në ekran mes turmës së kryengritësve meksikanë, befasues, imponues, mbresëlënës, me një portret sa i gjithë ekрани, sytërhequr, si të ngjitur në qepalla. Mbetëm pa frymë. Pakkush e kishte parë atë në ndonjë film – televizorët asokohe numëroheshin me gishta, në kinema nuk shfaqeshin filma amerikanë, madje edhe ky variant i blerë nga francezët ishte i dubluar në frëngjisht, nga një aktor francez me zë bariton të thellë, që nuk përqasej me zërin origjinal të Brandos. Loja e tij në atë film na tronditi e na lëkundti bindjet, u bë një objekt studimi dhe krahasimesh për stilin e lojës së aktorëve në film që kishim parë deri atëherë dhe Brando nga ai çast u bë një idhull, model imitimi.

Në një orë mësimi, pedagogia e aktrimit, Drita Agolli, e cila veç dashurisë dhe përkushtimit ndaj profesionit na kultivoi edhe ndjenjën ndaj së bukurës në art, na pyeti se përse Zapata i kishte sytë ashtu të tërhequr e misteriozë. Pasi ne s'dhamë atë përgjigje që ajo priste, na thotë: "Më tepër se një tipar i natyrës a i racës, forma e tërhequr e syve në portretin e aktorit shpreh zgjuarsinë popullore te prijësi meksikan, thelbin e karakterit. Mos harroni, loja e aktorit dhe gjithçka, çdo detaj e gjetje, duhet t'i shërbejë natyrës së karakterit."

Në diskutimet tona si studentë dhe shakave spontane, na pëlqente të imitonim dikush Brandon, dikush Kuinin, me pasionin e aktorit të ri, të etur për t'u transformuar nga vetja në tjetrin, që është thelbi i këtij arti.

Sa herë shfaqet Brando, përfytyroj "inskenimet" që bënim asokohe me Niko Kanxherin, shokun e kursit, aktorin brilant; unë imitoja Brandon, te Zapata, duke përthyer me gishta qepallat nën rrathët e syve, në mënyrë që ato të merrnin formën e syve të Brandos në rol, kurse Niko krijonte plastikën e çlirët të Kuinit në rolin e Manos, vëllait të Zapatës, duke i rënduar duart e duke zbritur zërin 1-2 oktavë më poshtë. Ishte një lojë zbavitëse, që u kthye në zakon mes nesh. Qeshnim.

Kur pas disa vitesh regjisori Sajmir Kumbaro, shoku ynë i kursit, na vuri përballë njëri-tjetrit, në dy role kundërshtare, te filmi *Vdekja e kalit* (filmi i parë pa censurë pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri), i thashë Nikos se ato prova që bënim atëherë kishin qenë së paku një shenjë parathënëse për një kohë tjetër, kur do të luanim si partnerë dramën shqiptare të njeriut nën diktaturë njëmend, duke i lënë imitimet.

Po çfarë kishte në interpretimin e Marlon Brandos që na rrëmbeu si magji? Lojë e përmbajtur, në nënshtresë, si "e fshehtë", e qetë në sipërfaqe, por e beftë dhe


Njëqind vite më parë, më 3 prill 1924 lindi  
Magjia e Kinemasë Marlon Brando

## SI AKTORË TË RINJ, KISHIM SI MODEL INTERPRETIMIN E BRANDOS NË FILM

nga Timo Flloko

shpërthyes si uragan në çastet kulmore. Brando sillte si askush tjetër një realizëm të paparë në ekran deri atëherë, me një proces të brendshëm të përmbajtur, por intensiv, atë që më vonë do ta mësonim si tipar kryesor i lojës së aktorëve të Metodës, të shkollës së aktrimit sipas parimeve të Stanislavskit, të gjeneruara në teatrin amerikan nga Stela Adler, Li Strasberg, Elia Kazan etj., me kampionë aktorësh si Xhejms Dini, Merlin Monro, më vonë Xhek Nikolson, Robert de Niro, Robert Duval, Dastin Hofman dhe Al Paçino, mes të cilëve shembulli më përfaqësues ishte dhe mbeti Marlon Brando.

Brando u shkollua me Stela Adlerin në Studion e Aktorëve në Nju-Jork, parimi bazë i së cilës ishte transformimi artistik i aktorit në rolin që interpreton. Arsyeja pse Brando ishte më i miri qëndron në atë se ai i ndërtonte karakteret së brendshmi, duke i përmbajtur emocionet për momentet më kulmore, të cilat krijojnë shpërthimin e madh. Ai e bëri këtë me aq përsosmëri në filmat e tij të parë, sa e ngriti stekën e "kërcimit" shumë lart, madje edhe për veten e tij. *Tango e fundit në Paris*, që doli në të njëjtin vit me *Kumbarin*, është filmi më personal i të gjithë filmave të tij, ku emocionet, përmes një teknike të përsosur, vijnë nga brendësia në sipërfaqe bindshëm, të gjalla, përpara syve tanë. Brando solli një koncept të natyrshëm e realist pranë psikologjisë njerëzore në karakteret që



luante, sa vështirë të dallohet në ta loja, teknika profesionale, truket e artificet dhe vështirë ta ndash për nga vërtetësia artistin në rol nga njeriu në jetë; ai e fshin atë kufi.

Është e njohur polemika që pati Marlon Brando me Lorenc Oliverin, kolosin e teatrit dhe filmit anglez, mbi parimet e interpretimit në film. Oliveri nuk pranonte ta "ulte" personalitetin krijues të aktorit në nivelet e një loje në nënshtresë (parimi i ajsbergut, 1/4 në sipërfaqe dhe 3/4 e pashfaqshme, nën ujë), natyrale në skaj, që ishte njëherësh thelb e stil i parimeve të Metodës. Sigurisht, të dy kolosët i respektonin principet e artit të njëri-tjetrit dhe ajo polemikë zhvillohej midis dy majave nga më të lartat që ka njohur teatri dhe filmi ndonjëherë.

"Po të ishte ndarë nga jeta pas filmit *Në ballë të portit* më 1954, miti i tij do ta kapërcente atë të Xhejms Dinit dhe të Merlin Monrosë, të marrë së bashku. Brando ishte simboli i parë i rebelimit rinor të pasluftës, seks-simboli i parë, djaloshi që çdo i ri ëndërronte t'i ngjante", - shkruante për të *Daily News*.

Si aktorë të rinj, disa prej nesh kishim si model interpretimin e Brandos në film.

Në fillim të viteve shtatëdhjetë, kur sapo kisha mbaruar Akademinë, fati e solli të luaja një rol, të cilin e kishte luajtur Brando në film, atë të Val Ksavie, tek *Orfeu zbret në Ferr* të Tenesi Uiliamsit, me partnere kryesore në rolin e Ledit, Margarita Xhepa. Për fat të keq, rolin e luajta deri në provën gjenerale, sepse pjesa u ndalua nga censura e asaj kohe dhe regjisori Mihal Luarasi u burgos si armik i regjimit dhe i metodës së realizmit socialist. E mora si shembull, sepse roli im ishte kryefund një imitim (s'mund të them as për humor, si një "variacion" mbi lojën e Brandos!) i bërë me zell e ngulm për t'i ngjarë sa më shumë atij, në lëvizje, në plastikë, në reagimet psikologjike. E adhuroja Brandon si besimtari Zotin, por synimi për ta imituar ishte i gabuar (arti nuk është imitim, por krijim), edhe pse imitimi më shërbeu për ta vënë veten në provë se sa i aftë isha ta bëja atë gjë. E vetmja gjë që vllente ishte modeli i përsosur që kisha zgjedhur, Brando, por krejt e gabuar në principin krijues. Me mendjen time kujtoja se sa më shumë t'i ngjaja modelit aq më shumë isha brenda karakterit që luaja. Është e kuptueshme, shkrijta me modelin e ëndërruar, nëse ndodh, u takon fillimeve të krijimtarisë, kur nuk e ke krijuar ende personalitetin si artist dhe je nën ndikimin e idhujve të adhuruar, si në këtë rast.

Kolegu dhe miku im i paharruar, Bujar Lako, e adhuronte Brandon si dhe unë, mos edhe më shumë. Bujari pati një sukses të bujshëm me filma, si *Gjeneral Gramafoni*, *Udha e shkronjave*, por jo rrallë zëra xhelozësh pëshpëritnin se Bujari luan si Brando. Absurde ta mendosh! Bujari, pavarësisht adhurimit ndaj Brandos, kishte prirje ndaj një loje të përmbajtur e psikologjike para kamerës, që ishte veçori e natyrës së tij si aktor, një aktor i madh, që e kishte bërë të shquhej mbi të tjerët.

Në vitet kur isha pedagog i ri i mjeshtërisë së aktorit në Akademinë e Arteve, në një nga orët e leksioneve të lëndës, referoja për një temë që lidhej




me krijimin e rolit nga artisti i metodës së realizmit socialist e se si kjo metodë e kushtëzon nivelin artistik të krijimit dhe se sipas saj vetëm një artist me botëkuptim marksist-leninist është i aftë ta përkryejë procesin mishërues të rolit, perspektivën e tij. Në auditor u krijua një heshtje e pezmet dhe pas pak studenti më kurajoz mes tyre pyeti: "Më falni, profesor, po si e shpjegoni ju faktin që Marlon Brando e ka luajtur Emiliano Zapatën në film në mënyrën më të përsosur, ai nuk është aktor i metodës së realizmit socialist dhe nuk ka botëkuptim marksist...?!" Pyetja, edhe pse delikate e sfiduese, pritej, por unë "dredhova" duke përmendur atë që kishte thënë Engelsi për Balzakun, se ka raste që vepra e shkruar i imponohet artistit, pavarësisht botëkuptimit, se: "Balzaku e kishte tradhtuar pa e kuptuar kauzën e vet." Atë pyetje ma bënin çdoherë studentët te leksioni mbi karakterin, sa herë shtrohej si çështje. Unë e pëlqeja atë sfidë dhe e sillja shembullin në auditor enkas, që pyetja të bëhej patjetër e të zinte vend. Ishte një rebelim brenda meje i artistit ndaj absurditetit të metodës socrealiste, ku ngadhënjyes dilte artisti, ndërkohë që lektorit skematik i binte argumenti e zihej mat si një shahist i pazot dhe përligjeje e vërteta mbi mashtrimin.

Më tej akoma, si për ta eksportuar fenomenin përtej auditorit në opinionin më të gjerë, m'u kërkua të kumtoj në një sesion shkencor në nivel akademie mbi interpretimin e aktorit të metodës së realizmit socialist. Në kumtesë shtrova pa nguruar të njëjtin problem. Mora si shembull dy role të Brandos dhe i vura përballë. Zapatën, të pranuar nga opinioni si një realizim të suksesshëm, por duke vënë theksin mbi botëformimin dhe idealet e luftës për liri të prijësit popullor, të cilat e kishin kushtëzuar suksesin në rol. Si shembull kundërvënës mora Polin te *Një tango në Paris*, një personazh pa moral shoqëror, të degraduar dhe pa të ardhme, një shembull degjenerues ndaj brezit të ri. (Për paradoks, karakteri i Polit ishte një nga rolet e Brandos që çmoja profesionalisht më shumë.) Hipokrizi nga ana ime, pa dyshim, që e dëmtonte imazhin tim, por kjo nuk kishte aq rëndësi në atë sistem hipokrit, rëndësi merrte ai trajtim ambig, vënia në dyshim e metodës përmes dy roleve të kundërta të Brandos në opinion, ku sukcesi i aktorit në secilin hidhte përtokë absurditetin e metodës socrealiste. Pas sesionit, ndonjë aparatçik më shtrëngoi dorën, të tjerë heshtnin në mospranim, një shok më tha: "Vërtet mendon ashtu?!", kurse profesor i dhe kritiku i shquar i teatrit, Kudret Velça, më tërhoqi mënjandë dhe më tha: "Do të të qortoja nëse do të kisha bindjen se mendon ashtu, në atë që kumtove s'kishte argument."

Në vitet pas rënies së diktaturës e kam trajtuar rishtas të njëjtën çështje në auditor, duke e ironizuar pozicionin dhe ligjërimin tim absurd e pa argument në të shkuarën, duke përqeshur madje edhe veten. Shembull më të mirë në përvojën time si profesor i aktrimit rreth skematizimit të asaj metode absurde rrallë se gjendej. Brandos ia shlepa borxhin me përkthimin e autobiografisë së tij, që e botova në vitin 2003.

Në librat që u botuan për të, admiruesit e tij zbuluan një Brando të vërtetë, një fëmijë i egër që e thërrisnin Bad, rebel dhe i pashtruar...

Marlon Brando ishte i njohur për karakterin e tij kryengritës ndaj autoritaritetit qysh nga shkolla fillore, kundërshtues ndaj tutelës së komandimit dhe urdhrit arbitrar në ushtri, në shkollën ushtarake, nga ku edhe e përzunë (ai s'pranoi të kthehej më kur e kërkuan).



Brando ishte nga të parët që iu kundërvu rregullave të ngurta shfrytëzuese të studiove të Hollivudit. Përpara dinjitetit vetjak ai nuk vinte asgjë dhe dëshpërohej në rastet kur shihte se si kolegët e tij, për të siguruar një rol në mëshirë të studiove, shisnin personalitetin. "Hollivudi drejtohet nga frika dhe etja për para, - do të deklaronte Brando në një intervistë, - por nuk mund të më drejtojë mua; unë nuk kam frikë nga asgjë dhe nuk jam i etur për para".

Brando u rebelua ndaj konvencioneve të Hollivudit dhe nuk pranoi të luante në jetë rolin e një ylli kinemaje. Arsyeja që e interpretoi boksierin Teri Mallo me aq vërtetësi që se "ai ishte një luftëtar si asnjë tjetër", shprehet në një intervistë Iva Maria Seint, partnerja e tij te filmi *Në ballë të portit*. Ai luajti një galeri rolesh, të cilat e tronditën traditën e deriatëhershme të

filmave të Hollivudit dhe sollën një model të ri, të pashfaqur më parë. Në një nga rolet më të rëndësishme, Vito Korleone, një karakterizim artistik i guximshëm e me risk, me atë zërin frymor e të shuar, gjysmëbelbëzues, u shfaq një nga karakteret më të famshme e më të papërsëritshme në kinema, maja e piramidës në artin e aktorit për nga mjeshtëria e gjenialiteti krijues, rol që i dha atij "Oscar"-in e dytë, të cilin Brando e refuzoi si protestë ndaj keqtrajtimit të indianëve të Amerikës nga shteti federal.

Krijimtaria e një artisti gjykohet nga arritjet. Ja një vlerësim, sipas kritikës, i dhjetë roleve më të realizuara të Marlon Brandos:

*Një tramvaj i quajtur dëshirë*, 1951  
*Në ballë të portit*, 1954  
*Kumbari*, 1972

*Xheku me një sy*, 1961  
*Tangoja e fundit në Paris*, 1972  
*Jul Cezari*, 1953  
*Rroftë Zapata!*, 1950  
*Apokalipsi sot*, 1979  
*I egri*, 1953  
*Don Juan de Marko*, 1995

Brando gjithë jetën u qëndroi besnik parimeve të tij, në mbrojtje të interesave të popullatës indigjene dhe zezakëve të Amerikës, idealit të lirisë së tyre; realizoi dhe ndonjë film dokumentar për tre drejtat e përkëmbura dhe pabarazinë sociale, duke udhëtuar deri në Indi. Ai ishte i pranishëm fizikisht në tribunën e fjalimit të famshëm të Martin Luther King-ut, "I have a dream".

Originaliteti i tij ishte unik, pa kurrfarë snobizmi, siç është paragjykuar jo rrallë si snob nga kundërshtarët dhe nga ata që s'e njihnin personalitetin e tij. Brando nuk shtirej as kur thoshte se arti i aktorit ishte puna më e dobishme që mund të bënte për t'i siguruar jetesën atij, familjes, miqve të vet, madje edhe botës. "Ai e urrente famën që kishte", - thotë Stela Adler, mësuesja e vet, të cilën ai e adhuronte dhe e çmonte profesionalisht mbi këdo tjetër. "Brando nuk kishte më jetë të vetën pasi u bë i famshëm", - shprehej ajo.

Një artisti të këtyre përmasave, veç të tjerash, iu desh të përballlej me ngjarje të rënda, shqetësime dhe drama familjare, të cilat, për fat të keq, e ndoqën gjatë gjithë jetës. Tri herë i martuar dhe baba i nëntë fëmijëve... Kristiani, djali i parë, i shtiu fatalisht të dashurit të motrës (nga i ati). Më 1995, vajza më e dashur e Brandos, Keien, kreu vetëvrasje në moshën 25-vjeçare... Natyrisht, të tilla fatkeqësi e rrënuan shpirtërisht. Vitet e fundit të jetës, edhe pse ai shquhej për guxim dhe kurajë për ta pirë kupën e jetës deri në fund, me të mirat dhe hidhësitë e veta, Brando u mbyll në vete, larg ishullit të tij në mes të Oqeanit Paqësor, Tetiaroa, ku dikur kalonte net të tëra duke soditur yjet si një Robinson Kruzo i kohëve moderne, në një izolim parajsor, larg botës së rrëmuajshme dhe përpirëse. "Rrallë u end jashtë shtëpisë së tij modeste në Los Anxheles, ku më së shumti fliste në telefon dhe dërgonte fakte në emër të qenit të tij, Doktor Tim", - shkruan po asokohe *Daily News*.

Kur banoja në Los Anxheles (365 S Doheny Drive, BH), më takonte të ngisja shpesh makinën në anën perëndimore të qytetit dhe jo rrallëherë e ktheja timonin në majë të kodrës në Mulholand Drive, drejt shtëpisë së Marlon Brandos dhe fqinjët të tij, Xhek Nikolson. Ndaloja përballë asaj porte pak çaste, si para një tempulli dhe sodisja. Bëja çudi ato çaste se sa pak hapa ndodh t'i ndajnë të zakonshmit nga mitet (të famshmit), realitetin nga ëndrra, ashtu si drita e një fari në net, sa më pranë ke iluzionin se i afrohesh, aq më shumë ai far ikën larg, si infinity. Me dëshirën (ndoshta në dehje) për të trokitur një herë a për të prekur atë portë, me atë drojë misterioze që na ndan si një mur kinez nga madhështia, ndërroja mendje, shkelja vullshëm pedalin e gazit dhe humbja tutje. Zotat kanë qiejt e vet!

Përherë kam pasur një bindje se gjërat, kur s'ndodhin, janë më të shenjtëruara (mjafton të besosh në këtë, e vlen).

Brando mbylli një epokë; arti i interpretimit në film i niveleve më të epërme mban vulën e tij.

Këtu e njëzet vjet më parë, gjatë përkthimit të autobiografisë së Marlon Brandos, *Këngët që më mësoi nëna* (*The Songs My Mother Taught Me*, me titull në shqip *Përtej famës*) e kam ndier asoherë atë si një krijim timin nga adhurimi i paskaj ndaj Brandos, frymëzuesi im mbi gjithçka, për ta sjellë sa më të vërtetë përmasën e personalitetit të tij për artistët shqiptarë.

## THIRRJE PËR APLIKIME NGA SHOQATA "MARTIN CAMAJ"

Synimi i Shoqatës Martin Camaj është përkrahja e shkëmbimit kulturor dhe ndërmjetësimi mes kulturave shqiptare dhe gjermane. Prej disa vitesh për këtë ofrohet edhe çmimi "Martin Camaj", duke nderuar talentet e reja në fushë të shkencës dhe të kulturës.

Me çmimin "Martin Camaj 2024", Shoqata Martin Camaj dëshiron të tregojë vlerësimin e saj për letërsinë shqiptare për fëmijë, e cila vendos themelet kulturore për më të rinjtë. Çmimi shoqërohet me një shpërblym monetar prej 1000 euro. Ftohen të aplikojnë të gjithë autorët nga Shqipëria, Kosova, Mali i zi dhe Maqedonia e Veriut të cilët në dy vitet e fundit kanë botuar libër për fëmijë.

Juria e Çmimit "Martin Camaj" do të bëjë një përzgjedhje dhe do të njoftojë fituesin e çmimit nga fundi i qershorit 2024, e më pas do të bëhet prezantimi formal në mbledhjen vjetore të shoqatës në shtëpinë e Erika Camajt në Lenggries, në korrik 2024.

Ju lutem dërgoni me email në [info@martin-camaj.de](mailto:info@martin-camaj.de) deri në 30 prill 2024 pdf të librit, biografinë tuaj dhe eventualisht kritika letrare.

Në emër të presidencës së Shoqatës Martin Camaj  
Prof. dr. Christian Voss, Kryetari

In memoriam

## Prof. dr. Enver Muhametaj – studiuues i përkushtuar i mendimit letrar shqiptar

Nga Prof. dr. Rami Memushaj

Të gjithë jemi sot dëshmitarë të një krize të thellë që po përjetojnë shkencat albanologjike. Nga njëra anë, po ndahen nga jeta studiues të përkushtuar të kulturës shqiptare – të historisë, gjuhës, letërsisë, etnologjisë, arkeologjisë etj. – dhe, nga ana tjetër, po krijohet një zbrazëti e frikshme në këto fusha për shkak të mungesës së kujdesit të institucioneve shkencore e të shtetit për përgatitjen e studiuesve të rinj.

Edhe në fushën e letërsisë ndihet mungesa e asaj plejade studiuesish e kritikësh letrarë që i dhanë vull mendimit letrar shqiptar në gjysmën e dytë të shekullit që shkoi. Dhe një ndër studiuesit e fundit letrarë të këtij brezi të munguar është edhe prof. dr. Enver Muhametaj, që u nda nga jeta një vit më parë.

I diplomuar më 1968 me rezultate të shkëlqyera për gjuhë e letërsi ruse në Universitetin e Tiranës, më 1970 ai nisi punën si punonjës kërkimor-shkencor në sektorin e letërsisë pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. I pajisur me një vullnet të fortë dhe me një dëshirë të madhe për të studiuar, nën udhëheqjen e drejtuesit të sektorit të letërsisë prof. Koço Bihiku, ai iu vu me zell punës për ngritjen e vet teoriko-letrare. Shumë shpejt emri i tij zuri të shfaqej në revistën shkencore “Studime filologjike”, duke filluar nga viti 1972 me një studim për nevojën e një sistemi koherent nociónesh letrare dhe duke vijuar pa ndërprerje me artikuj, me studime e monografi për probleme të teorisë së letërsisë. Më 1981 mori gradën shkencore “Kandidat i shkencave filologjike”, më 1986 titullin “Bashkëpunëtor i vjetër shkencor”, më 1994 titullin “Mjeshtër kërkimesh”, i barasvlefshëm me titullin “Profesor i asociuar” dhe më 2010 titullin “Profesor doktor”. Duke vlerësuar seriozitetin dhe përkushtimin e tij në punë, qysh herët u ngarkua me detyra të ndryshme, si sekretar shkencor i sektorit të historisë së letërsisë shqiptare të periudhës së pasluftës, anëtar i redaksisë së revistës shkencore “Studime filologjike”, përgjegjës i departamentit të historisë së letërsisë shqiptare (1993–1998) dhe nga vitit 2008 e deri 2011, kur doli në pension, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Veprimtaria e pasur krijuese e prof. dr. Enver Muhametaj përfshin gjashtë monografi, shumë studime e artikuj letrarë, tekste mësimore si dhe botime tekstologjike. Kjo veprimtari e pasur shkencore nuk do të kishte qenë e tillë, pa dëshirën e tij të madhe për të nxënë, të shfaqur që në shkollën e mesme “Jani Minga” dhe pastaj në bankat e universitetit. Dhe në të dyja nivelet e shkollimit u shqua si nxënë dhe student sistematik e shembullor. Serinë e monografive e nisi me monografinë “Tipikja dhe tipizimi në letërsi” (1982), me të cilën mbrojti titullin e kandidatit të shkencave, dhe e vijoi me monografitë “Mbi specifikën dhe rolin e humorit e të satirës në letërsinë shqiptare” (1986), “Rreth çështjes së karakterit kombëtar të letërsisë” (1983), “Roli dhe vendi i konvencionit në letërsinë shqiptare”, “Mbi mendimin estetik të Gjergj Fishtës” (1994) dhe “Ndhimesa të Ernest Koliqit në mendimin teoriko-letrar shqiptar” (2008), disa prej të cilave janë botuar si libra më vete dhe disa të tjera pjesërisht në revistën “Studime filologjike”.

Këtyre vjen e u shtohet përmbledhja e vëllimshme “Mendimi letrar shqiptar (1939–1944)”, vëll. 7 (Tiranë, 2008), nisur prej tij si pjesë e projektit madhor “Korpusi i mendimit letrar shqiptar nga fillimet deri më 1944”, të cilin mjerisht nuk arriti ta përfundonte. Kjo antologji përbën një prurje me vlerë në fushën e njohjes së trashëgimisë sonë letrare. Do të ishte një gjë me vlerë të madhe sikur sektori i letërsisë i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë ta rimernte këtë projekt aty ku e la prof. E. Muhametaj, duke ndjekur parimet e rrepta tekstologjike të zbatuara prej tij në vëllimin e shtatë. Përmbledhja e shkrimeve të periudhës midis dy luftërave do të ndihmonte në thellimin e studimeve të mendimit letrar shqiptar dhe të letërsisë shqiptare të kësaj periudhe.

Edhe vetëm nga titujt mund të shihet se në

veprimtarinë e tij krijuese pas viteve '90 prof. Muhametaj kaloi nga trajtimi i problemeve teorike të letërsisë në studimin e mendimit kritik, pra në kritikën e kritikës, me të cilën u mor në tri veprat e tij të fundit.

Me këto punime, ai krijoi shkallë-shkallë profilin e vet si teoricien i letërsisë, i kushtuar trajtimit të problemeve të *mprehta teorike të letërsisë shqiptare*. Vepra e tij dallohet për mprehtësinë dhe thellësinë e gjykimit, për akribinë e lavdërueshme, për guximin për të trajtuar çështje të vështira dhe për të ngritur ide të reja, gjë që mundi ta arrinte me punë të palodhur për formimin e vet shkencor. Gjatë veprimtarisë së tij të gjatë shkencore ai erdhi duke i përforsuar disa cilësi të domosdoshme për kërkimin shkencor, si aftësia për të rrokur me mprehtësi problemet teorike, skrupuloziteti dhe përpikmëria në trajtimin e tyre, si dhe ngulmimi për t'i shpurgë gjërat deri në fund.

Veprimtaria e tij shkencore dhe botuese nuk mbeti pa u vlerësuar. Kështu, më 1979 fitoi “Çmimin III të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë” për studimin “Mbi rolin e botëkuptimit në procesin e tipizimit” (revista “Nëntori”, nr. 9, 1979) dhe më 1984 me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor iu dha “Urdhri Naim Frashëri i Klasit III”.

Por kontributet e prof. dr. Enver Muhametaj nuk kufizohen vetëm në fushën shkencore. Ai ka ndihmesa të spikatura edhe në fushën e didaktikës, si mësimdhënës e si autor e bashkautor tekste të arsimit parauniversitar e universitar. E filloi mësimdhënien si mësues i shkollës fillore në fshatin Arrëz e Madhe të Tepelenës për ta vijuar në shkollën 7-vjeçare të Llakatundit në Vlorë dhe, pas përfundimit të studimeve universitare, si mësues i gjuhës ruse dhe i gjuhës shqipe në shkollën e mesme mjekësore të Vlorës.

Ndhimesat e tij në fushën pedagogjiko-mësimore përfshijnë tekste mësimore për shkollën e mesme e të lartë dhe leksione drejtpërdrejt në auditor. Ai është bashkautor i tekstit “Njohuri nga teoria e letërsisë” (për shkollën e mesme, 1983), bashkautor i tekstit “Nga teoria e letërsisë dhe stilistika gjuhësore”, po për shkollat e mesme (1992), bashkautor i tekstit universitar “Hyrje në shkencën e letërsisë” (Tiranë, 1990). Edhe pasi kaloi në Institut, prof. Muhametaj dha ndihmesa të rëndësishme në fushën pedagogjike, duke marrë pjesë aktive në zhvillimin akademiko-pedagogjik të institucioneve të arsimit të lartë, sidomos pas marrjes së gradës “Doktor i shkencave”. Ndhimesat e tij në fushën e mësimdhënies në shkollën e lartë fillojnë që nga viti 1975, me një cikël leksionesh për teorinë e letërsisë me studentët e degës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës; ai mbajti leksione e seminare në kurset njëvjeçare të magjistraturës, më pas në kursin pasuniversitar të kritikës letrare në Universitetin e Tiranës dhe gjatë periudhës 1980–1989 ka lekturuar për probleme të shkencës letrare në Institutet e Larta Pedagogjike në Shkodër dhe në Elbasan. Pas ndërrimit të sistemit, u aktivizua për një periudhë të gjatë në provimet pasuniversitare të lëndës së teorisë së letërsisë të pedagogëve të universiteteve të Shqipërisë dhe të punonjësve të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Prof. Muhametaj mbajti leksione e mori pjesë në konferenca shkencore në Universitetin e Shën Petërburgut, në Universitetin e Shkupit, në degën e gjuhës shqipe të Institutit të Studimeve Orientale të Napolit dhe në Kongresin VII Ndërkombëtar të Studimeve për Europën Juglindore.

Jeta shkencore e prof. dr. Enver Muhametaj është dëshmi e asaj se suksesi i ka rrënjët në punën këmbëngulëse e plot përkushtim, që kërkon të sakrifkohet shumë gjëra nga jeta vetjake, dhe jo duke u rritur nën hijen e shefave e të parive. Të arrish çdo gjë me forcat e veta, ky është mësimi që brezi i ri i studiuesve mund të nxjerrë nga jeta dhe veprimtaria e këtij punëtori të palodhur të shkencës.

Botimet Fishta, Lezhë, 2023


## “n'teh” si dukuri jetësore, “n'teh” si dukuri artistike në poezitë e Melita Vjerdhës

Nga Xhahid Bushati

“n'teh”...

Edhe pse është vëllimi i parë poetik, ajo, Melita Vjerdha vjen pas një përvoje e pune të heshtur, do të thosha përgjithësisht të panjohur për lexuesin. E, kjo nuk është çudi, kjo ndodh në jetën e krijuesve të vërtetë. Ashtu siç e thashë pak më sipër, vëllimi i parë i titulluar “n'teh”, teksta e lexon na thotë se Melita Vjerdha është nga ajo tipologji poetësh, e veçanërisht poeteshash, ku grafika e ndërtimit kompozicional të poezisë rezonon e shkrihet si një e vetme me zërin lirik të autores, ku vargjet edhe pse nazike kanë një pushtet poetik që të emocionojnë, frymojnë përmes shpirtit, figuracionit dhe shpirtit gegë. Një poete e talentuar, ku përmes rrugës së mundimshme të krijimit, me përveçësinë e saj, na shpërfaq një botë motivesh, ku nga këndvështrimet dhe mënyrat e trajtesës së poezive e të procedimeve strukturore, etj., për vlerat që mbartin ato, pasurojnë denjësisht rrugëtimin e poezisë shqipe. Përftesat e tyre gjatë leximit, të kujtojnë e pse jo (e kam fjalën pozitivisht) ndikime migjeniane, të Gaspër Palit, ndikime koliqiane. Është vlerë që përmes vetjakes tënd të kesh gjurmën tënde të dallueshme në rrugën e ndritur të trashëgimisë së ndritur geqe e mbarë shqiptare.

“n'teh” që prezantohet dhe shënjohet në kopertinën e librit që po diskutojmë, në vetvete mbart provën dhe raportin e njeriut me një problem, vështirësi apo dukuri të caktuar, sigurisht që është delikat, aq delikat sa në atë “n'teh” mund ta fitosh apo ta humbasësh një betejë jete, që ka koston e një



buzëqeshje të pafund si dhe të një hidhërimi të pafund. Por “n'teh-un” që na dhuron përmes vargjeve Merita, ne përftojme magjinë e një emocioni që fal poetika e saj, ndërsa ndjesitë përmes delikatësës vibrojnë sipas ritmikës së shpirtit. “n'teh” i jetës me “n'teh” i librit gjejmë plot stacione jete njerëzore, ku ata përkrijnë e takohen, por që sigurisht edhe ndahen. Gjithsesi, nuk mund të harrosh apo të anashkalosh, teksta i kujton nga leximi, si: copëza realitetesh, kohë të harruara e kohë të përjetuara, realizëm dhe ëndërrime, dëshira... Të gjitha këto e të tjera janë kompozuar dhe realizuar përmes një larmie rrafshesh shikimi dhe interpretimi. Mendoj, që poezia “ekuilibër” na e thotë këtë të vërtetë, ku ky nocion i kthyer shpesh në metaforë vizatohet përmes shkallëzimeve e inversioneve herë ngjitëse e herë zbritëse. citoj: “me lé / me qenë / me pasë / me ditë



/ me u lumnu / me andrru". Më tej: "me dashtë / me drashtë". Më tej: "Me u rrëz / me më ra / me u vra / sërisht me u rigjetë".

Përmbledhja "n'teh" i Melitës; në koncept e strukturë paraqitet si një tablo të jetës njerëzore, ku poetesha ka hyrë në skutat e shpirtit të tyre, në vizatimet e peizazheve shpesh lirike duke u njëjtësuar si gjendje shpirtërore, pa mbetur dorë jashtë dhe meditacioni e njëherazi edhe refleksionet e autores. E këto cikle janë: - ekuilibër; - kur plaket heshtja; - dizajn metaforash; kuadri i një epoka gri. Nga një këqyrje formale, mendoj se Melita është poeteshë e metaforës: herë drithëruese, e herë me nuanca tragjike e shpresëdhënëse...

### Natyrë e poezisë së poetes Melita Vjerdha

Po për çfarë shquhet natyrë e poezisë së poetes Melita Vjerdha? Ku duket e dritshmja dhe e fshëhta e saj, e njohura dhe e panjohura e saj, materja dhe heshtja e saj, e pabërtitura dhe modestia fisnike e saj? Po përmend disa prej tyre... - Poezitë ndërtohen dhe shquhen për raporte komunikimi. Ky dialog e nis fillin të titulli i poezisë, që për autoren është i rëndësishëm dhe është themeli, ku ngrihen më pas ngrehinat dhe strehëzat e fjalëve të mirëmenduar, plot ngjyra e stilistikë.; - Është e pranishme koha me të kaluarën dhe të përditshmen e saj. E folura e saj nuk është dekor, por do të thoja "personazh"; - Në mënyrën e perceptimit dhe të bashkëbisedimit, shpesh dhe të enumeracionit, kanë gjetur prezencën e tyre shpirtëzuese, si: dëshirat, lutjet, falja në emër të shpresës... etj., - thekse domosdoshmërie për të ngritur e vazhduar një ëndërr të saponisur apo të një ëndërr që të mos mbetet ëndërr.; - Përmes procedimit të poezive, që në dukje të parë duken si pabujë, por në të vërtetë shpirti i poetes është i shqetësuar, fundi i vargjeve shpesh shfaqet si kundra punt i kësaj "rrjedhe të qetë" do të thosha, pra një befasi, apo si plotësim i portretit të poezisë. Kjo është një veçori që plotëson individualitetin e poetes. Këtij plotësimi, shpesh i vjen në ndihmë paralelizmi figurativ dhe kontrasti.; - Një natyrë tjetër poezie që zë vend është dhe ajo që unë e kam quajtur poezia-portret. Edhe kjo është një veçori tjetër që i vjen në ndihmë individualitetit të poetes për ta dimensionuar artistikisht atë. Zakonisht poezitë-portret zënë hapësirat e ciklit "kuadri i një epoke gri".

### Fjala si akt besimi

Si përfundim, te ky libër me vlera e që të emocionon, Melita e përzgjedh fjalët, i jep asaj siguri e jetë. Fjalët u ngjajnë gjyshërve të urtë e të ditur, që edhe pse plaken vazhdojnë të rrëfejnë aq bukur histori jetësh njerëzore. Përse e them se Melita i beson fjalës? Një pjesë e poezive si titull kanë vetëm një fjalë. Dhe ky është një akt i madh besimi që kjo marrëdhënie kurorëzohet me sukses e artistikisht. Po përmend disa: "ekuilibër", "rutinë", "falma", "mur", "endacak", "gjurmë", "qetësi", "paradoks", "tjetër", "peng", "pupël", "mik", "rikthim", "thinjat", "liqeni", "ngujim", etj. Me që jemi tek fjala, po ndalem tek figuracioni ndërtimor, ku shpesh kthehet në një fjalë urtësie e mençurie dhe kjo falë Melitës. Citoj: vdekje dëshirash, dëshira t'ngujume, kujtime t'idhnume, grumbuj vujtjesh, gjurmë vesesh, tingull i shpirtit, melodi të trishta; vrap i shpejtë, kam e vogël, këpucët e randa; vjen një kohë që i druhen kohës; janë derdh ujnash pa u la / janë rrezu malesh pa u vra; kam harru me andrru / duke e jetu jetën përditë; telajot me ngjyrat e heshtjes; në pëlhurat e vjeshtës delikate; nuk kam kohë / mos me dashtë; më pëlqen çdo ikje për me u rikthi...

Shkodër, mars, 2024

# KTHEMI COPAT E MIA

## Poezi nga Vasko Popa



Guxo e bjerëm ndërmend  
Mendimet e mia fyren kanë me ta çky  
Guxo e dil para meje  
Sytë kanë me m'leh në ty  
Guxo e hape gojën  
Heshtja jem nofullën ka me ta thy  
Guxo e ma kujto veten tande  
Kujtimet e mia tokën nën shputa kanë me ta grry  
Deri këtu kemi mbërri

1.  
Kthemi copat e mia,  
copat e gjumit të paqetë  
Të buzëqeshjes së mëndafshhtë të parandjenjës vijore  
T'nerit tem të zafët;  
Copat e mia të shpresës pikaloshe  
Të dëshirës së lustrueme t'shikimeve laroshe  
Të lëkurës së fytrës tem  
Kthemi copat e mia  
Kthemi derisa po të lus si njeri

2.  
Ndigjo ti lugate  
Hiqe atë shami t'bardhë  
Unë t'njoh ty  
Që prej vogëlie  
Prej të njajtës kalanicë kemi pi  
Në të njajtin çarçaf kemi ra  
Me ty ti thikë sykeqe  
Në këtë botë të gabueme kemi ecë  
Me ty ti gjarpën tinzar  
A po digjon ti hileqare  
Hiqe atë shami t'bardhë  
Pse duhet mu mashtrove.

3.  
Nuk do t' maj kalikuks n'shpinë  
Nuk do të çoj ku t'më thush  
S'do ta báj edhe n' dukat me m'la  
As i lidhun në trerrotak ere  
As i zaptum me frena t'ylberit  
Mos u mundo me m'ble  
S'do ta báj as me kambë në xhep  
As i futun n'birë t'gjilpanës as i lidhun nyje  
As i zvogluem në një kallam të randomt'  
Mos u mundo me m'tutë  
S'do ta báj as i pjekun as i thekun  
As gjallë i kryposun  
As nandërr  
Mos e mashtro veten  
Asgja nuk dhezë, nuk due

4.  
Jashtë prej pafundsisë tem t'murosun  
Prej valles yjore rreth zemrës tem  
Prej kafshatës tem të diellit  
Jashtë prej të huejit det t'gjakut tem  
Prej naltësisë tem, prej ultësisë tem  
Jashtë prej heshtjes teme të thatë  
Jashtë thashë jashtë  
Jashtë prej humnerës tem t'gjallë

Jashtë prej trungut të zhveshun atnor n'mu  
Jashtë deri kur më duhet me bërtitë jashtë  
Jashtë prej kresë që po m' shpërthen  
Jashtë veç jashtë

5.  
Ty të vijnë kukullat  
E unë në gjakun tem i laj  
Me copa t'lëkurës tem i pshtjelli  
Luhajë prej flokëve t' mia ju maroj  
Karrocë prej rruazave t'mia  
Avionë prej vetullave t'mia  
Ju baj flutura prej buzëqeshjeve t'mia  
Lodra prej dhambëve t'mi  
Ta ndjekin e çojnë kohën  
Po çfarë loje bájne ashtu

6.  
Tu shohtë fara e fisi, e nama  
E krejt çka ke n'jetë  
Tu shohtë imazhi i etun n'tru  
Dhe ndijimi përvlues n' majat e gishtave  
Dhe secila secila pllambë  
Në tre kazana t'ujit fatëkeq  
Në tre furra të zjarrit t'shejt  
Në tre gropa pa emën e pa tamël  
E ftohtë të kjoft frymëmarrja deri n'fy  
Deri tek guri poshtë gjinit t'majtë  
Deri tek marshi i briskut natë gur  
Në ferr, në varr në boshllakun e pjellë  
Në gërshantë e urituna t'fillimeve e fillimeve  
Në mitrën qiellore ne njohsha unë

7.  
Çka u ba me copat e mia  
S'do mi kthye a, nuk do?!  
Kam me t'i djeg unë vetullat  
S'ke me kanë përjetë e padukshme  
Kam me ta përzie natën me ditë në krye  
Ke me i ra ti derës tem me ballë  
Kam me t'i pre thojtë vërshtëllues  
Që mos me vizatue gjëgjëza n'trunin tem  
Kam me t'i shty mjegullitë prej eshtnave  
Me t'i thithë helmet prej gjuhës  
Ke me pa çka kam me t' ba  
T'u shohtë kotilla e temeli e shkëlqimi  
Dhe terri dhe pika në fund të jetës tem  
E krejt çka ke n'jetë

8.  
E ti po do na me u dashtë  
Mundesh me më ba prej hinit tem  
Prej rrënojave të qeshjes tem zanaltë  
Prej mërzisë tem të mbetur  
Mundesh bukuroshe  
Me m'kapë për një fije harrimi  
Me ma përçafu natën n'këmishën e shkretë  
Me ma puthë oshtimën  
Po ti nuk di me u dashtë

9.  
Ik lugate  
Edhe fërkemet po na azdisen  
Po hahen mas neve në pluhun  
Nuk jemi njani për tjetrin  
Akullnajë e ashpër shikimi yt  
Prej teje kapërcej prej fundit në fund  
S'ka mbet gja prej lojës  
Qysh i kemi përzi copat kështu  
Kthemi çka po të duhen  
Kot po të zbehen mbi supe  
Kthemi e në hiçin tand ik  
Ik lugate prej lugatit  
Ku i ke sytë  
Edhe këtu asht terr

10.  
Gjuha e zezë, mesdita e zezë, shpresa e zezë  
Krejt t'zeza veç rrëqethja jem e bardhë  
Ujkun tem e paç n' fyt  
Stuhi e paç shtratin  
Lemeri jastakun tem  
T'pafundme i paç trazimet  
T'zjarra i paç kafshatat e dhambët e dyllit  
E ti përtypu grykëse  
Sa të dush përtypu  
Të heshtun e paç erën, të heshtun ujin,  
t'heshtuna lulet  
Krejt të heshtuna veç kërcëllima jem e zhurmshme  
Fajkoi jem në zemrën tande  
Nanat ma pak me u tutë

11.  
E kam fshi fytrën tande prej ftyres tem  
E kam shkul hijen tande prej hijes tem  
T'i kam fashitë kodrat  
Rrafshinat n'kodra t'i kam kthye  
T'i kam shti stinët n' bela  
I kam heq krejt anët e botës prej teje  
E kam laku tanë udhën e jetës tem  
Të pakalueshmen, të pamundunën  
E ti tash përpiqu me m'takue


12.  
Boll ma me jargitje t'amblla, boll me çikërrime të sheqerosuna  
Asgja s'po due me ndigju, asgja me ditë  
Boll, boll gjithçka  
Kam me e thanë të fundit boll  
Kam me e mbushë gojën me dhe  
Kam me i shtrëngue dhambët  
Me e pre kullimin në krye  
Me e pre njihërë e mirë  
Kam me ndejtë ashtu qysh jam  
Pa rranjë, pa degë, pa kunorë  
Kam me ndejtë tu u majtë në veten tem  
Në gungat e mia  
Kam me kanë një shkop murrizi mrena teje  
E vetmja gja që mrena teje muj me kanë  
Në ty, ti lojëprishse, në ty, ti kotësi  
Mos u kthefsh

13.  
Mos u tall lugat  
Thikën e ke mshef poshtë shamisë  
E ke shkelë vijën, ke marrë n' thue  
E ke prishë lojën  
Edhe qielli me u rrotullue  
Edhe dielli në tokë me ra  
Edhe copat me mu përzi  
Mos e tall lugate lugatin  
Kthemi copat e mia  
Edhe unë t'i kthej tuat!

Përktheu: Vlora Konushevc

Vasko Popa u lind me 29 qershor 1922 në fshatin Grebenac në Vojvodinë, dhe kishte përkatësi etnike rumune. Në vitin 1940 ai u regjistrua në Fakultetin Filozofik në Beograd, për t'i vazhduar studimet e tij në Bukuresht dhe Vjenë. Nga viti 1954 deri në vitin 1979 ai ishte redaktor i shtëpisë botuese "Nolit". Vasko Popa është një nga themeluesit e Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Vojvodinës, e themeluar më 14 dhjetor 1979 në Novi Sad. Ai ka publikuar tetë vëllime me poezi të cilat janë përkthyer në shumë gjuhë të botës duke e bërë Vasko Popën si njërin ndër poetët më me ndikim në botë.

Romani i panjohur i G. G. Markezit u botua në të gjithë botën  
(në shqip nga Onufri), në të njëjtën ditë: 6 mars 2024



  
**LIBRARIA  
ONUFRÍ**  
onufri librari  
onufri librari .com